



Raporti i Investimeve të Huaja Direkte

Shqipëri 2011



United Nations
ALBANIA

RAPORT MBI INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË SHQIPËRI, **2011**

Maj 2012



PASQYRA E LËNDËS

FALENDERIME 07

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 09

HYRJE 11

KAPITULLI I. IHD-TË NË SHQIPËRI: TENDENCAT E FUNDIT, KARAKTERISTIKAT KRYESORE DHE ROLI I TYRE NË EKONOMINË E VENDIT 13

- Një rënie e lehtë në vitin 2011, pas disa vitesh ekspansion
- Karakteristikat e prurjeve të IHD-ve
- Aspektet kryesore të stokut të IHD-venë Shqipëri
- Efektet e IHD-ve: roli i filialeve të huaja në ekonominë shqiptare

KAPITULLI II. POLITIKAT DHE MASAT QË NDIKOJNË IHD-të në SHQIPËRI 29

- Vlerësimi i mjedisit të biznesit dhe pozita konkurruese
- Masa për përmirësimin e mjedisit të investimeve
- Politikat për IHD: regjimi i investimeve
- Vrojtimi mbi kënaqësinë e investitorëve

KAPITULLI III. ROLI DHE NDIKIMI I IHD-ve NË BUJQËSINË SHQIPTARE 43

- Karakteristikat kryesore të politikave bujqësore dhe bujqësisë në Shqipëri
- Tendencat kryesore dhe problemet që lidhen me IHD-të në bujqësi në vende të tjera në tranzicion dhe në Shqipëri
- Konkluzionet dhe rekomandime për politikatat: thithja dhe përfitimi i më shumë IHD-ve në bujqësi

REFERENCAT 66

DY FJALË FALENDERIMI

Raporti mbi Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri për vitin 2011 u përgatit nga një Ekip Shqiptar i angazhuar në punën me Investimet e Huaja Direkte (Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës, Banka e Shqipërisë, INSTAT-i, AIDA (Agjencia Shqiptare për Nxitjen e Investimeve) dhe FIAA (Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri), në bashkëpunim me UNCTAD-in dhe zyrën e PNUD-it në Shqipëri.

Raporti është hartuar kryesisht nga z. Gabor Hunya, konsulent i UNCTAD-it, me mbështetjen substanciale të ekipit shqiptar në fushën e investimeve të huaja direkte, si edhe me kontributin e vecantë të z. Shkelzen Marku, konsulent i PNUD-it, në lidhje me aspektet e bujqësisë.

Ekipi përbëhet nga z. Bashkim Sykja dhe znj. Kujtime Stefani (Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës), znj. Diana Shtylla dhe znj. Godiva Rembeci (Banka e Shqipërisë), znj. Eneida Guria, znj. Silvi Gruda dhe z. Geri Zaimi (Agjencia Shqiptare për Nxitjen e Investimeve), znj. Elsa Dhuli (zyra Kombëtare e Statistikës), znj. Marinela Jazoj (Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri), znj. Diana Leka (zyra e PNUD-it, në Shqipëri), znj.

Lida Llakmani dhe z. Altin Zeqo (Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit). Raporti është koordinuar në cdo fazë të tij nga znj. Diana Leka në zyrën e PNUD-it në Shqipëri dhe nga z. Astrit Sulstarova në zyrën e UNCTAD-it, nën mbikqyrjen dhe drejtimin e z. Masataka Fujita nga zyra e UNCTAD-it, z. Enno Bozdo, përfaqësues i qeverisë shqiptare dhe z. Arben Rama nga zyra e PNUD-it në Shqipëri. Kontribuan me komentet e tyre të cmuara, znj. Padma Mallampally, eksperte ndërkombëtare për Investimet e Huaja Direkte, z. Kalman Kalotay dhe Kee Hwee Wee nga zyra e UNCTAD-it. Për këtë raport kontribuan gjithashtu me komente dhe sugjerime z. Adrian Civici, znj. Luljeta Minxhozi, z. Erjon Luci dhe z. Altin Tanku.

Mbështetja statistikore u sigurua nga znj. Besa Menzelxhiu dhe z. Dorin Rama. Një falenderim i vecantë për përkthimin e këtij raporti në gjuhën shqipe i takon znj. Evis Cerga (Gjikondi). Ky raport është një ndër aktivitetet në kuadrin e projektit për Nxitjen e Tregëtisë Rajonale dhe Thithjen e Investimeve të mëtejshme në Shqipëri.

Dëshirojmë gjithashtu të vlerësojmë, me mirënjohje mbështetjen financiare të One UN.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Zhvillimi i shpejtë ekonomik dhe integrimi në Bashkimin Evropian (BE) renditen ndër përparësitë e programit të qeverisë shqiptare. Politikat kryesore të vendit gjatë viteve të fundit kanë rezultuar në një kuadër të liberalizuar ekonomik dhe kanë sjellë një përmirësim të kushteve për bërjen e biznesit dhe thithjen e investimeve të huaja direkte (IHD). Gjatë periudhës midis viteve 2008-2011, rritja ekonomike e vendit shënoi hapa pozitive. Shqipëria, gjatë periudhës në fjalë, ka shënuar një ndër nivelet më të larta për sa i përket ritmeve të rritjes ekonomike në Europë, dhe e ka përballuar relativisht mirë krizën financiare.

Sipas Indeksit të Performancës së Investimeve të Huaja Direkte Hyrëse të UNCTAD-it, në vitin 2010 Shqipëria renditej në vendin e 18-të midis 141 vendeve, duke shënuar një ngjyje të ndjeshme nga vendi i 68-të që mbante në vitin 2005. Kjo pozitë e përmirësuar reflekton një mjedis biznesi më miqësor ndaj investorëve dhe më shumë mundësi të ofruara përmes privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore.

Përsa i takon Indeksit Potencial të IHD-ve Hyrëse (UNCTAD), në vitin 2009 Shqipëria renditej në vendin e 81-të (viti i fundit për të cilin disponohen të dhëna), shumë më pas vendeve të tjera evropiane. Ky klasifikim i ulët, ndër të tjera, ishte për shkak të infrastrukturës së dobët dhe aktiviteteve modeste në fushën e kërkimit dhe zhvillimit. Si rrjedhojë e investimeve të reja publike, gjatë katër viteve të fundit janë shënuar përmirësime të rëndësishme në infrastrukturën rrugore, ndërsa furnizimi me energji elektrike është stabilizuar, porse mbeten ende disa fusha të tjera ku ndjehet nevoja për përmirësime. Shqipëria ka nevojë të bëjë përmirësime të mëtejshme në potencialin e saj të Investimeve të Huaja Direkte, nëse dëshirohet një nivel më i madh Investimesh të tilla, në vecanti sa i takon investimeve të reja nga korporatat e huaja trans-nacionale (TNC).

Prurjet e investimeve të huaja direkte në vitin 2010 në krahasim me 2009 u rritën nga një e katërta në një të tretën e vlerës së formimit të brendshëm bruto të kapitalit nga 717 milionë euro në vitin 2009 në 793 milionë euro në vitin 2010. Në vitin 2011,

kjo shifër shkoi sërish në një të katërtën (742 milionë euro), shifër e cila gjithësesi mund të konsiderohet si një rezultat pozitiv, në mungesë të marrëveshjeve të rëndësishme të privatizimeve. Investimet e Huaja Direkte financuan 62 përqind të deficitit të llogarisë korrente në vitin 2011, duke shënuar një rënie nga shifra 77 përqind nga një vit më parë. Pavarësisht nga rënia e shënuar në vitin 2011, Investimet e Huaja Direkte përbëjnë një faktor të rëndësishëm për rritjen ekonomike dhe stabilitetin financiar të vendit. Por, një rënie më e madhe mund të sjellë rënie të rritjes ekonomike dhe mund ta bëjë vendin më vulnerabël ndaj tronditjeve të jashtme financiare.

Shqipëria ka zbatuar një kuadër të favorshëm politikash për Investimet e Huaja Direkte. Ndërsa kohët e fundit janë parashtruar politika për mbështetjen e zhvillimit të sektorit privat në përgjithësi. Gjithashtu, janë marrë masa të tjera për përmirësime të mëtejshme, duke përfshirë përmirësimet ligjore dhe krijimin e agjencisë së re për nxitjen e investimeve (AIDA).

Gjatë viteve 2010 dhe 2011, sektori industrial (duke përfshirë manifakturën dhe minierat) përfaqësonte afërsisht 50 përqind të prurjeve të Investimeve të Huaja Direkte, ku përfituesit kryesorë ishin sektori mineral dhe ai i punimit të metaleve. Disa prej industrive që punësojnë më shumë krah pune si p.sh.: ajo e veshmbathjeve dhe këpucëve kanë tërhequr një numër të madh projektesh, me kapital modest, që e kanë burimin kryesisht nga vende si Italia dhe Greqia.

Shkalla e pjesëmarrjes së filialeve të huaja në ekonominë shqiptare është e ngjashme me atë të vendeve të Evropës Qendrore. Shifra e afarizmit e ndërmarrjeve të investimeve të huaja (FIE) dmth ndërmarrje me 10 përqind e lart pronësi nga një investitor i huaj, në vitin 2010 përfaqësonte 29 përqind të totalit të xhiros të vendit dhe 51 përqind të xhiros në manifakturë. Të dy këto përqindje janë 1-2 pikë përqindjeje më lartë nga dy vite më parë. Xhiro e FIE-ve sigurohet nga tri aktivitete kryesore ekonomike: tregëtia (24 përqind), manifaktura (21 përqind) dhe transporti dhe telekomunikacionet (18 përqind). Në manifakturë, FIE-të zënë një vend shumë të rëndësishëm në industrinë e duhanit, prodhi-

meve të naftës dhe të metaleve, ku prodhohet pothuajse i gjithë produkti vendas. Përsa i përket punësimit në FIE, numri më i madh i vendeve të punës i takon kryesisht filialeve të prodhimit të veshmbathjeve dhe këpucëve, si edhe prodhimit të energjisë elektrike dhe sektorit të telekomunikacioneve. Nivelet e larta të pjesëmarrjes së huaj janë rezultat i kushteve të favorshme për Investime të Huaja Direkte në këto industri të vendit, por njëkohësisht është edhe shenjë dobësie e pjesës vendase të ekonomisë, ku përfshihet edhe sektori lokal i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME), i cili nuk ka zhvillimin e duhur.

Futja e investitorëve të huaj në një shkallë të gjerë në shërbimet financiare dhe ato të telekomunikacioneve ka rritur si gamën, ashtu edhe efikasitetin e këtyre shërbimeve. Investimet në sektorin energjetik kanë stabilizuar furnizimin me energji elektrike.

- Njësoj si në vrojtimin e vitit 2010, tre të katërtat e të anketuarëve u përgjigjën pozitivisht në lidhje me iniciativat e qeverisë shqiptare në aspektet e fillimit të një biznesi dhe licensimit, sigurimit të lejeve të punës dhe rregullores të punësimit. Afërsisht 40 përqind e FIE-ve, në përgjithësi, janë të kënaqura me sistemin tatimor dhe rregulloren e punësimit. Pjesa dërrmuese e kompanive janë shprehur pozitivisht në lidhje me aspektet e kostove të krahut të punës, ndërveprimet me autoritetet vendase dhe aftësive linguistike, të informatikës dhe teknologjisë së informacionit në vend.
- Pjesa dërrmuese e kompanive kanë ardhur në ekspansion gjatë viteve të fundit, 56.6 përqind e tyre kishin më shumë persona të punësuar në vitin 2010 sesa në vitin 2008, 68.1 përqind e tyre kanë një xhiro më të lartë dhe 66 përqind e tyre kanë rritur aksionet në treg. Në vitin 2012, 57 përqind e kompanive rritën nivelet e punësimit, ndërsa 35 përqind e mbajti punësimin në nivel konstant. Afërsisht 85 përqind e kompanive kanë pritshmëri pozitive në lidhje me shtimin e aktivitetit të tyre në Shqipëri.
- Për të ardhmen, komuniteti i biznesit të huaj pret nga qeveria shqiptare përmirësime të mëtejshme të klimës së biznesit përmes thjeshtimit të procedurave administrative, përmirësimit të licensimit dhe përmirësimit të situatës së sundimit të rendit. Gjithashtu, ky komunitet dëshiron të shohë përmirësime të mëtejshme në administratën tatimore dhe infrastrukturë. Në vecanti, ky komunitet ka evidentuar si pengesa ndaj biznesit: nivelin relativisht të lartë

të informalitetit, pabarazi në zbatimin e legjislacionit tatimor për të gjitha bizneset dhe vështirësi për të marrë fatura të regullta, sidomos nga ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme.

Në vitin 2010, ne bujqësi, stoku e IHD-ve përfaqësonte vetëm 0.3 përqind të gjithë stokut së IHD-ve të Shqipërisë dhe 2.1 përqind të stokut të IHD-ve të prodhimit ushqimor, pijeve dhe duhanit. Rrjedhimisht, gjatë hartimit të politikave të saj në lidhje me Investimet e Huaja Direkte në fushën e agrobiznesit, duke përfshirë bujqësinë dhe aktivitetet përkatëse të përpunimit dhe shërbimeve, qeveria shqiptare duhet të përqëndrohet tek impakti zhvillimor i këtyre investimeve dhe jo tek vëllimi i tyre, i cili parashikohet të mbetet i kufizuar.

Me krijimin e fermave dhe rrjeteve të biznesit me produktivitet të lartë dhe konkurrense, parashikohet një ndikim direkt pozitiv i TNC-ve në bujqësi dhe aktivitetet e saj përkatëse. TNC-të mund t'i përfshijnë fermerët shqiptarë *quasi* komercialë në rrjete biznesi, të cilat nga ana e tyre do të kontribuonin në krijimin e mundësive për punësim dhe në përmirësimin e aksesit ndaj financave dhe tregjeve për fermerët e vegjël. Kjo përfshirje mund të rezultojë në transferim të teknologjive, në trainime dhe shkëmbim dijeshe, së bashku me zbatimin e standardeve të prodhimit.

Por, përfshirja e TNC-ve në agrobiznes mund të sjellë edhe ndikime negative, nëse këta të fundit ua marrin tokën fermerëve të vegjël, dhe nxjerrin jashtë loje prodhuesit e vegjël nga tregjet lokale, duke rritur njëkohësisht edhe papunësinë. Sipas të njejtës logjike, degët e supermarkatave të mëdha mund të sigurojnë produkte më të lira nga jashtë duke nxjerrë kështu jashtë loje prodhuesit vendas dhe shitësit e pakicës. Nga ky aspekt, mund të bëhen *parashikime për një mbrojtje provizore për prodhuesit lokalë*. Po kështu, politikat shtetërore mund të mbështesin zhvillimin e fermave të orientuara drejt tregut, rrjetet e prodhimit dhe zinxhirët e vleres, bazuar mbi pjesëmarrjen e prodhuesëve vendas.

Investitorët e huaj luajnë një rol të rëndësishëm në industrinë shqiptare të përpunimit përsa i përket aspekteve të xhiros (22 përqind) dhe atij të punësimit (16 përqind). Ata përbëjnë segmentin më produktiv të kompanive dhe firmave që janë aktivë në këtë industri dhe ky është një avantazh i parashikuar edhe për projektet e perspektivës. Politika shqiptare në lidhje me Investimet e Huaja Direkte mund të targetojë investitorë specifikë që shfaqin interes për përpunimin e prodhimeve bujqësore vendase. Suksesi i këtyre përpjekjeve varet nga përmirësimet në kuadrin e politikave dhe atë institucional për agrobiznesin.

HYRJE

Ky raport ka një qëllim të dyfishtë. Së pari, tu ofrojë investitorëve të huaj, investitorëve potencialë dhe ekspertëve të interesuar, informacionin më të përditësuar në lidhje me zhvillimet dhe ndikimin e investimeve të huaja direkte (IHD) dhe politikave përkatëse në Shqipëri. Së dyti, raporti ka për qëllim tu vijë në ndihmë autoriteteve të vendit për te kuptuar me mire potencialin e IHD-ve në ekonominë shqiptare dhe për ta përdorur këtë informacion më pas gjatë vendim-marrjes së tyre.

Në këtë raport të dytë për Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri (pas një raporti fillestar, UNCTAD dhe PNUD, viti 2011), të gjitha të dhënat janë azhurnuar dhe janë analizuar nga e para. Për ato aspekte që nuk kanë ndryshuar shumë (si p.sh. roli i privatizimit në thithjen e Investimeve të Huaja Direkte), lexuesi mund t'i referohet raportit të mëparshëm. Ky raport ka një fokus të ri të vecantë, që ka të bëjë me situatën e investimeve të huaja direkte dhe zhvillimeve të tyre në agrobiznes (duke përfshirë: bujqësinë dhe ushqimin, pijet dhe industrinë e duhanit). Konkluzionet dhe rekomandimet që lidhen me investimet e huaja direkte në këtë sektor, ndër të tjera, kanë marrë në konsideratë qasjen liberale të qeverisë shqiptare ndaj pronësisë së huaj të tokës që mund të lehtësojë investimet e huaja direkte.

Modelet bazë të investimeve të huaja direkte në Shqipëri janë të lidhura me strukturën e saj gjeo-ekonomiko. Shqipëria është një vend i vogël me 2.8 milionë (sipas regjistrimit të popullsisë të 2011) banorë, ndonëse jo aq i vogël në kontekstin e vet nderajonal e pikërisht në Evropën Juglindore të shumë fragmentuar.¹ Produkti i saj nominal i Brendshëm Bruto (PBB) në vitin 2010, sipas kursit të shkëmbimit të tregut, ishte afërsisht 9 miliardë euro, trefishi i PBB-së së Malit të Zi dhe 50 përqind më i lartë nga

ai i Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë (por vetëm sa një e treta e atij të Kroacisë). Në rastin e thithjes së investimeve të huaja direkte, ka rëndësi masa, sikundërse niveli i zhvillimit dhe pozita gjeografike. Vendet e vogla zakonisht nuk arrijnë të thithin fondet të medha të TNC-ve dhe të industrive që prodhojnë për tregjet e eksportit në shkallë të gjerë. Ndërsa ky aspekt kufizon shkallën deri ku Shqipëria mund të konkurojë me vende më të mëdha (dhe ngjashëm me kosto të ulët) në thithjen e Investimeve të Huaja Direkte të orientuara nga eksportet nga një numër burimesh, ajo me krahun e saj të lirë dhe të motivuar të punës ka një potencial të mirë për tu shndërruar në një qendër prodhimi dhe shërbimesh për eksportet drejt Italisë dhe Greqisë. Po kështu, në bujqësi nuk është vëllimi, por specialiteti dhe kushtet mesdhetare ato që mund të jenë një dritare mundësish për eksporte drejt vendeve që gjenden më në Veri.

Zhvillimi i shpejtë ekonomik dhe integrimi në BE përbëjnë prioritetet kryesore të programit të qeverisë. Politikat kryesore të vendit gjatë viteve të fundit kanë sjellë si rezultat një kuadër të liberalizuar ekonomik dhe kushte të përmirësuara për zhvillimin e biznesit dhe për tërheqjen e investimeve të huaja direkte. Falë progresit në lidhje me shndërrimet ekonomike dhe një mjedisi mbështetës të jashtëm, rritja ekonomike mbeti e shëndoshë gjatë periudhës midis viteve 2000 dhe 2009. Shqipëria siguroi një rritje vjetore mesatare të PBB-së në nivelin 6 përqind gjatë kësaj periudhe. Ngadalësimi i ekonomisë gjatë viteve 2010 dhe 2011 në Shqipëri ishte më pak serioz, krahasuar me vende të tjera të rajonit. Gjithësesi, PBB-ja për frymë sipas indeksit të barazisë së fuqisë blerëse ishte vetëm 25 përqind e mesatares të vendeve të EU-27-ës, më poshtë se Bullgaria – që është vendi anëtar i BE-së me të ardhurat më të ulëta² Ndaj ka

1 Evropa Juglindore përfshin Shqipërinë, Bosnje- Hercegovinën, Kroacinë, Serbinë, Malin e Zi dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

2 "PBB për banor ndryshonte nga një në gjashtë në vendet anëtare të EU27-ës" Deklarata për shtyp e Eurostat-it, 94/2009.

shumë vend për përmirësime, kurse roli i potencialit të investimeve të huaja direkte në transferimin e kapitalit dhe teknologjive është i patjetërsueshëm.

Shqipëria e ka përballuar krizën financiare relativisht mirë. Gjatë periudhës midis viteve 2008-2011 u arritën nivele pozitive të rritjes ekonomike. Faktikisht, gjatë kësaj periudhe, Shqipëria shënoi si mesatare një nga nivelet më të larta të rritjes në Evropë. Argumenti për këtë rezultat të rëndësishëm ka qenë mungesa e forcimit për rebalancim të detyruar të deficitit të llogarisë korrente dhe të deficitit fiskal. Të dy këta deficitë janë të lartë në krahasim me ato të ekonomive të tjera evropiane, por prurjet e kënaqshme të kapitalit të huaj, një pjesë e madhe e të cilit kanë qënë Investime të Huaja Direkte ndihmuan në financimin e deficiteve. Ndikimi i krizës ndërkombëtare ekonomiko-financiare në Shqipëri u zbut gjithashtu nga rëndësia e kufizuar që kishte kanali i eksporteve për të transmetuar krizën në vend, por edhe nga varësia relativisht modeste e Shqipërisë nga tregjet ndërkombëtare financiare. Ndër efektet stabilizuese mund të përmendim gjithashtu kuadrin e politikave monetare, mbikqyrjen e kujdesshme të sektorit bankar dhe kursin fleksibël të këmbimit.

Në raportin e mëparshëm të Investimeve të Huaja Direkte (UNCTAD dhe PNUD 2010) sugjerohej që ngadalësimi i rritjes ekonomike mund të shkonte paralelisht me ngadalësimin e Investimeve Hyrëse të Huaja Direkte. Fatmirësisht, këto pritshmëri dolën të pavërteta: në vitin 2010, investitorët e huaj në Shqipëri ishin ende në fazë ekspansioni, në vecanti në sektorët e përfutur rishtazi përmes privatizimeve apo koncensionëve. Në vitin 2011 si rritja ekonomike, ashtu edhe investimet e huaja direkte u ngadalësuan, por pavarësisht nga një rënie që shkonte përkundër tendencës globale dhe rajonale, prurjet e investimeve të huaja direkte në Shqipëri në vitin

2011 ishin më të larta sesa ato të vitit 2009.

Në këto rrethana sfiduese merr edhe më shumë rëndësi fakti i ndërmarrjes nga ana e qeverisë shqiptare i politikave ekonomike me një theks të posaçëm tek kualifikimi dhe trainimi i krahut të punës, në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe të investimeve ndërkombëtare në vend. Përsa i takon këtyre të fundit, synimi është thithja e një numri më të madh investimesh të reja të huaja direkte, si edhe Investimesh të Huaja Direkte në industrinë që prodhojnë për eksport, ato që përmirësojnë infrastrukturën ekonomike dhe ato që kontribuojnë në rritjen e nivelit teknologjik të vendit. Një qasje liberale ndaj pronësisë së tokës për personat juridikë të regjistruar në Shqipëri, qofshin ata vendas, apo të huaj u mundëson investitorëve krijimin e bizneseve në këtë sektor. Në këtë mënyrë, bujqësia dhe produktet ushqimore mund të kontribuojnë gjithmonë e më shumë ndaj eksporteve apo të ulin varësinë nga importet.

Në kapitujt që pasojnë, ky raport si fillim merr në shqyrtim përvojën e Shqipërisë me investimet e huaja direkte, duke u përqëndruar tek tendencat e prurjeve të IHD-ve në vend, tek rëndësia e tyre për bilancin e pagesave të vendit, tiparet kryesore dhe modelet e IHD-ve hyrëse dhe tek rëndësia relative e aktiviteteve të ndërmarrjeve të investimeve të huaja në ekonominë shqiptare. Në Kapitullin II, si fillim merret në shqyrtim kuadri rregullator dhe mjedisi i biznesit për investimet e huaja direkte në vend, si edhe parashtrihen opsione dhe masa politikash që mund të kontribuojnë në përpjekjet e qeverisë shqiptare për hartimin e një politike më efektive dhe më të orientuar përkrah investimeve të huaja direkte, duke vazhduar me rezultatet e një vrojtimi të kohëve të fundit mbi investitorët e huaj. Në Kapitullin III analizohet roli dhe ndikimi i investimeve të huaja direkte në bujqësi dhe agrobiznes, si edhe kalohet në konkluzione politikash për atë sektor specifik.

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË SHQIPËRI

TENDENCAT MË TË FUNDIT, KARAKTERISTIKAT KRYESORE DHE ROLI I TYRE NË EKONOMINË E VENDIT

A. Rënie e lehtë në vitin 2011, pas disa vitesh ekspansion

Në vitin 2010, ndonëse pjesa dërmuese e vendeve të Evropës Juglindore pësuan rënie të ndjeshme të investimeve të huaja direkte, në

Shqipëri ndodhi e kundërta. Në vitin 2009, Shqipëria përfitoi 717 milionë euro investime të huaja direkte (sipas të dhënave të rishikuara nga Banka e Shqipërisë qysh nga botimi i Raportit për investimet e huaja në Shqipëri në vitin 2010 dhe WIR11 i UNCTAD-IT), ndersa në 2010 prurjet e IHD-ve arritën në 793 milionë euro (tabela I.1)³ Në vitin 2010, Shqipëria renditej e dyta përsa i përket sasisë së prurjeve të IHD-ve midis vendeve të Evropës Juglindore, pas Serbisë. Në vitin 2011, Shqipëria siguroi 742 mil-

TABELA I.1.


Prurjet e IHD-ve: Bota, Evropa Juglindore dhe Shqipëria, 2005-2011 (në milionë Euro)

Ekonomitë pritëse	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Bota	782 673	1 164 682	1 534 682	1 208 931	802 041	936 640	1 085 242*
Evropa Juglindore	3 870	7 885	9 384	8 663	5 446	3 109	4 745*
Shqipëria	213	259	481	665	717	793	742

Burimi: UNCTAD, WIR11 dhe Global Investment Trends Monitor No.8 dhe Banka e Shqipërisë. *UNCTAD-i.

FIGURA I.1

Përqindja e prurjeve të IHD në Shqipëri në krahasim me vendet e Evropës Juglindore dhe me Botën, 1990-2010



Burimi: Sipas të dhënave nga UNCTAD, baza e të dhënave për IHD/TNC (www.unctad.org/IHDstatistics) dhe atyre të Bankës së Shqipërisë

3 Të dhënat e raportuara nga Banka e Shqipërisë (BSH) në bilancin e pagesave janë marrë nga sondazhi vjetor i IHD-ve për periudhën 2008-2010. Të dhënat për vitin 2011 janë paraprake, bazuar në pagesat mujore bankare dhe janë objekt shqyrtimi.

ionë euro si investime të huaja direkte, dicka më pak sesa një vit më parë. Kjo rënie ishte jo vetëm kundër rimëkëmbjes globale, por edhe kundër rritjes së IHD-ve në dy nga vendet më të mëdha të Evropës Juglindore, Kroacia dhe Serbia.

Përqindja e prurjeve të investimeve të huaja direkte të Shqipërisë në totalin e “Botës” mbetet marginale: ajo ishte nën 0.1 përqind (figura I.1), ndonëse sipas të dhënave të UNCTAD-it, prurjet drejt Shqipërisë qysh nga viti 2000 janë dhjetëfishuar. Gjithësesi, pesha e Shqipërisë si vend pritës i IHD-ve në rajonin e Evropës Juglindore është rritur ndjeshëm në vecanti gjatë viteve 2007 dhe 2010, kur prurjet e IHD-ve

në Evropën Juglindore pësuan rënie, ndërsa ato drejt Shqipërisë vazhdonin të rriteshin (tabela I.1, figura I.1). Rënia e investimeve të huaja direkte në vitin 2011 solli rënie në përqindjen e tyre në Shqipëri si nga pikëpamja globale dhe rajonale.

Ndonëse vlera e prurjeve të Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri është modeste për shkak të madhësisë së vogël të ekonomisë së saj, rëndësia e tyre relative për ekonominë shqiptare është goxha e lartë. Raporti i prurjeve të GFCF (formimi bruto i kapitali fiks) -së u rrit nga më pak se 10 përqind në vitin 2006, në 25 përqind në vitin 2009 duke arritur deri në nive-

TABELA I.2


Prurjet e IHD-ve si përqindje e GFCF, vendet e Evropës Juglindore, 2004–2010

Rajoni/vendi	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Evropa Juglindore	16	16	24	33	27	22	13
Shqipëria	13	9	9	16	21	25	33
Bosnje-Hercegovina	27	20	25	46	17	6	2
Kroacia	12	17	27	33	32	19	4
Mali i Zi	56	208	130
Serbia	23	20	15
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	34	10	37	43	28	11	17

Burimi: UNCTAD, WIR11, tabelat e aneksit.

FIGURA I.2

Shqipëria: IHD hyrëse dhe dalëse, 2004–2011 (në milionë Euro)



Burimi: UNCTAD, baza e të dhënave për IHD/TNC, sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë.

4 IHD-të nuk kontribuojnë detyrimsht në GFCF dhe hartimi i dy grupesh të dhënash (një për prurjet e IHD-ve dhe një tjetër për GFCF) ka ndjekur metoda të ndryshme. Ndër të tjera, investimet ndërkuftare M&A janë pjesë e IHD-ve, por nuk përfshijnë investime të reja (të cilat do të shtonin formimin e kapitalit), sa kohë që ato marrin aksione ekzistuese.


lin 33 përqind në vitin 2010 (tabela I.2)⁴. Ky kapërcim i madh në vitin 2010 nuk ishte vetëm rezultat i Investimeve më të larta të Huaja Direkte, por edhe pasojë e një rënieje të ndjeshme në GFCF. Në vitin 2011, kur investimet e huaja direkte shënuan rënie dhe GFCF u rikuperua, raporti i të dyve shkoi sërish në 25 përqind. Në vitin 2010, midis vendeve të rajonit, vetëm Mali i Zi ka thithur më shumë investime të huaja direkte përkundrejt GFCF-së. Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri kanë nxitur rritjen ekonomike, posaçërisht përmes projekteve në shërbime dhe infrastrukturë. Rrjedhimisht, niveli i përgjithshëm i investimeve në Shqipëri përkundrejt PBB-së (33

përqind) ishte shumë më i lartë sesa mesatarja e rajonit (20 përqind) si për vitin 2010 ashtu edhe për vitin 2011.

Ndonëse analiza e këtij raporti përqëndrohet vetëm tek Investimet e Huaja Direkte hyrëse vlen të theksohet se investimet e huaja direkte shqiptare drejt vendeve të tjera kanë qenë modeste gjatë viteve të fundit dhe vecmas të ulta në nivelin e 9 milionë eurove në vitin 2010 dhe 30 milionë eurove në vitin 2011 (figura nr. I.2). Investimet e Huaja Direkte dalëse nga Shqipëria kanë më shumë si objektiv ekonomitë e vendeve fqinje, nëvecanti Kosovën dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

FIGURA I.3

Shqipëria: Bilanci i llogarisë rrjedhëse dhe bilanci i Investimeve të Huaja Direkte (IHD neto) gjatë viteve 2006–2011 (në milionë euro)



Burimi: Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë.

TABELA I.3

Shqipëria: tregues të sektorit të jashtëm, 2006–2011 (në milionë Euro dhe si përqindje e PBB-së)

Treguesit	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Bilanci i llogarisë korrente	-471	-824	-1381	-1321	-1019	-1145
si përqindje e PBB	-6.6	-10.5	-15.6	-15.2	-11.5	-12.5
Eksporti i mallrave	631	786	917	751	1172	1406
Si përqindje e PBB	8.8	10.0	10.3	8.6	13.1	15.3
Bilanci i mallrave	-1659	-2104	-2431	-2304	-2083	-2242
si përqindje e PBB	-23.1	-26.9	-27.4	-26.4	-23.4	-24.4
Eksporti i shërbimeve	1157	1421	1688	1771	1702	1747
si përqindje e PBB	16.1	18.2	19.0	20.3	19.1	19.0
Bilanci i shërbimeve	-32	19	69	174	182	135
si përqindje e PBB	-0.4	0.2	0.8	2.0	2.0	1.5
IHD hyrëse	259	481	665	717	793	742
si % e PBB	3.6	6.1	7.5	8.1	9.0	8.1
IHD dalje	-8	-17	-55	-28	-5	-30
si % e PBB	-0.1	-0.2	-0.6	-0.3	-0.1	-0.3
Bilanci i IHD	250	464	610	689	784	712
si përqindje e deficitit të llogarisë korrente	-53.1	-56.3	-44.2	-51.8	-77.4	-62.2

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT-i; PBB për vitin 2011 e llogaritur tek 9192.6 milionë euro.

Bilanci neto i Investimeve të Huaja Direkte hyrëse dhe dalëse është pozitiv dhe i lartë. Ai ka financuar pothuajse gjysmën e deficitit të llogarisë korrente të vendit gjatë periudhës midis viteve 2006–2009, duke arritur deri në 77 përqind në vitin 2010 (tabela nr. I.3 dhe figura nr. I.3). Ky fakt u bë edhe më i rëndësishëm për arsye se deficitit të llogarisë korrente u trefishua nga viti 2006 dhe 2008. Viti 2010 shënoi një kthesë me një ngushtim të hendekut të llogarisë korrente në 12 përqind të PBB-së (figura I.3), si rezultat i një performace jashtëzakonisht

evropiane.⁵ Kjo renditje e ulët, ndër të tjera vinte si pasojë e një infrastrukture të dobët, mungesave të energjisë elektrike dhe veprimtarive modeste në fushën e kërkimeve shkencore. Sic theksohet në Kapitullin II, në Shqipëri ka patur përmirësime të shpejta pikërisht në ato fusha të infrastrukturës si: furnizimi me energji elektrike dhe rrugët, të cilat ishin evidentuar si pengesa në krahasimet ndërkombëtare. Kompanitë e huaja kanë fituar koncesione për zhvillimin e këtyre shërbimeve dhe kanë përmirësuar ofrimin e tyre dhe rrjedhimisht kushtet për investime të mëtejshme në sektorët e tjerë.

TABELA I.4

Renditja e Shqipërisë sipas Indeksit të Performancës së IHD-ve Hyrëse dhe Indeksit Potencial të IHD-ve Hyrëse, në vite të përzgjedhura

Treguesit	1995	2000	2005	2009	2010
Indeksi i Performancës së IHD-ve hyrëse	39	58	68	23	18
Indeksi Potencial i IHD-ve hyrëse	115	101	83	81	..

Burimi: UNCTAD, WIR11.

Shënim: Viti i fundit për të cilin disponohen të dhëna për disa nga variablat e përfshira në Indeksin Potencial të IHD-ve Hyrëse është viti 2009.

të mirë të eksporteve, shoqëruar më një rritje modeste të importeve. Sipas rezultateve para-prake, në vitin 2011, deficitit të llogarisë korrente u rrit sërish, ndërsa investimet e huaja direkte mund të mbulonin 62 përqind të tij.

Shqipëria qëndron në pozitë relativisht të mirë sipas Indeksit të UNCTAD-it në lidhje me Performancën e IHD-ve hyrëse. Ky indeks mat prurjet e IHD-ve krahasuar me shkallën e ekonomisë. Në vitin 2010, Shqipëria renditej në vitin e 18-të midis 141 vendeve të studimit (tabela nr. 1.4). Kjo përfaqëson një përmirësim të shpejtë nga vendi i 68-të që Shqipëria mbante në vitin 2005. Në vitin 2005, Shqipëria renditej pas Polonisë, ndërsa tani renditet pas Kilit, ekonomia e të cilit renditet ndër të parat në botë përse i përket orientimit për kah Investimeve të Huaja Direkte (UNCTAD, *WIR06* dhe *WIR10*). Ky përmirësim në klasifikim është pjesërisht rezultat i rritjes së shpejtë të prurjeve të investimeve të huaja direkte në vend, kryesisht si reagim ndaj mjedisit të përmirësuar të biznesit dhe mundësive të shpalosura nga privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore.

Klasifikimi sipas Indeksit të Performancës së Investimeve të Huaja Direkte për Shqipërinë është më i mirë se klasifikimi i vendit sipas Indeksit Potencial për IHD-të hyrëse. Në këtë të dytin, në vitin 2009 Shqipëria renditej në vendin e 81-të (viti më i fundit për të cilin disponohen të dhëna), shumë më poshtë vendeve të tjera

B. Karakteristikat e prurjeve të IHD-ve

1. Investimet e Huaja Direkte sipas formave

Investimet e Huaja Direkte mund të marrin formën e kapitalit aksioner, fitime të ri-investuara dhe formave të tjera të kapitalit, duke mbuluar kryesisht huatë nga kompania mëmë. Duke qenë se Shqipëria është në fazat fillestare të përtithjes së Investimeve të Huaja Direkte, pjesa dërrmuese e tyre (afërsisht 80 përqind në vitin 2010 dhe akoma edhe më shumë në vitin 2011) ishin në formën e kapitalit aksioner në biznese të reja si edhe si shtesa kapitali në sipërmarrjet ekzistuese me investime të huaja (tabela I.5). Fitimet e riinvestuara përfaqësojnë afërsisht 20 përqind të investimeve hyrëse, ndërsa Investimet e Huaja Direkte në formë të tjera kapitali (kryesisht intra-company loans) janë zakonisht të papërfillshme dhe në vitet 2009 dhe 2011 ishin negative. Shkembimi i kredive midis kompanive me mardhenie të investimit të huaj, zakonisht ndodh kur kompania mëmë është në situatë të vështirë financiare, sic mund të kishte qenë rasti me investitorët grekë në Shqipëri.

5 Indeksi Potencial i IHD-ve Hyrëse bazohet në 12 tregues, duke përfshirë, ndër të tjera, nivelin e zhvillimit në përgjithësi dhe atë të infrastrukturës, në vecanti (UNCTAD, *WIR02*).

TABELA I.5

Shqipëria: përbërja e prurjeve të IHD-se, sipas formës, 2006–2011 (në milionë Euro)

Komponentët	2006	2007	2008	2009	2010	2011
IHD –Total	259	481	665	717	793	742
Kapital aksioner	199	487	420	516	600	755
Fitime te riinvestuara	0	0	182	229	186	64
Kapital tjetër	60	-6	63	-27	7	-77

Burimi: Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë.

TABELA I.6.

Shqipëria: Pagesat e te ardhurave nga IHD hyrese dhe fitimet e ri-investuara, 2008–2011 (në milionë Euro)

Treguesit	2008	2009	2010	2011
Te ardhura nga IHD-te	197	321	288	81
Te ardhura nga kapitali	10	91	94	14
Te ardhura nga fitime te riinvestuara	182	229	186	64
Te ardhura te tjera	6	1	8	4
Stoku i IHD-ve(inward)	2040	2233	2640	.
Te ardhura nga IHD hyrese si perqindje kundrejt stokut te IHD	9.7	14.4	10.9	.
Fitime te ri-investuara si % nga IHD s	92.4	71.3	64.6	79.0

Burimi: Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë

Të ardhurat e investitorëve të huaj në Shqipëri arritën në 81 milionë euro në vitin 2011, duke shënuar një rënie nga shifra 288 milionë euro e vitit 2010. Ky kontraktim i ndjeshëm mund të reflektojë një farë përkeqësimi në mjedisin e biznesit, si fjala vjen tkurrjen e kërkesës. Fitimet e investitorëve të huaj u korespondonin mbi 10 përqind të stokut të IHD-ve të viteve të mëparshme (tabela I.6) dhe ka gjasa të kenë rënë gjatë vitit 2011. Në vitet 2008 dhe 2009, investitorët në Shqipëri gëzuan nivele të larta përfitimesh, ndër më të larta midis vendeve të Evropës Juglindore (nuk disponohen të dhëna për vitin 2011). Midis vendeve të Evropës Juglindore dhe vendeve të reja anëtare të BE-së nga Evropa Lindore dhe Qendrore, ia kalonin vetëm Republika Çeke dhe Estonia. Të dyja këto vende kanë projekte më të maturuara të Investimeve të Huaja Direkte, që zakonisht kanë më shumë kapacitete dhe më të larta për të siguruar të ardhura sesa projektet e reja. Nga të ardhurat e siguruar nga Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri, 79 përqind e tyre u investua sërish në vitin 2011, duke shënuar një rritje nga 65 përqind që ishte shifra për vitin 2010. Kjo është një shifër e lartë sipas krahasimeve ndërkombëtare dhe përfaqëson një tjetër karakteristikë të projekteve në fazat e tyre të para të konsolidimit.

2. Prurjet e IHD-ve sipas mënyrës së hyrjes dhe aktivitetit ekonomik

Investitorët e huaj hyjnë në një vend në formën e investimeve në biznese të reja apo bashkime dhe blerje ndërkufitare (M&A). Sipas të dhënave të përpiluara nga UNCTAD-i (Kutia I.1) gjatë periudhës 2003–2011, numri i projekteve të reja në Shqipëri ishte 84 (tabela I.7). Gjithësesi duhet theksuar se dyqane të vecanta të një rrjeti supermarketash apo degë lokale të një banke tregëtare shfaqen si projekte të vecanta

Kutia I.1

Përkufizime dhe burime të të dhënave për projektet e reja

Të dhënat në lidhje me projektet e reja IHD që janë përdorur në këtë studim janë të bazuara në informacionin e përpiluar nga UNCTAD-i nga Tregjet e IHD-ve të Financial Times Ltd. Tregjet e IHD-ve ndjekin ndjekin të gjitha projektet e reja në vendet pritëse dhe ekspansionin e investimeve ekzistuese. Ndonëse nuk ka një sasi minimale që të kualifikojë përfshirjen e një projekti, si kritere përfshirjeje në këtë bazë të dhënash, projekti i investimit duhet të krijojë vende të reja pune dhe të sjellë kapital të ri investimi. Burimi i Informacionit për vlerësimin dhe verifikimin e këtyre projekteve përfshin burimet informative të Financial Times, afërsisht 9,000 burime mediash, të dhëna projektsh të siguruar nga mbi 1,000 organizata industriale dhe agjenci investimesh, si edhe të dhëna të prokuruar nga kompani publikimesh dhe kërkimesh tregu. Të dhënat u referohen disa burimeve të ndryshme të informacionit dhe mbi 90 përqind e tyre konfirmohen me burimet e kompanisë në fjalë.

Burimi: UNCTAD, WIR10.

TABELA I.7.**Projektet e reja IHD në Shqipëri: numri dhe angazhimet përsa i përket numrit të vendeve të punës dhe totalit të investimeve, 2003–2011**

Viti	Numri i projekteve	Numri total i vendeve të punës	Totali i investimeve (në milionë dollarë)
2003	9	643	300
2004	7	428	141
2005	13	2 399	668
2006	11	2 196	2 346
2007	8	2 738	4 454
2008	16	3 139	3 505
2009	7	914	124
2010	6	320	68
2011	7	1 311	488
Total	84	14 088	12 094

Burimi: Tregjet e IHD-ve, Financial Times Ltd (www.FDImarkets.com).

TABELA I.8**Shqipëria: Numri i projekteve të reja të Investimeve të Huaja Direkte sipas aktiviteteve të biznesit, 2003–2011**

Aktivitetet	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	Total
Nxjerrje	2					1				3
Manufakturë	3	4	3	1	3	5		1	2	22
Energji elektrike	1			1	3	2				7
Ndërtim			1	1	1			1		4
Shitje, marketing, pakica	1	1	3	5		7	4	2	3	26
Transport, shërbime biznesi	2	2	6	3	1	1	3	2	2	23
Total	9	7	13	11	8	16	7	6	7	84

Burimi: UNCTAD, bazuar në Tregjet e IHD-ve (FDI markets), Financial Times Ltd (www.FDImarkets.com).

investimesh. Viti me numrin më të madh të projekteve të reja ishte 2008 dhe periudha me numrin më të ulët të projekteve të reja ishte 2009-2011. Rrjedhimisht mund të vihet re një rënie e numrit të projekteve të reja gjatë viteve të krizës globale. Gjithashtu, përsa i takon vlerës së projekteve dhe numrit të vendeve të ardhshme të punës, angazhimet më të mëdha shfaqen gjatë viteve 2006–2008, ndërsa u siguruan sasi shumë të vogla gjatë dy viteve në vijim, të pasuara nga një rikuperim i lehtë në vitin 2011.

Numri më i madh i projekteve të reja nisi fillimisht në sektorët e shitjes dhe marketingut, i ndjekur me sektorët e transportit dhe shërbime të tjera biznesi (tabela I.8). Në përgjithësi, numri më i madh i projekteve të investimeve ishte në sektorin e shërbimeve. Sasitë më të mëdha të

fondeve për investime ishin në fushat e energjetikës dhe të prodhimit të materialeve të ndërtimit. Shpërndarja e projekteve sipas kategorive/grupeve tregon se numri më i madh i tyre është në fushat energjetike, ndërtim dhe tregtinë me pakicë. Raportohen katër projekte në fushën ushqimore, të pijeve dhe atë të duhanit, por asnjë në bujqësi.

Investitori më i madh, me sasinë më të madhe të fondeve të investuara në projekte të reja është kompania e cimentos Titan Cement, një kompani greke, e cila celi fabrikën e dytë në vitin 2011. Një tjetër investitor i madh është firma e ndërtimit Moncada Costruzioni (Moncada Energy Group) nga Italia. Dyqantit ushqimor italian, të tipit kooperativë iu shtua një konkurrent në sektorin e pakicës, kompania franceze Carrefour. 29 përqind e projekteve të reja të Investi-

meve të Huaja Direkte vijnë nga Italia, 7 përqind nga Shtetet e Bashkuara, 6 përqind nga Greqia, Turqia dhe Italia vecmas. Projekti më i madh i ri i shpallur në vitin 2010 ishte projekti Hidroelektra Niskogradnja nga Kroacia, në sektorin e ndërtimit. Projekte më të vogla në fushën e shërbimeve erdhën nga Austria, Bosnje-Hercegovina dhe Serbia. Në sektorin e naftës u shpallën dy projekte të reja, një nga kompania e kërkim-zhivillimit, Sonoro nga Kanadaja dhe një tjetër nga një kompani zvicerane që ndërton tubacione.

Futja e Investimeve të Huaja Direkte (Burimi METE) përmes blerjeve ndërkuftare (cross-border M&A) në një ekonomi në tranzicion si ajo shqiptare zakonisht ndodh përmes privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore. Ka patur një prurje të madhe investimesh të huaja direkte në Shqipëri përmes procesit të privatizimit, duke përfshirë privatizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME) në një numër industrish, si edhe përmes privatizimit të ndërmarrjeve të mëdha në

edhe mbi arritjet kryesore). Përbërja sektoriale e Investime të Huaja Direkte hyrëse në Shqipëri pësoi disa ndryshime të rëndësishme gjatë viteve 2006–2011, për të cilën periudhë disponohen të dhëna. Si fillim, pati një rritje të shpejtë të investimeve në industri (duke përfshirë minierat dhe manufakturën) (tabela I.9).

Në vitin 2011, Investimet e Huaja Direkte hyrëse u rritën vetëm në sektorët e energjetikës dhe të gazit, si edhe në shpërndarje dhe shërbime të tjera, ndërsa shënuan rënie në të gjithë aktivitetet e tjera, në krahasim me një vit më parë. Disa luhatje gjatë një periudhe gjashtë vjecare pasqyrojnë marrëveshjet e rëndësishme të privatizimeve si p.sh. në telekomunikacione. Privatizimi i kompleksit të rafinerisë së naftës, me emrin ARMO për një shumë prej 125 milionë eurosh ishte faktori kryesor që çoi në një rritje të madhe të investimeve të huaja direkte në manufakturë në vitin 2008. Në vitet që pasuan, Investimet e Huaja Direkte në fushën e naftës,

TABELA I.9.

Albania: Shqipëria: Investimet e Huaja Direkte hyrëse sipas aktivitetit kryesor ekonomik (në milionë Euro)

Aktivitetet	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Bujqësi, gjueti, peshkim	2	2	-54	-9	0	-
Ndërtim	8	51	147	19	44	-
Industri ^a	69	56	369	300	394	351
Energji elektrike dhe gaz	0	4	2	143	88	103
Telekomunikacionet	62	196	-61	84	97	67
Ndërmjetësim financiar	30	136	167	120	138	110
Shpërndarja, shërbime të tjera	88	25	95	59	33	111
TOTAL	259	480	665	717	793	742

Burimi: Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë.
a Të përcaktuara si industri nxjerrëse dhe perpunuese.

industritë strategjike (si p.sh. bankat, telekomunikacionet dhe energjetika), të cilat kanë futur në lojë TNC-të. Ka qenë kryesisht privatizimi i ndërmarrjeve të industrive strategjike që ka siguruar prurje të larta të investimeve të huaja direkte gjatë disa viteve. Gjatë viteve 2004–2008, 24 përqind e gjithë investimeve të huaja direkte ishin rezultat i privatizimeve; në vitin 2009, kjo përqindje arriti deri në 26 përqind.⁶ Gjatë viteve 2010 dhe 2011 nuk pati asnjë marrëveshje të re privatizimi. (Shih Kapitullin II mbi politikat e privatizimit dhe të koncensioneve të qeverisë, si

gazit dhe metaleve u rritën në kuadrin e koncensioneve që iu dhanë TNC-ve (shih kapitullin II). Pjesa më e madhe e investimeve të huaja direkte shkuan në sektorin e shërbimeve, kryesisht në pjesën e ndërmjetësimit financiar. Niveli i lartë i Investimeve të Huaja Direkte në shërbimet financiare në vitin 2008 ishte rezultat i blerjes së aksioneve të Bankës Popullore dhe Union Bank nga investitorë të huaj. Qysh nga ajo kohë, Investimet e Huaja Direkte në sektorin e ndërmjetësimit financiar ka rënë, kryesisht si pasojë e ndikimit të krizës financiare evropiane.

Lloji i Investimeve të Huaja Direkte që kanë hyrë në Shqipëri deri tani është përqëndruar kryesisht tek prodhimi i shërbimeve për tregun vendas. Por investime hyrëse pati gjithashtu edhe

⁶ Sipas të dhënave të BSH për prurjet e IHD-ve dhe ato të Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës, si edhe Ministrisë të Financave për prurjet e IHD-ve nga privatizimet.

në sektorët e manifakturës, minierave dhe energjetikës, disa prej të cilave gjithashtu siguruan edhe eksporte. Nga këndvështrimi i bilancit të pagesave, për Shqipërinë do të ishte e favorshme thithja e më shumë Investimeve të Huaja Direkte që gjenerojnë eksporte dhe shërbime, përveç sigurisht shërbimit të tregut vendas.

C. Karakteristikat kryesore të rezervës së IHD-ve në Shqipëri

1. Shkalla dhe përbërja e stokut të IHD-ve

Sipas rezultateve të vërtetimit më të fundit të Bankës së Shqipërisë mbi ndërmarrjet e investimeve të huaja (FIE) (Kutia I.2), në vitin 2010, stoku i IHD-ve hyrëse në Shqipëri arriti shifrën 2,640 milionë euro. Ky nivel është 18 përqind përmbi nivelin e një viti më parë dhe

45 përqind më lart se në vitin 2007. (Rezerva e IHD-ve dalëse të Shqipërisë mbërriti në 115 milionë euro në vitin 2010, që me fjalë të tjera do të thoshte që nuk kishte asnjë ndryshim nga një vit më parë).

Midis më shumë se një mijë FIE-ve të përfshira në vërtetimin e Bankës së Shqipërisë, 77 përqind e tyre në vitin 2010 ishin kryesisht në pronësi të huaj. Përsa i takon madhësisë së kompanive, 31 përqind e tyre ishin të ndërmarrjeve të vogla dhe 19 përqind të mesme. Nga një këndvështrim rajonal, 73 përqind e kompanive ishin të regjistruara në Shqipërinë Qendrore dhe pjesa tjetër ishte e shpërndarë në prefektura të tjera të vendit me përqindje pothuajse të barabartë.

Stoku i kapitalit të IHD-ve ndryshonë për shkak të hyrjeve të reja, të përfundimit të investimeve të meparshme dhe si rrjedhojë e lëvizjeve të kursit të këmbimit, ndërsa të dhënat

TABELA I.10.

Shqipëria: Përbërja e ndryshimit të stokut të IHD-ve, 2010 (Në milionë Euro)

Treguesit	Pozita në fund të viti 2009	Transaksionet	Ndryshimet në cmime	Ndryshimet në kursin e këmbimit	Ndryshime të tjera	Pozita në fund të vitit 2010
Investimet direkte në Shqipëri	2,233	793	0	-58	-329	2,640
Kapital aksioner dhe fitime të riinvestuara	2,148	786	0	-57	-328	2,550
Kapital tjetër	86	7	0	-1	-2	90

Burimi: Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë.

Kutia I.2 Mbledhja e të dhënave për IHD-të dhe aktivitetet e TNC-ve në Shqipëri

Të dhënat mbi prurjet dhe stokun e IHD-ve për periudhën 2008-2010 janë nxjerrë nga vërtetimi vjetor i Bankës së Shqipërisë për kompanitë, me së paku 10 përqind pronësi të huaj. Të dhënat për prurjet e IHD-ve, sipas aktiviteteve, për vërtetimin e vitit 2011 (të dhënat janë marrë për vitin 2010) janë objekt i shqyrtimeve të vërtetimit tjetër të IHD-ve. Nga 2300 FIE aktive në regjistrin statistikor të biznesit, Banka e Shqipërisë ia doli të mblidhte të dhëna për pothuajse 1060 sipërmarrje të IHD-ve, duke përfshirë edhe ato më të rëndësishmet. Rezultatet i bënë të mundur Bankës së Shqipërisë të azhurnonte statistikën mbi prurjet e IHD-ve dhe sigurimin e të dhënave për stokun e IHD-ve sipas karakteristikave të ndryshme. Paralelisht me vërtetimin e Bankës të Shqipërisë, INSTAT-i organizon një vërtetim strukturor të biznesit (ASN) që mbulon të gjitha kompanitë aktive që operojnë në vend. Nga rezultatet e këtij vërtetimi, INSTAT-i siguron të dhëna për ndërmarrjet e investimeve të huaja, për të gjeneruar më pas statistika në lidhje me karakteristikat e filialeve të huaja të cilat merren në shqyrtim më poshtë (pjesa D).

Burimi: Banka e Shqipërisë.

e monedhës kombëtare konvertohen sipas kursit të këmbimit të ditës së fundit të vitit; gjithashtu, ka edhe ndryshime të tjera që përfaqësojnë ndryshimet në lidhje me vlerat e stokut së kapitalit. Në Shqipëri, investimet hyrëse sollën një rritje të vlerës së stokut me 793 milionë euro në vitin 2010, por ndryshimet në zërin e “ndryshime të tjera” dhe në kursin e këmbimit çuan në rënie të stokut përkatësisht me 329 dhe 58 milionë euro (tabela I.10).

Shqipëria ka stokun e kapitalit më të ulët të IHD-ve përkundrejt PBB-së midis vendeve të Evropës Juglindore (tabela 1.11), gjë që është shumë e ndryshme nga madhësia relative e prurjeve të IHD-ve duke nisur qysh nga viti 2008. Kjo si pasojë e faktit që Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri janë një fenomen i kohëve

TABELA I.11.

Stoku i kapitalit të IHD-ve hyrëse si përqindje e PBB në Shqipëri dhe vendet e tjera të Evropës Juglindore, 2004–2010

Vendet	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Shqipëria	11	12	15	23	22	29	37
Bosnje Hercegovina	28	28	33	44	39	45	43
Kroacia	31	33	56	77	45	57	57
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	41	36	42	46	42	48	48
Mali i Zi	74	124	138
Serbia	35	44	47

Burimi: UNCTAD, WIR11, tabelat e Shtojcave

të fundit dhe pjesa më e madhe e stokut është akumuluar vetëm gjatë viteve të fundit, ndërsa vendet e tjera kanë përfituar Investime të tilla për periudha më të gjata kohore. Gjithashtu, krahasuar me fqinjët e rajonit, Shqipëria ka shënuar një rritje më të shpejtë ekonomike, gjë që nga ana e vet ka ulur magnitudën e Investimeve të saj të Huaja Direkte sipas treguesve të PBB-së.


2. Stoku i kapitalit të IHD-ve, sipas aktiviteteve kryesore ekonomike

Përbërja e stokut të IHD-ve pësoi ndryshime të qenësishme gjatë viteve 2008-2010. Në vitin 2008 ishte sektori i shërbimeve që domi-

nonte me 66 përqind totalin e stokut të IHD-ve; kjo përqindje ra në 58 përqind në vitin 2010. Gjatë të tri viteve, stoku e IHD-ve për shërbimet mbeti pothuaj i pandryshuar, ndonëse shënoi ekspansion në disa aktivitete të tjera ekonomike. Dhe përfituesi kryesor ishte sektori minierar. Përqindja e investimeve të huaja direkte për sektorin e minierave u dhjetëfishua gjatë tri viteve, nga një shifër e papërfillshme në afërsisht 13 përqind të stokut të IHD-ve. (Ky është rezultati i politikave koncensionare të qeverisë shqiptare, i cili parashtrahet më poshtë në Kapitullin II.) Zhvillime të ngjashme u shënuan në sektorin energjetik, ku përqindja u rrit nga më pak se 1 përqind që kishte qenë në vitin 2008 në afërsisht 5 përqind në vitin 2010.

FIGURA I.4.

Shqipëria: Stoku i kapitalit të IHD-ve hyrëse sipas aktiviteteve ekonomike, 2008-2010 (në përqindje)



Burimi: Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë

Telekomunikacionet kanë qenë një ndër aktivitetet më dinamike të shërbimeve në Shqipëri. Ato morrën zhvillim kryesisht përmes privatizimeve dhe investimeve pasuese të investitorëve të huaj dhe në një farë mase edhe falë investimeve vendase. Por IHD-të në këtë sektor pësuan rënie gjatë viteve të mëvonshme dhe përqindja e tyre në totalin e rezervës së IHD-ve ra në 15 përqind në vitin 2010. Në maj të vitit 1996 në Shqipëri u fut kompania e parë celulare nga Albanian Mobile Communication (AMC), asokohe kompani shtetërore. Në vitin 2009, 85 përqind e aksioneve të AMC-së iu shitën konsorciumit Cosmote (Greqi)-Telenor (Norvegji). Në qershor të vitit 2001, Vodafone Albania, filial i kompanisë Vodafone (Mbretëria e Bashkuar) ishte kompania e dytë celulare që mori licencën për të operuar në Shqipëri. Kompania e tretë celulare, Eagle Mobile, hyri në treg në muajin tetor të vitit 2008, ndërsa kompania e katërt një joint venture midis kompanive shqiptare dhe zyrës së Post & Telekomunikacionit të Kosovës mori licencën në vitin 2009. Operatori i telefonisë fikse, Albtelekom sh.a. u privatizua nga Calik Enerji Telekomunikasyon (Turqi) dhe nga partneri i vet Turk Telekom. Si rrjedhojë e investimeve pas privatizimeve, si edhe e investimeve nga operatorët e rinj në treg, numri i lidhjeve në telefoninë fikse në Shqipëri u rrit me 30 përqind duke shkuar në 360,000 abonentë, ndërsa numri i abonentëve të telefonisë celulare u trefishua duke mbërritur në mbi 4.16 milionë abonentë midis viteve 2005 dhe 2009. Ky nivel i penetrimit të telefonisë celulare është i ngjashëm me atë të vendeve të zhvilluara si p.sh. Gjermania. Me përhapjen e internetit të lëvizshëm, mungesa e lidhjeve nga linja fikse e humbet rëndësinë.

Industria e shërbimeve financiare është përfshirë gjithashtu nga ndryshime gjithëpërfshirëse si rrjedhojë e Investimeve të Huaja Direkte. Hyrja e bankave të huaja gjatë viteve 2000 dhe blerja e bankave vendase e konsoliduan sistemin bankar. Nga fundi i muajit dhjetor të vitit 2008, kapitali i huaj në sistemin bankar shqiptar llogaritej të ishte rritur në 50.3 miliardë Lek apo me 91.8 përqind të totalit (nga 88.8 përqind që ishte shifra në fund të vitit 2007), ndërsa kapitali vendas llogaritej të kishte pësuar një rënie në 4.5 miliardë Lek ose 8 përqind të totalit (sipas Bankës të Shqipërisë, viti 2009). Investitorët më të mëdhenj të huaj në sektorin bankar shqiptar janë austriakët (Raiffeisen International Bank), grekët (National Bank of Greece, Alpha Bank Greece, Emporiki Bank of Greece), Turqia (Calik Sekel) dhe Italia (Banca Veneto, Intesa San Paolo). Në vitin 2009, bankat greke kon-

trollonin afërsisht 30 përqind të tregut bankar në Shqipëri. United Bank of Albania është 4 përqind në pronësi të qeverisë shqiptare; ndërsa pjesa tjetër janë investitorë financiarë arabë.

Në përgjithësi, bankat e huaja duket të kenë patur një influencë pozitive mbi efikasitetin dhe stabilitetin e sistemit bankar të ekonomisë. Ato kanë fuqizuar manaxhimin e riskut dhe qeverisjen e korporatave përmes një akordimi më efikas të kapitalit dhe rritjes së konkurrencës, si edhe kanë futur shërbime financiare më të sofistikuar. Si rezultat, industria bankare është zgjeruar me shpejtësi, duke mbështetur kështu zhvillimin ekonomik, ndërsa deri në vitin 2008 huatë e këqia pësuan një rënie. Tashmë janë prezantuar shërbime bankare të reja dhe më moderne. Megjithatë, karakteristikat e përgjithshme pozitive sipas standardeve ndërkombëtare bankare nuk i plotësojnë ende të gjitha nevojat ekonomisë shqiptare. Aksesit i SME-ve në sektorin financiar bankar mbetet ende i kufizuar, ndërsa ekziston nevoja e përmirësimit të skemave të garantimit të kredive.

Kohët e fundit, transmetimi i efekteve të krizës ndërkombëtare financiare përmes kanaleve të marrëdhënieve bankare ka krijuar shqetësime në Shqipëri, ashtu sikundër edhe në vendet e tjera të Evropës Juglindore. Megjithatë, në Shqipëri, industria bankare është “në formë të mirë” jo vetëm për shkak të privatizimeve të saj dhe përfshirjes së bankave të huaja, por edhe si pasojë e politikave monetare që kanë siguruar mbështetje në kohë përmes dy uljeve të përqindjes së interesit të Bankës Qendrore dhe për shkak të injektimit të likuiditetit në ekonomi. Një sistem i kujdesshëm mbikqyrjeje dhe rregulator bënë të mundur që bankat ta përballonin krizën në gjendje të mirë. Këto masa u ndihmuan edhe nga mbështetja e siguruar nga bankat e huaja mëna (sipas FMN-së, viti 2010). Por në vitet 2010 dhe 2011, përqindja e huave të këqia u rrit dhe numri i kredive të reja për sektorin e biznesit pësoi rënie. Kushtet e kredive janë bërë më të ngurta dhe sektori privat ka patur vështirësi në realizimin e detyrimeve të veta. Në përgjithësi pati një përkeqësim të “business sentiment” ndërsa sektori i ndërtimit u detyrua të rrudhej. IHD-të e reja në sektorin bankar janë ende të qenësishme, por janë ndjeshëm më të ulëta sesa përpara vitit 2008.

Ndër përfituesit më të rëndësishëm të IHD-ve gjatë vitit 2007 ishin tregëtia me shumicë dhe me pakicë, por përqindja e tyre si total i IHD-ve erdhi në rënie në vitet në vijim. Rrjetet evropiane

të supermarkatave që dominojnë sektorin e pakicës në vendet e reja anëtare të BE-së janë në fazat e para të ekspansionit në Shqipëri. Përvec grupit METRO Group (Gjermani), që ka investuar në një dyqan shumice në Shqipëri, supermarkata ushqimore italiane, e quajtur Conad është firma më e rëndësishme e huaj që operon në shërbimet e tregëtisë me shumicë dhe pakicë.


Aktivitetet në pasurinë e paluajtshme sipas filialeve të huaja gjithashtu mbeten marginale, duke u përgjigjur për vetëm 2 përqind të IHD-ve. Disi më me peshë ka qenë zhvillimi i “aktivitetëve të tjera të biznesit” duke përfshirë konsulencën, IT dhe call centre-s, të cilat përbënin afërsisht 4 përqind të rezervës së IHD-ve në vitin 2010. Qysh nga viti 2007 proceset e biznesit dhe shërbimet e teknologjisë së informacionit kanë pësuar rritje dhe mund t'i presë një perspektivë pozitive edhe në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Afërsia me Italinë dhe aftësitë e mira gjuhësore në këtë gjuhë tek një pjesë në rritje e popullsisë së vendit kanë bërë të mundur mbërritjen në Shqipëri të kompanive italiane të cilat kanë ngritur qendra për mbështetjen e biznesit dhe “call centres”. Ndër pionierët në këtë aspekt është grupi italian Answer Group dhe Tele performance. Ndër faktorët e rëndësishëm për rritjen e mëtejshme të shërbimeve të biznesit janë evidentuar trainimi i krahut të punës, si edhe shërbime më të mira të telefonisë fikse. Industria

e hotelarisë dhe restoranteve përbën 1 përqind të stokut të IHD-ve, ndonëse Shqipëria ka potenciale të mira natyrore për thithjen e turizmit. Investimet janë të pakta në fushën e shërbimeve juridike dhe të konsulencës, prania e të cilave do të ishte e nevojshme për investitorët. Investimet e Huaja Direkte në këto shërbime mund të zgjerohen, me shtimin e kërkesës përkatëse.

Një detajim i hollësishëm i stokut të IHD-ve në manifakturë flet për predominancën e industrive me kapital intensiv. Dega e manifakturës që ka stokun më të madh të IHD-ve është prodhimi i produkteve minerare jometalike (materiale të ndërtimit) (figura 1.5). Ajo pasohet nga produktet e naftës bazuar në burimet natyrore vendase. Një objektiv tjetër i rëndësishëm për investimet, ai i prodhimit të metaleve bazë dhe të parafabrikuara gjithashtu përdor xeherorët vendas. Një industri tjetër ku investimet e huaja direkte janë relativisht të larta është prodhimi i ushqimeve dhe pijeve. Ajo bazohet në materiale importi, si edhe në lëndë të parë vendase. 16 përqind e stokut të IHD-ve në manifakturë është investuar në prodhimin e tekstileve dhe lëkurës, në aktivitetet që përdorin intensivisht fuqinë punëtore me potencial të mirë për eksport. Industritë e teknologjive më të avancuara, si fjala vjen prodhimi i makinerive elektrike dhe automjeteve mungojnë pothuajse plotësisht jo vetem midis objektivave të investimit, por edhe në ekonominë shqiptare në tërësi.

FIGURA 1.5.

Shqipëria: Stoku i kapitalit të IHD-ve hyrës në manifakturë, sipas industrive, 2008-2010 (në përqindje)



Burimi: Sipas të dhënave të Bankës të Shqipërisë

3. Stoku i kapitalit te IHD-ve sipas vendit të origjinës së investitorit

Si zakonisht në rastin e vendeve të vogla, Shqipëria e siguron një pjesë të madhe të IHD-ve të saj nga një vend fqinj, që është Greqia (tabela I.12 dhe figura I.6). Në vitin 2010, Investimet e Huaja Direkte nga Greqia përbënin 27 përqind të stokut të IHD-ve, duke shënuar një rënie me pesëmbëdhjetë pikë përqindjeje nga tri vite më parë. Kriza e thellë e borxheve greke që sfidoi stabilitetin financiar të kompanive dhe bankave më të mëdha ka gjasë të ketë luajtur rol këtu. Gjithashtu ka rëndësi të theksohet se IHD-të në Shqipëri janë diversifikuar në aktivitete ku investitorët grekë nuk kanë avantazhe specifike sipas firmave dhe kompanive që punojnë në vend. Investimet e Huaja Direkte greke janë të përqëndruara tek telekomunikacionet dhe ndërmjetësimi financiar, ku stoku i kapitalit ra edhe më për shkak të privatizimeve të huaja. Rënia e

15 përqind të stokut të kapitalit në vitin 2010, duke shtuar nga tri pikë përqindjeje në tri vite. Investimet që e kanë origjinën nga Italia përqëndrohen kryesisht në manifakturë dhe prodhim. Ndonëse ato janë të pranishme edhe në sektorin e shërbimeve, kryesisht në ndërmjetësim financiar, financat mbeten të nën-përfaqësuara midis IHD-ve italiane në Shqipëri, në krahasim me IHD-të nga vende të tjera madhore investitore. Një vecanti tjetër e investimeve italiane është se midis këtyre investitorëve ka shumë firma të vogla dhe të mesme.

Austria është vendi i tretë më i rëndësishëm sipas burimit të IHD-ve, me 14 përqind në vitin 2010, me një rritje prej gjashtë pikë përqindjeje qysh nga viti 2007. Pothuajse të gjitha investimet austriake janë të përqëndruara në sektorin bankar, kryesisht si rezultat i blerjes së Bankës së Kursimeve të Shqipërisë nga kompania Raiffeisen International, që është banka më e madhe

TABELA I.12.

Stoku i kapitalit te IHD-ve në Shqipëri sipas rajonit/vendit të origjinës, 2005–2010 (përqindje e totalit)

Rajoni/vendi	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Vendet e zhvilluara	85	88	82	81	82	82
Bashkimi Evropian	78	79	70	69	70	67
Nga ku:						
Austria	5	9	8	9	10	14
Gjermania	3	3	3	3	3	3
Greqia	55	53	42	34	30	27
Italia	12	11	12	16	16	15
Amerika e Veriut	6	7	4	5	7	12
Nga ku:						
SHBA	4	4	4	4	2	1
vendet/rajonet në zhvillim	12	10	16	16	16	15
Afrika	0	0	0	0	0	0
Amerika e Jugut	-	-	-	-	-	-
Azia dhe Oqeania	12	10	16	16	16	15
Libani	3	2	2	2	2	1
Turqia	6	6	8	9	10	11
Evropa Juglindore	3	2	2	2	2	1
Organizatrat ndërkombëtare	0	0	1	1	1	1

Burimi: Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë

investimeve të huaja direkte greke solli uljen e përqindjes të vendeve të tjera anëtare të BE-së si pjesë e stokut të IHD-ve në Shqipëri nga afërsisht 80 përqind në vitin 2006 në 67 përqind në vitin 2010; vendin e IHD-ve greke e kanë zënë ato turke.


Vendi i dytë më i madh përse i përket burimit të IHD-ve në Shqipëri është Italia, me

në Shqipëri, me 30 përqind të aseteve bankare të vendit (viti 2009). Në vitin 2010, sipas investimeve, në vendin e katërt renditej Kanadaja, kryesisht prej Bankers Petroleum Ltd., një kompani me qendër në Kanada e specializuar në kërkimet dhe prodhimin e naftës dhe gazit, që krijon rezerva të mëdha naftë dhe gazi në vend. Rëndësia e investitorëve turq gjithashtu ka ardhur në rritje, nga 8 përqind në vitin 2007 në 11 përqind


FIGURA 1.6.

Shqipëria: shpërndarja gjeografike e stokut të kapitalit të IHD-ve hyrëse sipas vendit të origjinës së investitorit , 2007 dhe 2010

2007



2010



Burimi: Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë

ind në vitin 2011. Investitorët nga Turqia janë të pranishëm në një numër aktivitetesh. Investitorët gjermanë, hollandezë dhe zviceranë që zakonisht renditen mes pesë të parëve për nga rëndësia në vende të tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore në Shqipëri luajnë një rol marginal. Prania e tyre e kufizuar mund jetë për shkak të mungesës relative të mundësive për investime nga ndermarjet e teknologjise se mesme dhe te avancuara .

Për shkak të mungesës së stabilitetit financiar të ekonomive të burimeve kryesore të IHD-ve, në Shqipëri ndjehet nevoja e përpjekjeve për diversifikim ndaj burimeve të reja të IHD-ve. Por Shqipëria mund të përfitojë gjithashtu edhe nga largimi eventual i kapitalit nga Greqia, në rast se kompanitë largohen nga Greqia për shkak të uljes së kërkesës dhe rritjes së barrës tatimore.

D. Efektet e IHD-ve: roli i filialeve të huaja në ekonominë shqiptare

Në këtë seksion merren në konsideratë disa karakteristika të rëndësishme të filialeve të huaja, me së paku dhjetë përqind pronësi të huaj, të ashtu-quajtura ndërmarrje të investimeve të huaja (FIE) (Kutia I.3), për të kuptuar kontributin e tyre në ekonominë shqiptare.

Nga viti 2007 deri në vitin 2010 u shënuan një rritje e ndjeshme në përqindjen e FIE-ve në ekonominë shqiptare (figura I.7). Ky ndryshim ishte më i theksuar në lidhje me investimet dhe xhiron, ndërsa përsa i përket punësimit rritja ishte e vogël. Ky element ishte vecmas i dukshëm në rastin e punësimit në sektorin e manifakturës, ku përqindja e FIE-ve ishte e pandryshuar, ndër-

Kutia I.3

Të dhëna për ndërmarrjet e investimeve të huaja

Të dhënat për ndërmarrjet e investimeve të huaja janë grumbulluar nga INSTAT-i, në kuadrin e Vrojimit Strukturor për Biznesin (SBS) që është shumë i ngjashëm me atë të Bankës së Shqipërisë (BSH) në lidhje me statistikat e IHD-ve (shih Kutinë I.2.). Të dy këto vrojtime mbulojnë ndërmarrje me 10 përqind ose me shumë pronësi nga një investitor i huaj (FIE). Të dhënat janë grupuar sipas aktiviteteve ekonomike, sipas klasifikimit të NACE-s (Nomenclature Générale des Activités Économiques dans les Communautés Européennes), në nivel dyshifror. Megjithatë, mbulesa sipas aktivitetit ekonomik është e pjesshme dhe lë jashtë ndërmarrje që janë aktive në bujqësi, ndërmjetësim financiar, arsim, shëndetësi dhe aktivitet kulturor. Të dhënat u peshuan njësoj si të dhënat e tjera të SBS-së; kështu arrihet të bëhet krahasim që lejon llogaritjen e përqindjes së ndërmarrjeve të investimeve të huaja (FIE) në ekonominë shqiptare, sipas treguesvë të ndryshëm që mbulon nga SBS-ja.

Burimi: INSTAT

sa kishte një rritje në aspektin e xhiros.

Numri i FIE-ve mbetet marginal në krahasim me numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve: vetëm 2.1 përqind e numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve aktive në vitin 2010 kishin investime të huaja (figura I.7). Megjithatë, kjo shifër është më shumë se dyfishi i shifrës së vitit 2007. Përqindja është më e lartë në sektorin e manifakturës (5.3 përqind në vitin 2010). Në disa aktivitete, numri i ndërmarrjeve është i vogël në terma absolute, por një pjesë më e lartë sesa numri mesatar i tyre janë FIE. FIE-të përbëjnë një përqindje të madhe të kompanive të nxjerrjes së naftës (më shumë se gjysma), në prodhimin e pajisjeve të tjera të transportit, makinerive elektrike dhe produkte të naftës, si edhe në sektorin energjetik dhe atë të gazit (më shumë se

një e treta, figura I.8). Këto janë aktivitete me intensitet shumë të lartë kapitali, ku SME-të, në përgjithësi me pronësi vendase, janë të rralla. Në aktivitete të tjera, si p.sh. tregëtia me pakicë apo hotelet dhe restorantet, SME-të vendase janë të shumta në numër dhe dominojnë.


Përqindja e FIE-ve në ekonominë shqiptare është shumë më e madhe përsa i përket të gjithë treguesve të tjerë, të ndryshëm nga numri i ndërmarrjeve (figura I.7). Kjo pasqyron faktin që filialet e huaja janë më të mëdha, si përmasa; kanë më shumë të punësuar dhe një xhiro më të lartë për ndërmarrje sesa kompanitë në pronësi vendase. Shkalla më e madhe dhe më shumë pushtet ekonomik janë elemente pozitive që i shtohen strukturës ekonomike vendase, por ato mund të cojnë në një konkurrencë të pabarabartë me firmat vendase, në vecanti me SME-të. Përbërja sektoriale e filialeve të huaja ndryshon nga ajo e ndërmarrjeve shqiptare. Tipari kryesor dallues është përqindja e lartë e filialeve të huaja në sektorin e manifakturës, pavarësisht nga përqindja relativisht e vogël që zë sektori i manifakturës në të gjithë rezervën e investimeve të huaja direkte.

Përsa i përket **punësimit**, përqindja e FIE-ve është 18 përqind për të gjithë ekonominë në tërësi, por shumë më e lartë në manifakturë (39 përqind) (figura I.7). Përqindja e punësimit është relativisht e vogël në krahasim me përqindjen e xhiros që është shenjë e prodhimitarisë më të lartë të krahit të punës së sektorit të huaj. Një numër më i lartë investimesh të huaja direkte mund të rezultojë në xhiro më të lartë dhe produktiviteti më të lartë të krahit të punës, por jo domosdoshmërisht në nivele më të larta punësimi. Përsa i përket produktivitetit të krahit të punës, në sektorin e huaj në krye qendrojnë industritë me aktivitete intensive kapitali, si p.sh. mineralet jo-metalike, metalet bazë dhe makineritë në përgjithësi. Të gjitha këto tipare pozitive të sektorit të huaj mbështesin politikat shtetërore të orientuara drejt IHD-ve në manifakturë. IHD-të në këtë sektor mund të ndikojnë në vecanti në nxitjen e zhvillimit. Problem i përthithjes së kompanive vendase nuk ekziston duke qenë se ato ose mungojnë ose luajnë një rol të kufizuar në disa industri. Por duhet të ketë rregullore uniforme, për të siguruar konkurrencë të ndershme dhe njohjen e rregullave të saj.

Xhiroja e filialeve të huaja përfaqëson 29 përqind të totalit, por në sektorin e manifakturës kjo shifër është shumë më e lartë, 51 përqind (figura I.7). Të dyja përqindjet janë me 1-2

FIGURA 1.7.


Përqindja e ndërmarrjeve të investimeve të huaja në ekonominë shqiptare, si total dhe në sektorin e manufakturës në aspektin e numrit të ndërmarrjeve, punësimit, xhiros dhe shpenzimeve për investime 2007–2010 (në përqindje)



Burimi: Sipas të dhënave të INSTAT-it

FIGURA 1.8.

Përqindja e ndërmarrjeve të investimeve të huaja në sektorin e manufakturës në Shqipëri sipas treguesit dyshifror të NACE-s, përsa i takon numrit të ndërmarrjeve, punësimit dhe xhiros, 2010 (në përqindje)



Burimi: INSTAT, Vrojtimi Strukturor për Bizneset (SBS)

pikë përqindjeje më lartë nga dy vite më parë. Pjesa dërmuese e xhiros të FIE-ve sigurohet nga katër aktivitete kryesore ekonomike, që janë: manifaktura, transporti dhe telekomunikacionet, ndërtimi dhe tregëtia. Në sektorin e manifakturës, FIE-të janë shumë të rëndësishme në industrinë e duhanit, produkteve të naftës, metaleve bazë dhe pajisjeve të tjera të transportit dhe përgjigjen për pothuajse të gjithë produktit të vendit (figura I.8). Në një shkallë të madhe kjo është rezultat i privatizimit dhe politikave koncensionare të qeverisë.

Aktiviteti i **investimeve** të filialeve të huaja shkon në gjysmën e vlerës së të gjitha investimeve të kryera në Shqipëri (figura I.7). Shpenzimet për investime për njësi të xhiros janë më të larta në sektorin e FIE-ve, sesa mesatarja për të gjithë ekonominë shqiptare në tërësi. Rritja e investimeve si pasojë e një gatishmërie më të madhe nga ana e firmave të huaja për të investuar është një avantazh i qartë që rrjedh nga Investimet e Huaja Direkte. Sidomos pas privatizimeve nga kompanitë e huaja, investimet janë rritur ndjeshëm në fushën e telekomunikacioneve. Përqindja e FIE-ve në investimet në manifakturë është më e vogël sesa përqindja e tyre në investime në të gjithë ekonominë si e tërë në vitin 2010. Gjithashtu, gatishmëria e FIE-ve për të investuar në sektorin e manifakturës është më e ulët sesa i gjithë sektori i huaj i marrë si i tërë. Ky i fundit mund të përbëjë rrezik për perspektivën, me rritjen e kostove të prodhimit dhe me lindjen e nevojës për zhvillime teknologjike. Politikat e nxitjes së IHD-ve mund tu adresohen kompanive të huaja të manifakturës, që janë të stabilizuara mirë në ekonominë shqiptare, me qëllim modernizimin, rritjen e investimeve dhe kapaciteteve të kompetencave të filialeve lokale.

Si konkluzion:

Ndërmarrjet e investimeve të huaja kanë një rëndësi të madhe për ekonominë shqiptare përse i përket prodhimit, punësimit dhe aktiviteteve të investimit.

- Investimet e Huaja Direkte përmirësojnë produktivitetin e krahut të punës dhe gatishmërinë për investime, gjë që mund të rrisë konkurencën në rang ndërkombëtar. Megjithatë, pjesëmarrja e lartë e huaj në disa sektorë dhe industri është njokohësisht shenjë dobësie e ekonomisë vendase, duke përfshirë edhe faktin që sektori lokal i SME-ve nuk është i zhvilluar aq sa duhet.
- Shpërndarja e ndërmarrjeve të investimeve të huaja në Shqipëri sipas sektorëve të ekonomisë nuk është uniforme. Ndonëse këto ndërmarrje janë shtysa deri në një farë mase të një ri-industrializimi të vendit, përfshirja e tyre në aktivitete të teknologjive më të larta është ende në nivele të ulëta.
- Hendeku i produktivitetit të krahut të punës midis filialeve të huaja dhe kompanive vendase është relativisht i vogël në industrinë e manifakturës, cka flet për një nivel thuajse të ngjashëm të teknologjisë që përdoret nga filialet e huaja në krahasim me firmat vendase.
- Konkluzioni i politikave është që duhet të vendosen kushte për IHD me vlerë të shtuar më të lartë. Kjo kërkon standarde më të larta trainimi dhe përmirësim të kompetencave të burimeve njerëzore. Zhvillimi i infrastrukturës është një tjetër parakusht për rritjen e mëtejshme të IHD-ve në manifakturë, ndaj dhe përmirësimet e kohëve të fundit në rrugë dhe furnizimin me energji elektrike shënojnë një hap të mirëpritur në këtë aspekt. Por infrastruktura lokale ende mund të ketë mangësi dhe rrjedhimisht duhet që parqet industriale të bëhen funksionale për të garantuar shërbime me standarde të larta për investitorët e ardhshëm.



POLITIKAT DHE MASAT QË NDIKOJNË INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË SHQIPËRI

Me fillimin e proceseve të reformave drejt ekonomisë së tregut në vitet 90-të, Shqipëria nisi udhën e transformimeve të kuadrit politik, ekonomik, ligjor dhe institucional të ekonomisë së saj. Qeveria shqiptare ka zbatuar një sërë reformash strukturore, duke përfshirë, ndër të tjera, reformën e tokës, reformën e sistemit financiar, liberalizmin e cmimeve, privatizimin etj. Janë privatizuar pothuajse të gjitha kompanitë shtetërore, duke përfshirë telekomunikacionet dhe bankat. Vendi tashmë karakterizohet nga një ekonomi e hapur, me një regjim liberal tregëtie dhe investimesh. Gjithësesi, thithja e niveleve më të larta të IHD-ve mbetet ende një sfidë për vendin. Procesi i reformave vazhdon dhe ka për qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mjedisit të biznesit dhe investimeve përmes uljes së barrierave të ndryshme ligjore dhe administrative ndaj bërjes së biznesit, si edhe përmes përmirësimit të infrastrukturës fizike. Si fillim, ky Kapitull jep një panoramë të përgjithshme të vlerësimeve më të fundit të mjedisit të biznesit në Shqipëri dhe të pozitës konkurruese ndërkombëtare, duke vijuar më pas në përshkrimin e karakteristikave kryesore të politikës së qeverisë për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe duke përfunduar me një panoramë të përgjithshme të regjimit të IHD-ve në Shqipëri.

A. Vlerësimet e mjedisit të biznesit dhe pozita konkurruese

Komisioni Evropian – Raporti i Progresit për Shqipërinë 2011⁷

Shqipëria nuk ia doli të merrte statusin e vendit kandidat për në BE kryesisht për shkaqe politike. Në Raport theksohet se ka patur ecuri në përgjithësi përpara si takon krijimit të një ekonomie funksionale tregu. Por, në Raport theksohet gjithashtu se Shqipëria duhet të angazhohet për ndërmarrjen e reformave të mëtejshme stru-

kturore, ndër të tjera, përmes nxitjes së qeverisjes së politikave ekonomike, përmirësimit të performancës së tregut të punës dhe mbrojtjes së të drejtave të pronës. Mangësi u konstatuan në vonesën e programit të planifikuar të privatizimeve, në ritmin e reformave për lehtësimin e hyrjes dhe daljes nga tregu u ngadalësua si edhe u konstatuan dobësi në çështjet e sundimit të rendit, në vecanti përpara i takon zbatimit të kontratave dhe të drejtave të pronës. Korrupsioni i përhapur pati efekte negative në mjedisin e biznesit. Njëkohësisht, në Raport theksohet fakti se ka patur ecuri të mirë përpara i përket lehtësimit të procedurave të regjistrimit dhe licensimit të biznesit. Kjo u bë e mundur edhe përmes faktit që Qendra Kombëtare e Licensimit i zgjeroi shërbimet e saj edhe në qytete të tjera përveç Tiranës. Gjithashtu, raporti konstatonte progres edhe në fushat e reformës regullatore dhe të sistemit të vlerësimit të impaktit regullator.

Vlerësimet për Vendet sipas BERZH-it (2011): Shqipëria⁸

Ndër konstatimet kryesore përfshihen:

- Ka patur një ngadalësim të progresit të përafrit me Bashkimin Evropian. Betejat e brendshme politike kanë penguar kalimin e ligjeve të rëndësishme dhe reformave, dhe nuk e kanë lejuar vendin të marrë statusin kandidat.
- Reformat në sektorin rrugor kanë përparuar. Institucionet ndërkombëtare financiare kanë siguruar mbështetje të ndjeshme për ndërtimin e rrugëve të reja dhe përmirësimin e infrastrukturës.
- duhet të përfundojë shitja e aseteve shtetërore. Përfundimi i privatizimeve të planifikuara, jo vetëm që do të sjellë të ardhurat e shumë pritura për qeverinë, por gjithashtu do të sinjalizojë angazhimin e saj ndaj reformave të orientuara nga tregu. Kjo do të nxiste prurje të qenësishme të investimeve hyrëse të huaja direkte në vitet në vijim.

7 Komisioni Evropian, Shqipëria 2011, Raporti i Progresit, Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin e Evropës, fq. 27.

8 vizitoni: <http://www.ebrd.com/downloads/research/transition/assessments/albania.pdf>


Banka Botërore, Raporti të Bësh Biznes 2012⁹

Në vitin 2012, klasifikimi global i vendeve sipas lehtësisë së bërjes biznes në vendet përkatëse e rendiste Shqipërinë në vendin e 82-të, me një performancë pak më të ulët nga një vit më parë. Shqipëria renditet në grupin e mesit të vendeve të Ballkanit Perëndimor, përpara Italisë dhe Greqisë (figura II.1). Përsa i takon dhjetë fushave kryesore që përfshihen në treguesit e

bërjes së biznesit ekziston një diferencë e madhe. Shqipëria renditet më mirë në aspektin e Mbrojtjes së Investitorëve (16), Marrjes së Kredive (24) dhe Fillimit të një Biznesi (61) (figura II.2). Por pozita e saj është më e ulët në aspektin e Regjistrimit të Pronës (154), Marrjes së energjisë elektrike (152), Pagesës së taksave (152) dhe ka renditjen më të ulët në rang global përsa i takon Trajtimin të lejeve të ndërtimit (183/183).

FIGURA II.1.


Klasifikimi i Shqipërisë sipas treguesëve të lehtësisë së bërjes biznes në Shqipëri dhe në ekonomitë fqinje



Burimi: World Bank dhe IFC, Doing Business 2012 vizitoni: <http://www.doingbusiness.org/rankings>

FIGURA II.2

Klasifikimi i Shqipërisë sipas treguesëve kryesorë të raportit Të Bësh Biznes, 2012




Burimi: Banka Botërore dhe IFC, Raporti Të Bësh Biznes, viti 2012 është i disponueshëm në këtë adresë: <http://www.doingbusiness.org/rankings>.

9 Banka Botërore dhe IFC, Raporti të bësh biznes, viti 2012, Profili Ekonomik i Shqipërisë (Uashington D.C.: Banka Botërore, 2012).

FIGURA II.3.

Klasifikimi i Shqipërisë në lidhje me konkurrueshmërinë sipas fushave kryesore



Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, Raporti i Konkurrueshmërisë Globale 2011–2012.

Forum i Ekonomik Botëror – Raporti i Konkurrueshmërisë Globale për periudhën 2011–2012

Shqipëria përfshihet në grupin e vendeve, të cilat sipas *Raportit të Konkurrueshmërisë Globale për periudhën 2011-2012* të Forumit Ekonomik Botëror gjenden në fazën e dytë të zhvillimit të konkurrueshmërisë, të ashtu-quajtur “faza e rritjes ekonomike e nxitur nga efikasiteti ekonomik”. Konkurrueshmëria e Shqipërisë ka pësuar përmirësime të qendrueshme gjatë viteve të fundit: renditja e saj sipas aspektit të konkurrueshmërisë u përmirësua nga vendi i 96-të në vitin 2009 në vendin e 88-të në vitin 2010, ndërsa në vitin 2011 Shqipëria u ngjoi lart me dhjetë vende duke kaluar në vendin e 78-të në klasifikim midis 142 vendeve të botës. Shqipëria e përmirësoi performancën e saj në përgjithësi, duke reflektuar një forcim modest të kërkesave bazë, përmirësimin të efikasitetit dhe faktorëve të novatorizmit, sic tregohet në klasifikimin e saj në fushat kryesore të konkurrueshmërisë (figura II.3). Komponentët që janë më lart me renditje janë: efikasiteti i tregut të mallrave (43) eficienca e tregut të punës (49) dhe institucionet (57). Performanca e përgjithshme e konkurrencës së vendit vijon të minohet nga një nivel i ulët novatorizmi (123), zhvillimi i tregjeve financiare (107), mjedisi makro-ekonomik (86), arsimi i lartë dhe trainimet (82). Kompanitë të cilat u intervistuan për këtë raport evidentuan ndër faktorët më problematikë që pengojnë konkurrueshmërinë: aksesin ndaj financave, tarifatatimore, korrupsionin dhe rregulloret tatimore.

B. Masat për përmirësimin e mjedisit të investimeve

Duke patur parasysh problemet që ka vendi në lidhje me mjedisin e biznesit, si edhe për të përmirësuar konkurrueshmërinë e vendit dhe për ta bërë Shqipërinë një vend tërheqës për investitorët e huaj, qeveria shqiptare ka ndërmarrë një program gjithëpërfshirës reformash. Si themel për politikat e saj ekonomike, qeveria shqiptare ka prezantuar politika për të mbështetur zhvillimin e sektorit privat. Ajo ka ndërmarrë reforma rregullatore gjithëpërfshirëse. Thelbi i masave konsiston në uljen e barrës administrative dhe kostove të bërjes së biznesit. Më poshtë parashtrihen hapat e ndërmarrja gjatë viteve 2006–2011, sipas informacionit të siguruar nga Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës.

Regjistrimi i biznesit: Qysh nga viti 2007, regjistrimi i biznesit bëhet brenda një dite në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) për më pak se 1 euro dhe numri i hapave për fillimin e një biznesi të ri është shkurtuar nga dhjetë në pesë. Brenda një dite, me një aplikim të vetëm, biznesi i ri mund të regjistrohet online për të plotësuar kërkesat që lidhen me tatimet, sigurimet shëndetësore dhe krahu e punës.

Procedurat e licensimit: Procedurat e licensimit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë janë thjeshtësuar përmes krijimit të Qendrës së Licensimit të Biznesit, në muajin korrik, në vitin

2009. Rrjedhimisht, shumë kërkesa për licenca janë hequr dhe ka përfunduar një thjeshtësim i gjerë i procedurave të licensimit në shumë sektorë, duke përfshirë minierat, hidrokarburet, punët publike, shëndetësinë, bujqësinë dhe mjedisin.

Prokurimet publike. Prokurimet publike janë përmirësuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Me synim përmirësimin e efikasitetit dhe transparencës, si edhe forcimin e sundimit të shtetit ligjor, Shqipëria ka krijuar një sistem elektronik prokurimesh që në vitin 2010 morri cmimin e Kombeve të Bashkuara për Shërbime Publike “UN Public Service Award”. Ky sistem tashmë përpunon të gjitha prokurimet mbi shumën 4000 dollarë dhe ka ulur kostot e prokurimeve, duke përmirësuar njëkohësisht konkurrencën.

Tatimet. Reforma tatimore ka ndikuar në modernizimin dhe përmirësimin e regjimit tatimor, ka përmirësuar arkëtimet dhe ka reduktuar hapësirën për diskrecion dhe evazion tatimor. Politika tatimore është e bazuar mbi filozofinë e taksave më të ulëta dhe në shtimin e gamës të tatimpaguesëve. Që nga viti 2007, në Shqipëri është futur taksa e sheshtë prej 10 përqind, taksa mbi të ardhurat personale dhe taksa për korporatat. Gjithashtu, përmirësimi ka patur edhe në aspektin e kontributeve për sigurimet shoqërore; aktualisht ato përfaqësojnë 28 përqind të pagës bruto (16.7 përqind paguhen nga pudhënësi dhe 11.2 përqind paguhen nga punëmarrësi). Ligji Nr. 9975, i datës 28 korrik 2008 thjeshtësoi me tej tatimet, duke ulur numrin e taksave indirekte kombëtare (me përjashtim të TVSH-së) nga 23 në 7 përmes eliminimit dhe konsolidimit të një numri taksash, duke transformuar të tjerat në tarifa. Taksat aktuale kombëtare janë: taksa e rrugës, taksa mjedisore, taksa portuale, taksa për qeranë minerare, taksa e pullës, taksa për regjistrimin e kazinove dhe lojrave të fatit dhe taksa mbi aktivitetet e peshkimit. Si rrjedhojë e reformave tatimore ka patur një rritje të të ardhurave fiskale, me nivele më të larta se PBB-ja, si edhe një shtim të numrit të tatimpaguesëve.

Politika tregëtare. Një politikë e duhur tregëtare lehtëson integrimin e ekonomisë shqiptare në tregjet rajonale të Evropës Juglindore që mund të kompenzojë faktin që Shqipëria është një vend i vogël, duke hapur perspektiva për ofrimin e shërbimeve për një treg prej afërsisht 50 milionë banorësh. Integrimi nxitet nga liberalizimi i tregëtisë, mbështetja e eksporteve dhe nxitja e IHD-ve. Qeveria shqiptare ka ndërmarrë veprime për harmonizimin e legjislacionit shqiptar

me rregullat ndërkombëtare të tregëtisë, si edhe me Politikat e Përbashkëta Tregëtare Evropiane. Qysh me anëtarësimin e saj në OBT në shtator të vitit 2000, Shqipëria ka zbatuar liberalizimin e plotë të regjimit të saj të import-eksportit të mallrave. Gjithashtu, hapa të mëtejshme të politikave tregëtare do të arrihen përmes eliminimit të të gjitha barrierave jo-tarifore ndaj tregëtisë.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) me BE-në e firmosur me datë 1 dhjetor 2006 përmban një marrëveshje të ndërmjetme me BE-në që hyri në fuqi në prill të vitit 2009. Kjo marrëveshje, një hap i rëndësishëm në rrugën drejt anëtarësimin në BE parashikohet të çelë mundësi të reja për zhvillimin e vendit.

Qysh nga janari i vitit 2004 Shqipëria ka përfunduar dhe ka zbatuar një rrjet të plotë të *Marrëveshjeve të Tregëtisë së Lirë* në rajonin e Evropës Juglindore me Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Kosovën, Serbinë dhe Malin e Zi, Bullgarinë, Rumaninë, Bosnje- Hercegovinën, Kroacinë dhe Republikën e Moldavisë. Kjo u pasua me procesin e liberalizimit dhe miratimin e një marrëveshjeje të përbashkët për tregëtinë e lirë. Marrëveshja për Tregëtinë e Lirë e vendeve të Evropës Qendrore (CEFTA) e vitit 2006 u nënshkrua nga të gjitha palët e lartpërmendura dhe ka qënë funksionale që nga nëntori i vitit 2007. Kjo marrëveshje nuk është një transformim formal i rrjetit të marrëveshjeve individuale të tregëtisë së lirë në një të vetme, por reflekton një nivel më të lartë të hapjes së tregëtisë dhe bashkëpunimit rajonal midis vendeve të rajonit. Politika e liberalizimeve ka vijuar me marrëveshjet e tregëtisë së lirë midis Shqipërisë dhe Turqisë, si edhe marrëveshjet e tregëtisë së lirë me Shqipërinë me vendet e Shoqatës Evropiane të Tregëtisë së Lirë (EFTA).

Parqet industriale dhe zonat e lira. Ndër instrumentet që shërbejnë për lehtësimin e investimeve në vend janë parqet industriale dhe zonat e lira, krijimi i të cilave është nisur nga qeveria shqiptare. Baza ligjore për zhvillimin e këtyre zonave ekonomike është Ligji nr. 9789, i datës 19.07.2007 “Për krijimin dhe vënien në funksion të zonave ekonomike”, që regullon krijimin e zonave ekonomike dhe çështjeve përkatëse. Përzgjedhja e “zhvilluesit” të zonave ekonomike bazohet në kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9663, të datës 18 dhjetor 2006 “Për koncensionet”. Koncensionet për zhvilluesin janë kryesisht në formën BOT (ndërto-vër në funksion-transfero) për një periudhë deri në 35 vjet përkundërt një tarife nominale prej 1 €.

Zonat e tregëtisë së lirë dhe parqet industriale po ngrihen pranë porteve, aeroporteve apo në kryqëzimet e transportit ndërkombëtar. Zonat ekonomike propozohen nga Ministria e Ekonomisë dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave rast pas rasti. Investimet e parashikuara në zonat ekonomike parashikohen të kapin shifrën mbi 100 milionë €. Investimet do të jenë kryesisht investime të reja, me përjashtim të parkut industrial të Elbasanit që do të jetë një investim i tipit “brownfield” në një ish ndërmarrje ekzistuese. Qysh nga viti 2010, Këshilli i Ministrave ka miratuar nëntë zona ekonomike, një prej të cilave është në Vlorë dhe ka statusin e zonës së lirë. Të tjerat kanë statusin e “Parkut Industrial” dhe ndodhen në Koplak (Shkodër), Shëngjin (Lezhë), Vlorë, Elbasan, Spitalle (Durrës), Shkoder, Laknas (Tiranë) dhe Lezhë. Parku i Vlorës do të nisë së shpejti nga funksionimi dhe për parkun e Shëngjinit është nënshkruar kontrata e zhvillimit dhe pritet të nisë puna. Parqet industriale mund të përdoren për qëllime manifakture, agropërpunim, tregëti dhe aktivitetet mbështetëse. Agjencia e zhvillimit AIDA do të shërbejë si një agjenci “one-stop-shop” për licensimin e qeramarrësve në zonat ekonomike.

Përveç reformës së politikave dhe masave për lehtësimin e biznesit, një çështje kritike për firmat është shkalla deri ku ligjet dhe rregulloret ekzistuese zbatohen dhe ekzekutohen. Shqipëria ka bërë përpjekje të konsiderueshme për përmirësimin e klimës së investimeve përmes zbatimit të një sërë ligjesh dhe rregulloresh të reja (në përputhje me kërkesat për anëtarësim në BE). Megjithatë, aty ku ligjet janë të paplota (mungojnë rregulloret zbatuese) ose inkonsistente me njëri-tjetrin mund të krijohen hendeqe midis strukturave ligjore formale dhe praktikave aktuale të zbatimit që kanë tendencë të minojnë sundimin e shtetit ligjor dhe të rrisin pasigurisë për bizneset (Banka Botërore 2010a). Gjithashtu ka nevojë të qartësohen proceset për zbatimin e ligjeve dhe rregullore të reja, si edhe për rishikimin e efikasitetit të atyre ekzistuese.

Reformat rregullatore për përmirësimin e transparencës dhe parashikueshmërisë së ligjeve dhe rregulloreve shqiptare, përfshijnë krijimin e një sistemi për Vlerësimin e Impaktit Regullator (RIA), Reformën e Sistemit të Inspektimit dhe krijimin e Regjistrat Elektronik të Legjislacionit të Biznesit. Sistemi për *Vlerësimin e Impaktit Regullator* është institucioni bazë për përmirësimin e cilësisë së rregulloreve dhe ndikimit të tyre në biznese. *Reforma e Sistemit të Inspektimit* është ndër reformat më të ndërlikuara të ndërmarra

deri më tash. Ligji Horizontal Për Inspektimet, Nr. 10433 Dt. 16.06.2011 përmban parimet e përgjithshme të inspektimit, krijimin e inspektoriatit të përgjithshëm të inspektimit dhe ndarjen e roleve mes institucioneve. *Legjislacioni për Regjistrin elektronik të bizneseve* hyri në fuqi nga fundi i vitit 2010. Qëllimi i tij është nisja e konsultimeve mbi projekt-aktet dhe aktet në fuqi me qëllim përmirësimin e cilësisë së tyre.

Për të *parandaluar korrupsionin* janë ngritur sisteme në administratën doganore dhe në zyrat që kontrollojnë shpenzimet e shtetit. Gjithashtu janë rishikuar proceset e administrimit tatimor dhe ato të auditimit, me qëllim që ato të pasqyrojnë standardet ndërkombëtare. Ato janë të organizuara sipas linjave të qarta administrative që shkurajojnë tatimorët të bëhen pjesë e praktikave korruptive. Megjithatë, sektori informal i ekonomisë ende është në shkallë të lartë dhe kjo lehtëson evazionin fiskal.

Privatizimi ka qënë një pjesë e rëndësishme e procesit të reformave në Shqipëri dhe një instrument i rëndësishëm për thithjen e investitorëve të huaj (shih edhe Kapitullin I). Strategjia e privatizimi e miratuar me anë të Ligjit Nr. 8306, datë 14 mars 1998, ndër të tjera pati si qëllim thithjen e investitorëve strategjikë, nxitjen e ekonomisë përmes përdorimit me efikasitet të burimeve njerëzore dhe natyrore, si edhe përmes garantimit të stabilitetit të pronësisë. Nuk ka pasur kufizime në lidhje me pjesëmarrjen e investitorëve të huaj në procesin e privatizimit. Investitorëve të huaj u lejohet 100 përqind pronësi e ndërmarrjeve të privatizuara. Ndonëse lejohet me ligj, shteti nuk ka ruajtur kontrollin ndaj kompanive përmes përdorimit të të ashtu-quajturit “aksion i artë”. Marrëveshjet më të rëndësishme të privatizimit, pas vitit 2000 përfshijnë (sipas METE) :

- Në vitin 2001, privatizimi i Bankës Tregëtare përmes shitjes tek grupi Calik, nga Turqia për një shumë prej 10 milionë dollarë;
- Në po të njejtin vit, privatizimi i 85 përqind të aksioneve të kompanisë së telefonisë celulare AMC, e cila iu shit për 85.6 milionë dollarë kompanisë greke Cosmote (OTE Group),
- Dhe licensimi i operatorit të dytë të telefonisë celulare, Vodafone për 30.1 milionë dollarë;
- Në vitin 2004, privatizimi i Bankës së Kursimeve nga Banka Raiffesen e Austrisë për 124 milionë dollarë;
- Në vitin 2007, privatizimi i 84 përqind

të aksioneve të kompanisë Albtelekom nga "Calik Enerji Telekomunikasyon" për 120 milionë euro;

- Në vitin 2008, kompania e rafinerisë së naftës, ARMO u privatizua përmes shitjes së saj tek konsorciumi "The Refinery Associates of Texas", "Anika Enterprises SA", "Mercuria Energy Group Limited" për një shumë prej 126 milionë eurosh;
- Në vitin 2009, 76 përqind e operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike TSO u privatizua duke u shitur për një shumë prej 102 milionë eurosh tek kompania çeke CEZ;
- Në mars të vitit 2009, paketa e aksioneve shtetërore në kompaninë celulare AMC, që përbënte 12.6 përqind të kapitalit u shit për 48.2 milionë euro;
- Në vitin 2012 nisi privatizimi i Albpetrolit.

Procesit të privatizimit pothuajse i ka ardhur fundit, ku kanë mbetur vetëm një numër rastesh të vogla. Kompanitë e mëdha për shitje përfshijnë Albpetrol-in, kompania e vetme në vend për nxjerrjen e naftës, për të cilën Parlamenti miratoi Ligjin nr 10490 "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të kompanisë ALBPETROL Sh.a" në dhjetor të vitit 2011. Aktualisht, pjesa dërrmuese e zonave ekzistuese naftëmbajtëse të administruara nga kompania Albpetrol sh.a. janë dhënë për eksplorim dhe prodhim përmes marrëveshjeve të ndryshme të naftës. Përfaqësuesit kryesorë të këtyre marrëveshjeve, kompania Bankers Petroleum Ltd. është një kompani kanadeze që punon në fushën e eksplorimit të naftës dhe gazit, si edhe kompani prodhimi të përqëndruara në zhvillimin e rezervave të mëdha të naftës dhe gazit. Kompania Bankers operon dhe ka të drejta të plota për zhvillimin e zonave të rënda naftëmbajtëse në zonën e Patos-Marinzës, ka 100 përqind interesa në zonën naftëmbajtëse të Kucovës dhe 100 përqind interesa në Bllokun F të Eksplorimit. Puna është në progres për të gjitha asetet e tjera në pronësi të Albpetrolit, të cilat nuk janë përfshirë në marrëveshjet e naftës. Qeveria ka pajtuar firmën ligjore Patton Boggs me zyra në Uashington për ta këshilluar për shitjen e Albpetrom-it.

Gjithashtu, qeveria po përpiqet sërish të shesë aksionet e saj të kompanisë së sigurimeve INSIG, ku dy tenderat e parë dështuan me

rradhë. Në përgatitjen e një përpjekjeje të re për privatizim, autoritetet kanë hequr kërkesat minimale për ofertën, në fund të qershorit të vitit 2011 dhe parashikohet të organizohet një tender i ri në muajt në vijim. (Dy vite me parë, kompania e sigurimeve "American Reserve Life" Insurance ra dakord të blinte 61 përqind të aksioneve të INSIG-ut për 41 milionë euro, por u tërhoq kryesisht për shkak të krizës financiare.)

Privatizimi i aksionit të minorancës (16 përqind) të qeverisë shqiptare në operatorin e telefonisë fikse Albtelecom u hodh në ankand 15 mars 2012. Gjithashtu, në vitin 2012 do të nisnin procedurat për privatizimin e aksioneve të mbetura të TSO-së dhe ARMO-s.

Për më tepër, qeveria ka planifikuar të privatizojë disa prej asetëve të tyre që kanë mbetur ende në sektorin e hidrocentrale. Katër hidrocentrale (Ulza, Shkopeti, Bistrica 1 dhe Bistrica 2) janë nxjerrë për shitje dhe ankandi i tyre është shpallur për në qershor 2012. Gjithashtu, qeveria shqiptare ka shpallur qëllimin e saj për privatizimin e afërsisht 1,300 të ndërmarrjeve të saj të mbetura shtetërore (kryesisht ndërmarrje të vogla), disa prej të cilave janë ish ndërtesa/objekte të ushtrisë.

Partneriteti publik-privat (PPP) është regulluar përmes paketës ligjore, sipas Ligjit Nr 9663, të datës 18 dhjetor 2006 "Për konkensionet". Amendamentet në këtë ligj do të bëjnë të mundur rritjen e transparencës, efektshmërisë dhe paanësisë në nënshkrimin e marrëveshjeve konkensionare. Qeveria shqiptare ka zbatuar konkensionet, duke përfshirë konkensionet për firmat e huaja, në sektorë të ndryshëm si: energjetika, minierat, infrastruktura aeroportuale dhe manaxhimi i sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve.

Projektet konkensionare në sektorin energjetik kanë si qëllim rritjen e prodhimit të energjisë elektrike për të arritur dyfishin e nivelit aktual, si dhe diversifikimin e burimeve të energjisë drejt energjisë së rinovueshme. Strategjia e qeverisë për rritjen e *sigurisë së furnizimit me energji elektrike* ka të bëjë me shfrytëzimin e potencialit të energjisë në vend që është ende i pashfrytëzuar. Kjo parashikohet të kryhet kryesisht përmes investimeve private dhe kontratave konkensionare për PPP, duke përfshirë me TNC-të. Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës ka firmosur 114 kontrata konkensionare për ndërtimin

e 327 hidrocentraleve, me një kapacitet total prej 1400 MW, me vlerë investimi 1.7 miliardë €. 43 prej tyre janë në fazën e prodhimit, 40 në fazën e ndërtimit, ndërsa vijon procesi i nënshkrimit dhe negociatave për kontrata të mëtejshme koncensionare.

Si pjesë e programit të stabilitetit energjetik, qeveria shqiptare ka përfunduar ndërtimin e një termocentrali me 97 MW në Vlorë, me një vlerë prej afërsisht 80 milionë € që është bërë funksional dhe ka nisur nga prodhimi i energjisë në vitin 2012. Gjithashtu, u janë dhënë licencë një numri investitorësh privatë për ndërtimin e mullinjve të erës me kapacitet total të instaluar prej afërsisht 1500 MW, duke parashikuar një investim prej afërsisht 1.5 miliardë €. Ndërkaq, Shqipëria po ecën drejt një tregu rajonal të energjisë dhe pjesëmarrjes në shkëmbime rajonale të energjisë. Linjat e interkonjeksioneve janë bërë funksionale dhe sigurojnë lidhje midis Elbasanit dhe Tiranës dhe Tiranës dhe Podgoricës. Investime të mëtejshme për dy linja kabllore nënujore me Italinë dhe interkonjeksionet midis Tiranës dhe Prishtinës, si edhe Tiranës dhe Shkupit do të mbyllin by-passin e transmetimit rajonal të energjisë elektrike, duke përfshirë edhe Shqipërinë.

Në sektorin e minierave, ndër projektet ekzistuese përfshihen: kompania Albanian Chrome Sh.p.k. (ACR) që operon në Bulqizë me minierën më të madhe të kromit dhe uzina e ferokromit në Elbasan. Në një projekt të ri, kompania Kurum Energy, Resources and Metallurgy Sh.a. (nën-degë e Kurum Holding A.S., Turqi) dhe Sichuan Jiannanchun International Group Ltd (një grup i rëndësishëm kinez) kanë nënshkruar me qeverinë shqiptare një marrëveshje koncensionare për eksplorimin dhe shfrytëzimin e depozitave të kromit në zonën e Kalimashit dhe në Vlahne dhe për ndërtimin e impjanteve për pasurimin e bakrit në Shqipërinë e Veriut në prill 2010. Të drejtat koncensionare bënë të mundur që kompania vendase e investitorëve të sipër përmendur, Illyria Minerals Industry Sh.a (IMI) të siguronte për një periudhë 35 vjecare një depozitë prej 6 milionë ton xeherorësh kromi dhe bakri, në pjesën e Shqipërisë që gjendet në kufi me Kosovën. Kompania e re parashikohet të prodhojë afërsisht 210,000 ton krom në vit.

Në industrinë e naftës, qeveria shqiptare ka marrëveshje për eksplorimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit me kompani si: Island-

rockall JV. dhe Australian Beach Petroleum Ltd, Capricorn Albania shpk, filiale e kompanisë Cairn Energy, me kompaninë Petromanas Albania GmbH, Banker Petroleum Albania dhe Sky Petroleum. Gjithashtu ka edhe marrëveshje të tjera për prodhimin dhe zhvillimin e zonave ekzistuese naftë dhe gaz mbajtëse me kompanitë Bankers, Stream Oil & Gas, Sherwood International Petroleum dhe IEC Visoka.

Zhvillimi i infrastrukturës së transportit në vend është një tjetër objektivi prioritar i qeverisë shqiptare. Falë ndihmës së fondeve nga donatorët dhe në bashkëpunim dhe partneritet me sektorin privat, qeveria shqiptare ka zhvilluar dhe rehabilituar ndjeshëm rrjetin rrugor, me qëllim rritjen e eficiencës dhe kapaciteteve të tij, si edhe për përmirësimin e lidhjeve rajonale dhe kontinentale të transportit. Autostrada kryesore aktualisht shtrihet nga porti i Durrësit në bregdetin e detit Adriatik deri në kufirin me Kosovën dhe kur të përfundojë plotësisht do të mbërrijë në Prishtinë, me një gjatësi totale prej 250km. Është në ndërtim e sipër Korridori i VIII që lidh portin e Durrësit me Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, sikundërse edhe aksi Veri-Jug që lidh Malin e Zi me Greqinë përmes Shqipërisë. Pas disa vitesh, vendi do të lidhet me fqinjët e vet përmes rrugëve tejet cilësore që lehtësojnë transportin dhe tregëtinë.

Me linjën e saj bregdetare në Adriatik dhe afërsinë ndaj Afrikës së Veriut dhe Lindjes së Mesme, Shqipëria ndodhet në një pozitë mjaft të favorshme si epiqendër rajonale për zhvillimin e tregtisë detare. Shqipëria ka katër *porte kryesore detare* – atë të Durrësit, Vlorës, Sarandës dhe Shëngjinit. Porti i Durrësit përpunon deri tani vëllimin më të madh të ngarkesave, afërsisht 75 përqind të gjithë totalit për vendin. Shqipëria po modernizon lidhjet e transportit nga portet e veta drejt vendeve të ndryshme në Evropë, duke rritur njëkohësisht kapacitetin e porteve të veta për tu bërë ballë volumeve në rritje, si edhe përmes përmirësimit të niveleve të tyre eficiencës. Në vitin 2009, një kompanie angleze dhe zvicerane të quajtur Zamax AG group iu akordua një kontratë 35 vjecare për ndërtimin e një terminali kontenierësh për anije në pjesën e Shqipërisë Jug-Perendimore. Ndërtimi i terminalit është parashikuar të përfundojë brenda katër vjetëve, duke ofruar kështu një terminal me kapacitet vjetor kontenier tre milionësh. Parashikohet që mbi 4,000 kom-

pani të përdorin kontenierët kur porti të bëhet aktiv në formën e një zone të lirë. Fondet nga donatorët po ndihmojnë në modernizimin e shumë nevojshëm të Portit të Sarandës, ndërsa në portin e Durrësit do të jepen kontrata koncesioni për ndërtimin e një terminali konteinerësh dhe magazine cimentoshe për ta hapur atë për kompanitë e huaja. Duke njohur vlerën e infrastrukturës së vet portuale, qeveria ka hartuar një axhendë për të përmbytur mirë nevojat dhe kërkesat në rritje. Parashikohet që Investimet e Huaja Direkte do të luajnë një rol shumë të madh në këtë nën-sektor që po lulëzon.

Investime të fuqishme ka patur edhe në lidhje me *transportin ajror*. Aeroporti Nënë Tereza në Tiranë ka pësuar një modernizim të rëndësishëm dhe zgjerim gjatë dekadës së fundit dhe është koncesioni më i suksesshëm që operohet ngë një konsorcium i Hochtief Airport, Deutsche Investitions- und Entwicklungsgesellschaft mbH dhe Fondi Amerikano-Shqiptar i Ndërmarrjeve me një kontratë Ndërto-Merr në Pronësi-Vër në Funksionim-dhe Transfero (BOOT) për 20 vjet. Në vitin 2009, aeroporti u shërbeu 1.4 milionë udhëtarëve, 180 përqind më shumë se në vitin 2005, ndërsa numri i operatoëve ndërkombëtarë ajrorë është rritur nga 7 në 18. Një Plan për Manaxhimin e Trafikut Ajror, në bashkëpunim me kompaninë Lockheed Martin, që kap një vlerë prej afërsisht 50 milionë dollar do të ndihmojë në përfundimin e një qendre të re për kontrollin e trafikut ajror. Aktualisht aeroporti Nënë Tereza ka tërhequr linja ajrore të njohura ndërkombëtare si: British Airways, Lufthansa dhe Austrian airlines. Ndonëse kjo ka qënë një marrëveshje e suksesshme koncesionare, një problem mbetet fakti që i jep koncesionarit monopol për të gjithë trafikun ndërkombëtar, që është një pengesë e rëndësishme për zhvillimin e aeroporteve më të vegjël me shërbime ndërkombëtare si aeroporti i Kukësit dhe potencialisht ai i Sarandës, për t'i shërbyer zhvillimit të turizmit në jug të Shqipërisë.

Infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit (ICT) përfaqëson një tjetër faktor të rëndësishëm për një rritje të qendrueshme. Gjatë dekadës së kaluar, Shqipëria ka bërë ndryshime të ndjeshme të infrastrukturës së saj ICT. Sektori i ICT-së po rritet me shpejtësi, duke u shndërruar në një ndër industritë më dinamike të vendit. Gjatë viteve të fundit, qeveria ka ndërmarrë masa përmes Strategjisë

Ndër-sektoriale të Shoqërisë së Informacionit për ta azhurnuar vendin me moshën dixhitale. Legjislacioni vendas ka liberalizuar industrinë e telekomunikacioneve, duke e sjellë atë në linjë me kuadrin rregullator të BE-së në lidhje me komunikacionet, që nxit konkurrencën. Në vitin 2007 u krijua Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (NAIS), me qëllim përsheptimin e zhvillimit të shoqërisë së informacionit dhe shërbimeve e-government. Duke patur parasysh që rritet me bandë të gjerë dhe shërbimet mund të kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe rritjen e konkurrueshmërisë, një nga objektivat kryesorë të qeverisë shqiptare është ndërtimi i një rrjeti kombëtar me bandë të gjerë që do të garantojë shërbime internet për të gjitha shkollat publike, institucionet akademike, agjencitë qeveritare dhe qytetarët e Shqipërisë. Aktualisht, Ministri për Inovacion dhe ICT-ja po punojnë për një Plan Kombëtar me Bandë të Gjerë për të mbështetur ITU.

Si rezultat i zhvillimeve teknologjike Shqipëria ia doli mbanë të rriste ndjeshëm disponueshmërinë e shërbimeve elektronike në të gjitha shërbimet bazë qeveritare. Pothuajse 80% e shërbimeve bazë qeveritare aktualisht janë të disponueshme në format elektronik, në nivelin e parë apo të dytë të sofistikimit, kurse mbi 50% të shërbimeve G2B ofrohen në nivele interaktive të sofistikimit.

Aksesi në telefoninë celulare është përmirësuar dhe tani renditet ndër më të mirët në rajon. Rritja e sektorit është nxitur më tej përmes futjes së konkurrencës së tregut përmes një operatori të tretë të telefonisë celulare në vitin 2008, kompania Eagle Mobile dhe një kompani e katërt me pronësi shqiptare, e quajtur Plus Communication sh. a. në vitin 2010. Numri i përdoruesëve të telefonave celularë në fund të vitit 2011 arriti në afërsisht 5.2 milion në krahasim me 4.2 milionë përdorues që ishte shifra për fundin e vitit 2010. Kjo përfaqëson një përqindje penetrimi (numri i përdoruesëve për 100 banorë) prej 185 (140 në vitin 2010) që është më e lartë se niveli mesatar i vendeve të BE-së. ulja e tarifave të telefonisë celulare në vitet e fundit erdhi si rezultat i masave rregullatore () të zbatuara nga Autoriteti Kombëtar i Elektronikës dhe Komunikacioneve Postare (AKEP) si edhe shtimit të konkurrencës në treg.

Përdorimi i internetit është rritur vit pas viti. Numri i familjeve që kanë akses në in-

ternet është afërsisht 161 000 ose shprehur ndryshe rreth 22% e familjeve shqiptare dhe më shumë se 90% kanë lidhje me internet me bandë të gjerë. Gjatë 2-3 viteve të fundit, numri i SME-ve me lidhje me bandë të gjerë pothuajse është dyfishuar. Numri i lidhjeve me bandë të gjerë (fikse dhe 3G-USB/modem) për 100 banorë është afërsisht 6.2 në krahasim me 3.7 që ishte kjo shifër në fund të vitit 2010. Raporti për Teknologjinë Globale të Informacionit për vitet 2011-2012 i Forumit Ekonomik Botëror tregonte se Shqipëria kishte ngjitur 19 shkallë në renditje sipas Indeksit të Gatishmërisë së Rrjetit, në krahasim me raportin e mëparshëm.

Pavarësisht faktit që sektori shqiptar i ICT-së praktikisht ka marrë zhvillimin më të madh gjatë viteve të fundit ende ka objektiva të rëndësishme që mbeten për tu realizuar, si p.sh. mbulesa me internet në të gjithë vendin dhe sigurimi i një rrjeti infrastrukturor më të shpejtë dhe më të besueshëm. Cështjet kryesore që duhet të mbulohen janë niveli i ulët i penetrimit të linjave të telefonisë fikse dhe internetit, densiteti i ulët i pronësisë së PC-ve, kostot relativisht të larta të aksesit në internet dhe nivelet e ulëta të ndërgjegjësimit në lidhje me përfitimet e përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikacionit, dhe hendeku dixhital midis zonave urbane dhe atyre rurale, në krahasim me vende të tjera evropiane.

Përpyekjet e Shqipërisë për fuqizimin e marrëdhënieve dhe masave institucionale për nxitjen e Investimeve të Huaja Direkte mbështeten nga bashkëpunimi dhe asistenca teknike e organizatave ndërkombëtare si: KE, PNUD-i, Banka Botërore/FIAS-i, UNCTAD-i etj. Një ndër këto iniciativa të suksesshme kanë qenë ushtrimet “lead generation” e organizuara nga Albinvest-i (agjencia për nxitjen e IHD-ve, përpara se të quhej AIDA), me mbështetjen e Projektit të KE-PNUD-it për Liberalizmin dhe Nxitjen e Tregtisë, që kishte si objektiv investitorë potencialë dhe u ofronte atyre informacionet përkatëse.

C. Politikat për Investimet e Huaja Direkte – regjimi i investimeve

Në vitin 1993, Shqipëria miratoi një kua-dër ligjor për investimet e huaja direkte që më pas pësoi ndryshime. Karakteristikat kryesore

të regjimit aktual të investimeve janë:

- Ekonomia shqiptare është e hapur për të gjithë investitorët. Nuk kërkohet autorizim paraprak për investimet. Si regull, të gjithë sektorët janë të hapur ndaj investimeve të huaja. Ligji garanton trajtim të barabartë dhe të paanshëm. Investimet nga investitorët e huaj dhe vendas janë të lejuara në të njëjtat kushte.
- Ligji për Investimet e Huaja përcakton se investimet e huaja nuk mund të nacionalizohen apo shpronësohen, me përjashtim të rasteve të posacme të përcaktuara në ligj dhe kur kjo është në interes të publikut. Në këto raste procedurat duhet të zhvillohen pa diskriminim dhe me kompensim të barabartë me vlerën reale të tregut.
- Investitorët në Shqipëri gëzojnë të drejtën e mbrojtjes nga gjykata të drejtave të tyre që lidhen me investimet e tyre. Palët në një debat mund të bien dakord të paraqesin mosmarrëveshjet për konsideratë tek një institucion arbitrazhi. Në rast të një dështimi të këtij arbitrazhi, investitorët e huaj gëzojnë të drejtën ta paraqesin kërkesën e tyre në një gjykatë shqiptare apo gjykatë arbitrazhi në Tiranë. Në rast të një mosmarrëveshjeje në lidhje me diskriminimin, transferimin e aseteve, apo shpronësim indirekt të investimit të huaj nga qeveria, investitori mund ta parashtrijë ankesën e vet në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve në lidhje me Investimet (ICSID). Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara kanë superioritet ligjor mbi legjislacionin vendas për çështje që lidhen me IHD-të.
- Ndërmarrjeve të investimeve të huaja të regjistruara në Shqipëri si subjekte juridike u lejohej të kenë në pronësi çfarëdo lloj toke.
- Kompanitë që investojnë në Shqipëri kanë të drejtën të punësojnë në to shtetas të huaj.
- Fondet që lidhen me investimet

mund të transferohen jashtë vendit, në një monedhë të konvertueshme që llogaritet me kursin e këmbimit për transaksionet aktuale, në datën e kryerjes së transfertës. Megjithatë, transferimi i këtyre fondeve mund të kufizohet për mospagesë taksash apo për mospërmbushje detyrimesh, si edhe sipas vendimeve të gjykatave.

- Shqipëria ka në fuqi 40 marrëveshje bilaterale investimesh me baza reciproke.

Aksesi ndaj tokës në Shqipëri raportohet si një ndër problemet kryesore për investitorë të vecantë të huaj për shkak të një sërë faktorëve, ndër të cilët përfshihen: mungesa e dokumenteve të pronësisë, pretendime të mbivendosura për token në fjalë dhe vendimeve të paparashikuara nga gjykatat. Për t'iu përgjigjur këtij realiteti dhe për të lehtësuar hyrjen e investitorëve të huaj, qeveria shqiptare ka miratuar ligjin Nr. 10316, datë 16.09.2010 "Për disa shtesa në Ligjin Nr. 7764, datë 02.11.1993 "Për investimet e huaja". Ky ligj garanton mbrojtje të posacme shtetërore për disa kategori të investitorëve të huaj të cilët në procesin e investimeve përballen me probleme të pronësisë, për shkak të pretendimeve që lidhen me titujt e pronësisë nga palë të treta. Kjo mbrojtje do të jetë e përkohëshme për një periudhë katër vjecare ose deri në plotësimin/përfundimin e regjistrimit elektronik për titujt e pronësisë. Kjo mbrojtje e posacme shtetërore garantohet për investimet e huaja në infrastrukturën publike, në turizëm, në energjetikë, bujqësi dhe në pasuri të paluajtshme të vendosura në dispozicion të investitorit nga vetë qeveria shqiptare, si edhe në rastet kur investimi i parashikuar pritet të vlejë mbi 10 milionë euro.

Legjislacioni shqiptar nuk garanton *stimujt të posacëm për investitorët e huaj*. Kompanitë e huaja njësoj si ato vendase përfitojnë njësoj nga stimujt që ofrohen nga ligje të ndryshme. Stimujt rregullohen përmes Ligjit Nr. 9374, datë 21 prill 2005, Për ndihmën shtetërore, dhe sipas amendamenteve të Ligjit Nr. 10183, datë 20 tetor 2009 për zbatimin e projekteve të rëndësishme. Ligji për ndihmën shtetërore është i vlefshëm për të gjithë sektorët e prodhimit dhe shërbimit dhe të gjitha masat e ndërmarra nga qeveria qendrore dhe lokale, si edhe nga subjekte të tjera që veprojnë në emër të shtetit dhe nga e cila përfitojnë të gjitha

ndërmarrjet, me përjashtim të atyre në bujqësi dhe peshkim. Ndër stimujt përfshihen, sa më poshtë vijon:

- Investitorët që ndërtojnë impjante për prodhimin e energjisë, me kapacitet të instaluar mbi 5 MW, duke përdorur materiale djegëse të lëngëshme apo të ngurta, si edhe investitorët të cilët janë të përfshirë në rehabilitimin e impjanteve ekzistuese mund të përfitojnë nga përjashtime tatimore për makineritë dhe pajisjet që importojnë dhe të cilat ata i përdorin për investime kapitale. Investitorë të tillë gjithashtu mund të rimbursohen për taksat doganore dhe të akcizës që paguajnë për importimin e lëndëve djegëse që përdorin për prodhimin e energjisë (Ligji Nr. 8987, datë 24 shkurt 2002 "Për krijimin e kushteve lehtësuese në lidhje me ndërtimin e impjanteve të reja për prodhimin e energjisë");
- Aktualisht, importuesit e makinerive dhe pajisjeve mund të përfitojnë nga shtyrja e pagesave të TVSH-së për një periudhë deri në dy vjet, në rast se këto makineri dhe pajisje përdoren tërësisht për aktivitetin e ekonomik të importuesit të tatueshëm sipas Ligjit Nr. 9856, Për disa amendamente të Ligjit për TVSH-në, datë 26 dhjetor 2007. Megjithatë, qeveria ka deklaruar gatishmërinë e saj për një amendament tjetër të këtij Ligji nga mesi i vitit 2012, duke eliminuar TVSH-në për këto makineri dhe pajisje.

Një ligj i ri, ai me Nr. 10303, datë 15 korrik 2010 i miratuar nga parlamenti shqiptar themelon AIDA-n (*Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve*), e cila luan rolin e agjencisë kombëtare për nxitjen e investimeve (IPA). Agjencia u bë funksionale vetëm një vit më vonë dhe tashmë po shndërrohet në një aktor të rëndësishëm në thithjen e IHD-ve në vend. Sipas këtij ligji, qeveria i ka ngarkuar kësaj agjencie këto detyra:

- Të lehtësojë dhe mbështesë investimet direkte në Shqipëri, përmes identifikimit dhe nxitjes së mundësive për investime, duke ofruar shërbime dhe mbështetje për investitorët

ekzistues dhe ata potencialë;

- Të rrisë konkurueshmërinë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke mundësuar rinovimin dhe përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve, si edhe teknologjive që ata përdorin, duke ofruar mekanizma për zhvillimin e kapaciteteve të tyre teknike dhe rinovuese; Të nxisë dhe mbështesë eksportin e mallrave dhe shërbimeve përmes ofrimit të shërbimeve mbështetëse dhe sigurimit të asistencës financiare për kompanitë eksportuese dhe nxitjen e eksporteve.
- Agjencia i kryen të gjitha aktivitetet dhe merr të gjitha iniciativat e nevojshme për të mbështetur zhvillimet e sektorit privat dhe për të përmirësuar klimën e biznesit, duke ndihmuar kompanitë në të gjitha fazat e aktivitetit të tyre ekonomik, si edhe duke ndërmjetësuar me investitorët dhe autoritetet shtetërore. Vëmendje e vecantë ndër të tjera do tu kushtohet trajtimit të mangësive në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e projekteve të investimit, manaxhimit të marrëdhënieve me klientët, dhe shërbimeve që do të ofrohen pas krijimit të investimeve të huaja.

D. Vrojtimi mbi kënaqësinë e investitorëve

Opinionet e investitorëve është testuar gjatë një vrojtimi të kryer në periudhën midis dhjetorit 2011 – janarit 2012 që kishte si objektiv të gjithë investitorët e huaj në sektorët e ndryshëm të ekonomisë shqiptare. Hulumtimi drejtohej nga AIDA, nën drejtimin e UNCTAD-it dhe në bashkëpunim të ngushtë me Shoqatën e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA) dhe PNUD-in. Qëllimi ishte marrja e opinionit të drejtuesëve të FIE-ve në lidhje me mjedisin e biznesit në Shqipëri dhe objektivat e tyre të zhvillimit. Ekipi që u morr me punën kërkimore siguroi 66 përgjigje nga një kampion jo-përfaqësues i ndërmarrjeve të investimeve të huaja (FIE), së paku 60 përgjigje të vlefshme për çdo pyetje.

Tiparet kryesore të kampionit janë këto:

- Më shumë se gjysma e kompanive që morrën pjesë në vrojtimit janë krijuar përpara vitit 2005; të tjerat kanë një origjinë të mëvonëshme;
- 60 përqind e kompanive pjesëmarrëse në vrojtimit janë krijuar si investime të reja, ndërsa të tjerat janë investime brownfield;
- Me përjashtim të katër kompanive, të gjithë pjesëmarrësit ishin kryesisht me pronësi të huaj;
- Kompanitë janë themeluar nga investitorë të huaj nga 18 vende, shumica e të cilëve vijnë nga Italia, Greqia dhe Austria;
- Përsa u takon aktivitetet kryesore ekonomike, 21 nga kompanitë pjesëmarrëse janë ofrues të shërbimeve ICT, nëntë janë ofrues të shërbimeve financiare, ndërsa pjesa tjetër në miniera, ndërtim dhe industri të tjera; kurse vrojtimit iu përgjigj vetëm një kompani aktive në bujqësi.
- 28.6 përqind e të anketuarve janë ndërmarrje mikro me më pak se nëntë të punësuar, 35.7 përqind janë ndërmarrje të vogla që kanë të punësuar nga 10-49 persona, 12.5 përqind janë kompani të mesme që kanë të punësuar nga 49-250 persona dhe 21.4 përqind e tyre kanë më shumë se 250 të punësuar.
- 83 përqind e kompanive e kanë selinë në Tiranë, ndërsa pjesa tjetër janë të shpërndara nëpër të gjithë vendin.
- Vrojtimi mbulon afërsisht 10 përqind të filialeve të huaja në vend që është një shkallë e mirë përfaqësimi për të tilla lloje vrojtimesh.

FIE-të u pyetën për nivelin aktual të kënaqësisë me tiparet kryesore të mjedisit të biznesit dhe politikave qeveritare, në krahasim me pritshmëritë e tyre përpara fillimit të IHD-ve në Shqipëri (figura II.4). U shprehën disa opinione pozitive:

- Njësoj si në vrojtimin e vitit 2010, tri të katërtat e të anketuarëve janë shprehur pozitivisht në lidhje me ini-

FIGURA II.4

Vrojtimi mbi kënaqësinë e investitorëve: reagimet ndaj pyetjes “pasi keni investuar në Shqipëri, si ka qënë përvoja juaj deri më tani përkundrejt pritshmërive tuaja?”





FIGURA II.4. VIJON



Burimi: Vrojtimi i AIDA/FIAA/UNDP për ndërmarrjet e investimeve të huaja

ciativat e ndërmarra nga qeveria shqiptare në fushat e fillimit dhe licencimit të biznesit, sigurimit të lejeve të punës dhe rregullores së punësimit.

- Kompanitë janë shprehur pozitivisht në lidhje me kostot e krahut të punës, ndërveprimet me autoritetet dhe kapacitetet gjuhësore dhe ICT që gjenden në Shqipëri.
- 40 përqind e FIE-ve, në përgjithësi janë të kënaqura me sistemin tatimor dhe rregulloret për punësimin.
- 85 përqind e kompanive kanë pritshmëri pozitive për shtimin e aktiviteteve të tyre në Shqipëri.
- Pjesa dërmuese e kompanive ka ardhur në ekspansion gjatë viteve të fundit, 56.6 përqind e kompanive kishin më shumë punonjës në vitin 2010 sesa në vitin 2008, 68.1 përqind e kompanive kanë rritur xhiron, 66 përqind kanë rritur aksionet në treg. Në vitin 2012, 57 përqind e kompanive do të rrisin punësimin, ndërsa 35 përqind e tyre do ta mbajnë atë konstant.
- Më shumë mendime negative (zhgënjim) u shprehën për fushat në vijim:
 - Progresi drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian;
 - Funkcionimi i Gjyqësorit;
 - korrupsioni;
 - të drejtat e pronësisë mbi tokën;
 - mundësia për të gjetur burimet lokalisht;
 - sigurimi i lejeve të planifikimit dhe ndërtimit;
 - mungesa e zonave industriale apo ekonomike.

Gjithashtu, vrojtimi përmbante pyetje në lidhje me aktivitetet që FIE-të kryejnë në Shqipëri. Përsa i përket novatorizmit, FIE-të bazohen kryesisht tek teknologjia nga importi dhe nuk kanë aktivitete kërkim-zhvillimi (R&D) në Shqipëri. Vetëm 25 përqind e kompanive kanë investuar në aktivitete R&D, ndërsa mbi 72 përqind e tyre nuk kanë akorduar fonde për inovacionin e teknologjive apo në përfshirjen herë pas here në projekte R&D. Nga kompanitë e përfshira në aktivitete R&D, 32

përqind e tyre punojnë në bashkëpunim me një apo më shumë FIE dhe 22 përqind e tyre bashkëpunojnë me universitetet. Afërsisht 54 përqind e FIE-ve kanë investuar në monitorimin e regullt të tregut. Gjithashtu, 85 përqind e tyre kanë plane strategjike për vitet në vijim. Investimet do të financohen nga burimet e veta në 56 përqind të rasteve dhe vetëm 25 përqind përmes financimeve bankare.

Marrëdhëniet tregtare dhe ato të rrjeteve karakterizohen nga një mbizotërim i lëndëve të para të importit dhe shitjeve vendase. Kjo tregon orientimin ndaj tregut lokal të kompanive, përveç orientimit të dobët ndaj eksporteve. Por orientimi nga eksporti ndryshon nga njëra FIE tek tjetra sipas aktiviteteve të ndryshme ekonomike.

Një grup tjetër pyetjesh që iu drejtua kompanive kishte të bënte me pengesat që ato hasnin. Përgjigjet tregojnë se shumica e investitorëve të huaj mund të bazohen tek fonde të mjaftueshme dhe të gjejnë krah të mjaftueshëm pune për aktivitetet e tyre. Ato janë shumë të ndara përsa i përket disponueshmërisë së krahut të kualifikuar të punës, që mund të përkthehet në kërkesë për arsimim më të mirë dhe trainim profesional. Një fushë tjetër problematike ka të bëjë me qartësinë dhe paanësinë e ligjeve dhe rregulloreve, si edhe funksionalitetin e gjyqësorit dhe të sistemit tregëtar ligjor. Kushtet e aksesit në treg ishin të kënaqshme, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për ndërveprimin me autoritetet. Problemet në komunikimin me autoritetet janë shprehur gjithashtu edhe si pjesë e komenteve me shkrim.

Anëtarët e komunitetit të biznesit të huaj për të ardhmen parashikojnë që qeveria shqiptare të përmirësojë më tej klimën e biznesit përmes thjeshtësimit të procedurave administrative, përmirësimit të licensimit dhe zbatimit të shtetit ligjor. Në këtë aspekt, proceset post-regjistrim duhet të thjeshtohen më tej, duke ndihmuar në shmangien e burokracisë dhe në forcimin e kompetencave të agjencive publike. Ata kërkojnë stimuj të mëtejshëm tatimorë, një administratë më të mirë tatimore dhe përmirësim të infrastrukturës ekzistuese. Ata identifikojnë si pengesë ndaj biznesit mungesën e gatishmërisë së autoriteteve për zbatimin e ligjeve tatimore me të gjitha bizneset dhe se e gjejnë shumë të vështirë të marrin fatura të regullta nga bizneset e vogla. Për mendimin e tyre, kompanitë

e vogla vendase nuk i regjistrojnë të gjithë punëmarrësit e tyre dhe nuk e deklarojnë xhiron dhe rrjedhimisht përfitojnë nga avantazhe të pandershme konkurrese duke shmangur taksat. Sipas tyre, procedurat e ekzekutimit dhe transparencës në lidhje me procedurat e tenderave do të ndihmonin në kapërcimin e korrupsionit. Rekomandime të mëtejshme për politikën përfshijnë heqjen e TVSH-së për makineritë e importit dhe thjeshtimin dhe përmirësimin funksional të regjistrimit të tokës.

Përsa i përket rolit të AIDA-s dhe mbështetjes nga qeveria shqiptare, FIE-të pjesëmarrëse në vrojtimit rekomandojnë që AIDA të shndërrohet në një aktor aktiv dhe të bëhet bashkëpunëtor me kompanitë e huaja,

duke u ardhur atyre në ndihmë për zgjerimin e aktivitetit të tyre në Shqipëri. Gjithashtu, AIDA duhet të transmetojë të gjitha çështjet dhe problemet që parashtrihen nga investitorët tek institucionet publike dhe të sigurojë feedback. AIDA duhet të vijojë të nxisë mundësitë për investime dhe të mbështesë investitorët ekzistues dhe ata potencialë përmes një bashkëpunimi aktiv.

Së fundi, FIE-të riafirmojnë që përzgjedhja e Shqipërisë si një vend për të zhvilluar biznesin varet nga stabiliteti i politikave ekonomike, nga integriteti i qeverisë (ulja e korrupsionit), taksat të arësyeshme, qartësimi i pronësisë mbi tokën dhe disponueshmërinë e krahut të kualifikuar të punës.



ROLI DHE NDIKIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË BUJQËSINË SHQIPTARE

A. Tiparet kryesore të bujqësisë dhe politikat bujqësore në Shqipëri

1. Tendencat e prodhimit dhe kushtet natyrore

Bujqësia është një nga sektorët më të mëdhenj dhe me të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare. Aktiviteti ekonomik “bujqësi, gjueti dhe pyje” është punëdhënësi kryesor (44 përqind) duke qënë njëkohësisht edhe sektori i dytë për nga rëndësia ekonomike, sipas vlerës së shtuar (19 përqind) (tabela III.1). Punësimi në sektorin e bujqësisë ka pësuar një rënie të ndjeshme, por mbetet ende shumë lart sipas krahasimeve ndërkombëtare. Përqindja e këtij sektori në vlerën e shtuar gjatë pesë viteve të fundit ka pësuar një rënie më të ngadaltë sesa në gjysmën e

parë të viteve 90-të.

Pavarësisht nga progresi i bërë gjatë viteve të fundit, prodhimtaria e përgjithshme bujqësore në Shqipëri është më e ulët sesa në sektorët bujqësorë të vendeve të saj fqinje dhe të pjesës tjetër të Evropës, si edhe më e ulët nga mesatarja për ekonominë shqiptare, sic tregohet nga përqindja më e lartë e sektorit përsa i përket punësimit sesa në terma të vlerës së shtuar (tabela III.2). Por qysh nga viti 2005, rënia në përqindjen e punësimit ka qënë më e shpejtë sesa vlera e shtuar, gjë që flet për një përmirësim të produktivitetit të krahut të punës.

Shqipëria është vendi më bujqësor në Ballkanin Perendimor (tabela III.2). Përqindja e bujqësisë në vlerën e shtuar është afërsisht ose më poshtë se 10 përqind në të gjitha vendet e tjera të Ballkanit Perendimor, me përjashtim të

TABELA III.1

Përqindja e bujqësisë në ekonominë shqiptare, 1996–2009 (Përqind)

Viti	Vlera e shtuar	Punësimi
1996	36.6	70.3
2000	25.5	71.8
2005	20.6	58.5
2009	18.8	55.2
2010	20.3	55.3

Burimi: llogaritur bazuar në të dhënat e INSTAT-it

TABELA III.2.

Përqindja e bujqësisë në vlerën e shtuar dhe në punësim në ekonominë e Ballkanit Perendimor, 2009 (Përqind)

	Shqipëria	Bosnje Hercegovina	Kroacia	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	Mali i Zi	Serbia
Vlera e shtuar	18.8	8.8	6.7	11.6	10.0	10.5
Punësimi	55.2	2.7	13.9	18.5	6.2	23.9

Burimi: wiiw database, www.wiiw.ac.at, dhe INSTAT-i për Shqipërinë.

ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, ku kjo përqindje është disi më e lartë se 11 përqind. Përsa i përket punësimit, Bosnja & Hercegovina dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë kanë përqindje më të ulët sesa në terma të vlerës së shtuar, gjë që tregon se bujqësia në këto vende nuk është sektor me nivel të lartë të përdorimit të krahut të punës (Këto janë vende malore ku predominon mbarështimi ekstensiv i gjedhëve përkundrejt prodhimit të drithrave). Në vendet e tjera, përqindjet e punësimit janë më të larta sesa ato të vlerës së shtuar, ngjashëm me ato të Shqipërisë. Nuk është produktiviteti i sotshëm aq sa i potenciali për rritjen e produktivitetit në të ardhmen që mund t'i bëjë investimet në këtë sektor të favorshme në të gjithë rajonin.

Toka bujqësore (afërsisht 1.1 milionë ha) zë afërsisht 39 përqind të sipërfaqes së Shqipërisë, nga e cila 699,000 ha ose 63 përqind janë tokë e punueshme dhe pemë frutore, ndërsa pjesa tjetër janë pyje. Përdorimi i tokës është i stabilizuar, me një sërë kategorish të cilat kanë ndryshuar fare pak gjatë viteve të fundit. Gjatë 15 viteve të fundit, sipërfaqja e tokës bujqësore është ulur me 1.4 përqind, sidomos për shkak të zgjerimit të zonave urbane në ish toka bujqësore (kryesisht në zonat që rrethojnë Tiranën dhe qytetet e tjera kryesore), ndërsa një pjesë e tokave të papërdorura është kthyer në kullota.

Shqipëria karakterizohet nga tri zona kryesore bujqësore, në varësi të kushteve të përgjithshme klimatike, pjerësisë dhe lartësisë mbi nivelin e detit. Pjesa e ultësirës bregdetare është kryesisht e sheshtë, me një prodhimtari më të lartë dhe e përshtatshme për drithëra të tipit mesdhetar. Pjesa e mesme kodrinore karakterizohet nga pemë frutore, disa drithëra dhe kullota për blegtorinë. Zonat malore janë të përshtatshme për mbarështimin e gjedhit (në vecanti dele dhe dhi), rritjen e pemëve të ndryshme frutore dhe arnore, si edhe të bimëve medicinale dhe aromatike. Afërsisht 43 përqind e të gjithë tokës së punueshme dhe tokës së drithit gjendet në zonat e ulëta bregdetare, me kapacitet të lartë prodhimi, afërsisht 34 përqind gjendet në zonat kodrinore dhe afërsisht 23 përqind në zonat malore. Për shkak të vendndodhjes gjeografike dhe kushteve fizike, si edhe për shkak të fragmentarizimit të lartë, toka bujqësore është e shpërndarë në zona që janë të vogla për kultivimin e drithërave dhe të lashtave të tjera për të cilat nevojiten terrene të mëdha. Hapësira për fusha të mëdha në pllaja është e kufizuar, gjë që nuk shërben si stimul

për investitorë të mëdhenj në atë zonë. Prodhimi i përgjithshëm bujqësor ka pësuar rritje të lehtë gjatë dhjetë viteve të fundit, në vecanti në fruta, perime dhe blegtori.

Blegtoria është nën-sektori më i rëndësishëm i bujqësisë në Shqipëri, me afërsisht 52 përqind të të gjithë vlerës së prodhimit bujqësor në vitin 2011, e ndjekur më pas nga drithërat që zinin afërsisht 31 përqind dhe nga pemët frutore me afërsisht 17 përqind. Gjatë viteve 2001-2011, numri i blegtorisë pësoi një rënie, ku rënia më e ndjeshme është konstatuar në kategorinë e gjedhëve, duke përfshirë lopët, ndërsa numri i derrave është rritur me mbi 50 përqind. Megjithatë, prodhimi bujqësor ka pësuar rritje të ndjeshme (3-5 përqind në vit; 2.3 përqind në vitin 2011) si rezultat i përmirësimit të teknologjive të prodhimit, të racave, ushqimit dhe kujdesit për shëndetin e kafshëve në përgjithësi: prodhimi i mjaltit në vitin 2010 u rrit me 134 përqind në krahasim me vitin 2000; ndërsa prodhimi i vezëve dhe i mishit u rrit përkatësisht me 52 përqind dhe 25 përqind brenda së njëjtës periudhë. Përsa i përket prodhimit të qumështit, këtu ka patur një rritje të lehtë, me luhatje gjatë të gjithë periudhës.

Pemëtaria është dega që ka shënuar rritjen më të shpejtë ndër degët e bujqësisë gjatë periudhës 2000-2011, si përsa i përket zonave të kultivuara ashtu edhe përsa i përket totalit të rendimentit, ku përqindja është rritur nga 10 në 16 përqind. Gjatë viteve të fundit, fermerët po tregojnë më shumë interes për plantacionet e pemëve frutore dhe vreshtat. Pemët frutore kultivohen nga pothuajse 80 përqind e fermerëve. Edhe gjatë vitit 2011, një vit shumë i vecantë që u karakterizua nga periudha të gjata thatësire pati një rritje të prodhimit frutor me afërsisht 6 përqind, në krahasim me vitin 2010.

Kulturat e fushës kanë shënuar luhatje të ndjeshme si përsa i takon sipërfaqes së kultivuar, ashtu edhe përsa i takon vëllimit të prodhimit, ndërsa përqindja e tyre në prodhimin bujqësor shqiptar shënoi rënie nga 34 përqind në vitin 2000 në 32 përqind në vitin 2011. Në kategorinë e kulturave të fushës, patatet, foragjeret dhe perimet (sidomos përmes prodhimit të perimeve në sera) ishin aktivitetet që patën edhe rritjen më të lartë gjatë dhjetë viteve të fundit. Faktorët kryesorë që kanë nxitur shtimin e përdorimit të serave janë kërkesa e tregut dhe të ardhurat e larta në potencë për njësi sipërfaqejeje për perimet e prodhuara.

Sipërfaqja e kultivuar për foragjere është rritur, ndërsa ajo për drithëra është pakësuar me afërsisht 16 përqind gjatë periudhës së viteve 2001–2011. Kjo rënie reflekton konkurueshmërinë e ulët të kushteve të fermerëve shqiptarë në lidhje me këto drithëra, për shkak të shkallës së vogël të fermave, fragmentimit të tokës dhe mekanizimit në nivele të ulëta.

2. Pronësia e tokës, shkalla e fermave dhe tregu i tokës

Prodhuesit e huaj mund të kenë akses në tokën bujqësore në Shqipëri, duke u regjistruar si kompani në Shqipëri; kjo u bën të mundur atyre të blejnë apo të marrin me qera tokën njësoj si subjektet e tjera vendase. Ndonëse pronësia e tokës bujqësore nga subjekte të huaja nuk është e kufizuar, ajo mbetet shumë e kufizuar për shkak të çështjeve dhe problemeve ekzistuese në lidhje me pronësinë, të drejtat e pronësisë, tokat e fragmentuara dhe problemeve që lidhen me tregun e tokës.

Përsa i përket pronësisë, afërsisht 80 përqind e tokës bujqësore është në pronësi private të familjeve fermere. Në përgjithësi ka një predominim të fermave të vogla familjare, me një madhësi mesatare ferme prej afërsisht 1.2 ha¹⁰ dhe shumë prej tyre kanë disa parcela (mesatarisht 3.9 parcela për fermë). 41 përqind e fermave zënë më pak se 1 hektar, 43 përqind zënë 1–2 hektarë dhe 11 përqind zënë 2–5 hektarë, ndërsa madhësia mesatare e një parcele është 0.3 hektarë. Ky fragmentarizim ekstrem i tokës pengon prodhimin modern dhe aksesin e investitorëve të rinj.

Afërsisht 138,000 ha janë në pronësi shtetërore, nga të cilat afërsisht 108,000 ha janë në administrim të komunave dhe bashkive. Toka në pronësi publike në potencë është më lehtë e aksesueshme për investitorët sesa toka që është në pronësi private. Por kushtet e këtyre tokave nuk janë aq të mira sepse shumica e tyre gjenden në terrene kodrinore dhe malore dhe karakterizohen kryesisht nga cilësi e varfër e tokës, gjenden larg zonave urbane dhe u mungon aksesin i duhur në infrastrukturë dhe ujë. Nga 108 mijë hektarë tokë publike, vetëm afërsisht 25,000 hektarë janë në blloqe parce-

lash prej mbi 10 hektarë. Afërsisht 20,000 ha janë parashikuar për kompensim të pronarëve të shpronësuar gjatë periudhës së komunizmit, ndërsa pjesa tjetër me nivele të ulëta prodhimtarie ka kaluar nën administrimin e pushtetit vendor dhe mund të jepet me qera ose me koncesion.

Një pjesë e rëndësishme e fermave shqiptare kanë për qëllim plotësimin e nevojave të veta, ku shumica e produkteve bujqësore janë të destinuara për konsum familjar dhe siguron të ardhura të vogla për familjet në zonat rurale. Si rezultat, vetëm 40 përqind e prodhimit të kulturave të fushës, afërsisht 57 përqind e pemëve frutore dhe rrushit, 65 përqind e produkteve blegtorale dhe një përqindje e vogël e produkteve të përpunuara në ferma arrijnë në treg. Qysh nga viti 2000, në vend ka ndodhur një proces i ngadaltë për konsolidimin e tokës bujqësore. Në vecanti, dhënia e tokës me qera ka kontribuar në një rënie të lehtë të këtij lloji të zhvillimit të fermave dhe në rritje të efikasitetit të fermave të konsoliduara.

Gjithashtu, vihet re një tendencë e specializimit të fermave, në përputhje me evolucionin e kërkesës së tregut dhe mundësive të rritjes së prodhimtarisë. Rritja e konsolidimit dhe specializimit të fermave po haset në sektorin frutor dhe atë të perimeve, si edhe në sektorin e bujqësisë. Numri i fermave të bagëtive të mëdha, me 5 deri në 50 krerë bagëti pothuajse është trefishuar që nga viti 2005, gjë që shënoi një ndryshim drastik në këtë sektor. Gjithashtu ka patur një rritje të shpejtë të numrit të fermave të orientuara drejt tregut me tufa të mëdha dhish dhe delesh.

Procesi i konsolidimit të fermave është influencuar negativisht nga rritja e moshës së popullsisë fermere dhe nga rënia e interesit të rinjve për tu marrë me aktivitete bujqësore. Të dhëna nga vërtetimet të ndryshme flasin për një rënie të numrit të krahut të punës në bujqësi si pasojë e faktorëve të ndryshëm si: moshimi, migrimi, mungesa e mundësive për arsimim dhe trainim të krahut të ri të punës. Numri i të rinjve në krahun e punës në bujqësi dhe midis fermerëve ka ardhur në rënie. Shumë të rinj nuk e vazhdojnë aktivitetin bujqësor në fermat e vogla të trashëguara nga prindërit e tyre, duke preferuar tu drejtohen qyteteve ose emigracionit¹¹. Megjithatë, kriza ekonomike e

10 Në krahasim me një mesatare prej afërsisht 5 ha për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe 27 ha për vendet e Evropës Perendimore (Banka Botërore, viti 2007).

11 Numri i fermerëve të rinj në moshë, nën 40 vjeç shënoi rënie nga 43,000 (11.4 përqind) në vitin 2004 në

TABELA III.3.

Shqipëria: numri i ndërmarrjeve aktive, në total dhe në bujqësi dhe peshkim, viti 2010

Sektor	Total	Shqiptare	Të huaja	Joint venture	Person juridik	Memë shumë se 4 punëmarrës
Total ekonomi	100,687	97,763	1,719	1,205	19,824	9,121
Bujqësi & peshkim	1,702	1,679	4	19	357	111
Bujqësi	964	276	86
Peshkim	738	81	25

Burimi: INSTAT.

kohëve të fundit në Greqi, që është edhe shteti më i zakonshëm i emigrimit për shqiptarët ka bërë që mjaft individë të kthehen sërish në Shqipëri, duke sjellë me vete teknologji të avancuara bujqësore nga vendi ku kanë punuar si dhe një farë kapitali financiar. Në vitin 2011 u futën disa politika mbështetëse për të ndihmuar të kthyerit nga emigracioni që të integroheshin në aktivitetet bujqësore dhe ato të agrobiznesit. Të gjithë përfituesit duhet të paguanin taksën e pronësisë mbi tokën dhe të regjistroheshin në skemat e sigurimeve shoqërore, për të përfituar prej tyre.

Shumë pak ferma funksionojnë me të vërtetë në formë biznesi dhe që janë kryesisht ato më të mëdhatë dhe modernet. Regjistri i ndërmarrjeve në vitin 2010 përfshinte mbi njëqind mijë ndërmarrje aktive, nga të cilat 1 përqind ishin në bujqësi (tabela III.3). Vetëm katër sipërmarrje janë me pronësi të huaj, ndërsa 19 janë shoqëri të përbashkëta shqiptare dhe kompani të huaja. Duke marrë në konsideratë që investimet e huaja nuk janë në formën e fermave familjare, por në formë firmash/biznesesh, numri i investitorëve të huaj është vërtet shumë i kufizuar. Bizneset bujqësore janë kryesisht të vogla, vetëm 8.9 përqind e tyre kanë së paku pesë punëmarrës.

Qeveria shqiptare, me mbështetjen e projekteve nga donatorët ka përmirësuar kuadrin ligjor, si edhe kapacitetet administrative të siste-

23,800 në vitin 2008 (6.7 përqind). Në vitin 2008, mbi 50 përqind e fermerëve ishin mbi 55 vjeç dhe 30 përqind mbi 65 vjeç. Vetëm 33 përqind e fermerëve kanë mbaruar shkollën e mesme apo të lartë ndërsa 48 përqind kanë mbaruar tetëvjeçaren; vetëm 30 përqind e fermerëve kanë arsim agrar dhe këta janë kryesisht ata që kanë mbaruar shkollat bujqësore profesionale në të kaluarën.

mit të administrimit dhe manaxhimit të tokës. Projekti i financuar nga Banka Botërore gjatë viteve 2001-2007 për Konsolidimin e Tokës inkurajoi konsolidimin e tokës në disa komuna të përzgjedhura pilote, përmes subvencionimit të kostove të transaksioneve dhe përmes asistencës teknike për lehtësimin e transaksioneve të tokës sipas tregut dhe përmes një studimi politikash në lidhje me konsolidimin e tokës. Progresi i mëtejshëm është penguar nga mungesa e një ligji për konsolidimin e tokës, kostot e larta të transaksioneve të tokës dhe marzhet e larta të gabimeve në lidhje me informacionin mbi pronësinë e tokës. Megjithatë, ky projekt mbështeti 189 transaksione të tokës bujqësore, duke rezultuar në një masë të konsoliduar të tokës prej 94 ha. Në vitin 2010, me mbështetjen e FAO-s dhe Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, morri rrugë një projekt i ri që kishte si synim hartimin e një strategjie kombëtare për konsolidimin e tokës, me pjesëmarrjen vullnetare të pronarëve të tokës dhe aktorëve të interesit.

Kadastra e tokës përfshin të gjithë tokën bujqësore dhe e identifikon pronarin e tokës, në shumicën e rasteve. Administrimi i tokës ende po përballlet me shumë probleme si: përfundimi i regjistrimit të tokës dhe regullimi administrativ i të drejtave të pronësisë mbi tokës (kryesisht lëshimi i titujve të pronësisë), zgjidhja e konflikteve në lidhje me pronësinë e tokës, zhvillimi i tregut të tokës për qëllime bujqësore, manaxhimi sic duhet i tokës së privatizuar dhe rritja e efikasitetit të përdorimit të saj, dhe përdorimi i tokës në pronësi publike. Mosmarrëveshjet ndodhin kryesisht pranë zonave urbane ose në territore të tjera më me vlerë të vendit. Fermerët mund t'i marrin titujt e tokave të tyre në rastet kur nuk ekzistojnë mosmarrëveshje, por refuzojnë ta bëjnë një gjë të tillë për shkak të tarifave që iu duhet të

TABELA III.4.

Shqipëria: përqindja e bujqësisë dhe produkteve ushqimore në tregëtinë e huaj (si përqindje)

Tregtia	2000	2005	2009	2010	2011
Importet CIF	22.3	17.6	17.3	17.5	16.9
Eksportet FOB	10.3	8.2	7.3	5.8	5.7
Bilanci tregëtar (eksportet - importet)	25.9	20.7	20.5	23.9	23.3

Burimi: INSTAT.

paguajnë dhe për shkak të procedurave të gjata që iu duhet të ndjekin.

Tregu i tokës dhe qeradhënia, në mënyrë zyrtare nuk mund të funksionojë sic duhet derisa fermerë të kenë marrë në dorë titujt e pronësisë mbi tokën e tyre.¹² Ndër faktorët që pengojnë zhvillimin e tregut zyrtar të tokës rurale janë: perceptimi i tokës si rrjet i sigurisë sociale; probleme me pronësinë e tokës dhe pretendime të pazgjdhura dhe konfliktuale në lidhje me tokën; perceptimi se regjistrimi i tokës haraxhon kohë dhe ka kosto të lartë; si edhe tregjet e dobëta të kreditimit. Mungesa e një tregu funksional toke pengon aksesin e ndërmarrjeve të huaja në lidhje me aktivitetet bujqësore.

3. Tregëtia bujqësore dhe politikat tregtare

Shqipëria ka një deficit të madh tregëtar në lidhje me produktet bujqësore dhe ushqimore, ku eksportet arrijnë në afërsisht 10 përqind të importeve. Përqindja e këtij grupi produktesh në importe ka qënë shumë stabilë në vitet e fundit (2005-2010) në afërsisht 17 përqind, ndërsa përqindja e po këtij grupi në eksporte ka patur luhatje midis 6–8 përqind (tabela III.4). Një e pesta e të gjithë deficitit të tregëtisë së jashtme shqiptare vjen nga ky sektor. Gjatë viteve 2005-2009, deficitit tregëtar në prodhimet agrorshqimore u rrit me 58 përqind; ai u përkeqësua në mënyrë të vecantë gjatë viteve 2007 dhe

2010, për shkak të rënies së eksporteve të disa prodhimeve bujqësore dhe rritjes së importeve. Gjithashtu, deficitit tregëtar në këto produkte në vitet e fundit është ndikuar negativisht edhe nga rritja e cmimeve të produkteve të importit, e cila ka qënë më e lartë sesa rritja e cmimeve të eksporteve shqiptare. Shkaqet e bilancit negativ të tregëtisë përfshijnë edhe kostot e larta të prodhimit, fragmentarizimin e lartë të ofertës, zinxhirët e dobët të vlerave dhe organizimin e dobët të tregut, si edhe manaxhimin të dobët të cilësisë.

Produktet më të mira të eksporteve agrorshqimore shqiptare janë produkte të tregjeve specifike që kërkojnë metoda prodhimi me përqëndrim të lartë të krahut të punës: si p.sh. bimët mjekësore dhe vajore, farërat dhe peshku. Shqipëria është një ndër furnizuesit më të rëndësishëm të disa bimëve si: sherebela, lisna, etj. Gjithashtu, vitet e fundit, Shqipëria ka nisur eksportin e perimeve dhe frutave të freskëta (në vecanti perimet dhe frutat e fillimit të sezonit).

Prodhuesit ushqimorë e importojnë shumicën e lëndës së parë për industrinë e tyre përpunuese. Industria vendase e përpunimit të mishit varet kryesisht nga mishi i importit i papërpunuar (që vjen kryesisht nga Brazili dhe Argjentina). Po kështu, drithërat, vera, vaji vegjetal dhe disa lloje frutash ekzotike vijnë kryesisht nga importi. Megjithatë, për shkak të rritjes së prodhimit vendas, frutat dhe perimet që mund të prodhohen në vend (si p.sh. molla) importohen pothuajse vetëm jashtë sezonit për prodhim vendas.

Përqindja më e lartë e gjithë eksporteve shqiptare të produkteve bazë bujqësore përfaqësohet nga grupi “bimë mjekësore dhe eterovajore”. Në vitin 2011 kjo përqindje ishte 36.6 përqind dhe produktet eksportoheshin kryesisht drejt Gjermanisë dhe Shteteve të Bashkuara. Vlera e eksporteve të këtij grupi produktesh u rrit në

12 Që nga viti 2007, më pak se 2 përqind e familjeve rurale e ka shitur tokën në tregun zyrtar, qysh nga fillimi i privatizimit dhe vetëm 3.6 përqind e tyre e kanë dhënë atë me qera. Megjithatë, ka fakte që tregu informal i tokës rurale është më aktiv. Përlogaritjet tregojnë se 6 përqind e fermave familjare e kanë dhënë tokën me qera dhe masa totale e fermave po vjen duke u rritur, cka flet për faktin që fermerët janë të përfshirë në transaksione informale të tokës mes njëri-tjetrit.

vitin 2011 me 49 përqind, krahasuar me vitin 2010. Eksportet e “të brendshmeve & lëkurëve të gjedhëve dhe kuajve” u rritën me 4.4 përqind në vitin 2011, ndonëse vlera e tyre ende vazhdon të përbënte 14 përqind të totalit të eksporteve, kurse eksporti i domateve u trefishua.

Në vitin 2011, afërsisht 73 përqind e eksporteve të produkteve bujqësore shkoi në tregjet e BE-së, ndërsa 17 përqind në tregjet e vendeve të CEFTA-s2006¹³ dhe 10 përqind në pjesën tjetër të botës. Afërsisht 57 përqind e importeve shqiptare të produkteve bujqësore e kishin origjinën nga vendet e BE-së, 14 përqind nga vendet e CEFTA2006 dhe 29 përqind nga pjesa tjetër e globit. Një rritje e ndjeshme e vëllimit të tregtisë (56 përqind) me vendet e CEFTA2006 u vu re në vitin 2010 (në krahasim me vitin 2009), ku eksportet u rritën me 59.6 përqind, ndërsa importet me 55.4 përqind.

Në vitin 2010, Italia ishte destinacioni kryesor për eksportin e produkteve bazë dhe të përpunuara bujqësore, me 39 përqind të totalit, e ndjekur nga Gjermania (21 përqind), Greqia (15 përqind) dhe Austria (11 përqind). Një situatë e ngjashme vihet re edhe për importet, ku Italia mbetet sërish vendi kryesor i origjinës për produktet bazë dhe ato të përpunuara bujqësore me 28 përqind, e ndjekur nga Greqia (25 përqind). Në vitin 2011 u shënua një risi ku eksportet drejt vendeve si Lituania, Hungaria dhe Republika Çeke u rritën në një nivel të ndjeshëm. Ekonomitë fqinje të vendeve të Ballkanit Perëndimor, në vecanti Kosova, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia kanë nisur të marrin rëndësi më të madhe në tregëtimin e produkteve bujqësore të Shqipërisë, edhe në kuadrin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë të nënshkruara nga këto vende.

Pavarësisht zhvillimeve të fundit, eksportet shqiptare të produkteve të përpunuara bujqësore mbeten akoma në nivele të ulëta, kryesisht për shkak të mungesës së teknologjisë, sic mund të jenë magazinat moderne, paketimi dhe etiketimi i produkteve të përpunuara. Ndër produktet që ndikojnë më shumë në gjenerimin e deficitit janë nga njëra anë pije dhe duhani, ku Shqipëria ka pak mundësi për rritjen e prodhimit aktual dhe në të ardhmen, dhe nga ana tjetër grupe produktesh ku Shqipëria mund të zhvillojë një industri efektive si:

13 Shqipëria, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Republika e Moldavisë, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova (UNMIK).

produktet e bulmetit, mishi i deles dhe i dhisë, frutat dhe arrat, si edhe perimet. Zëvendësimi i importeve është një objektiv i vlefshëm, sikundër zgjerimi i eksporteve në gamën e përzgjedhur të produkteve (PNUD-i 2005a). Futja e investitorëve të huaj mund ta lehtësojë këtë proces, sidomos në agro-përpunim, si dhe mund të ndikojë në rritjen e kapaciteteve të eksportit për të gjithë sektorin agror.

Aktualisht, politikat tregëtare shqiptare në fushën e produkteve bujqësore (OBT, 2010) janë në përputhje me angazhimet e vendit në kuadrin e (i) Organizatës Botërore të Tregtisë, (ii) Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit midis Shqipërisë dhe Bashkimit Europian (MSA), (iii) Marrëveshjes së Tregëtisë së Lirë me vendet e CEFTA2006 dhe (iv) Marrëveshjes së Tregëtisë së Lirë midis Shqipërisë dhe Turqisë. Shqipëria u bë anëtare e OBT-së në vitin 2000, kurse MSA-ja me BE-në hyri në fuqi në vitin 2009.

Shqipëria po zbaton një regjim liberal të tregtisë ndërkombëtare të produkteve bujqësore dhe ushqimore, karakteristikat kryesore të të cilit janë si më poshtë vijon: (i) një sistem i thjeshtë tarifor i përbërë nga 5 shkallë tarifash të kombit më të favorizuar në tregëti (MFN), 0, 2, 5, 10 dhe 15 përqind, vetëm mbi baza *ad valorem*; (ii) moszbatimi i “kuotave tarifore” për kombin më të favorizuar; (iii) aplikimi i tarifave sezonale për grupe produktesh; (iv) zbatimi i një sistemi tatimor të vetëm të vlerës së shtuar; (v) akciza aplikohet për një grup produktesh bujqësore; (vi) në regjimin e saj tregëtar të kombit më të favorizuar në tregëti, Shqipëria nuk përdor stimuj fiskalë apo skema mbështetëse për importin dhe eksportin e produkteve bujqësore dhe nuk ofron ndihmë shtetërore, me përjashtim të nxitjes së transferimit të teknologjive dhe novacionit (duke qënë një masë e lejuar e ndihmës shtetërore); (vii) zbaton një sistem për licensimin e importeve në përputhje të plotë me marrëveshjen GATT të vitit 1994 për licensimin importeve që kryhet nga Qendra Kombëtare e Licencimit. Në kuadrin e angazhimeve të saj me OBT-në, Shqipëria i ka thjeshtuar të gjitha linjat e tarifave në bujqësi dhe nuk ka kuota tarifore (OBT, 2010). Për disa importe të caktuara kërkohen certifikata fitosanitare apo shëndetësore, ndërsa importuesit e disa produkteve të caktuara duhet të jenë të licensuar. Me anëtarësimin e saj në OBT, Shqipëria nuk rezervon të drejtën për të aplikuar mekanizmin e vecantë për mbrojtjen e ndonjë produkti bujqësor. Gjithashtu, Shqipëria nuk ka bërë

ndonjë njoftim pranë OBT-së në lidhje me kufizime eksportesh në kuadrin e Nenit 12.1(b) të Marrëveshjes për Bujqësinë. Ajo ka njoftuar OBT-në që për periudhën 2000–2008, ajo nuk ka dhënë subvencione për eksportet.

Duke qenë vend anëtar i CEFTA2006, Shqipëria liberalizoi tregëtinë e saj me vendet e CEFTA-s, duke nisur nga viti 2012. Një Protokoll Shtesë i Marrëveshjes për Amendamentin dhe Anëtarësimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore u nënshkrua midis Shqipërisë, Kroacisë, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi, Republikës së Moldavisë dhe Serbisë për liberalizimin e koncensioneve për tregëtimin e produkteve bujqësore në fund të vitit 2011 dhe në fillim të vitit 2012. Gjithashtu, Shqipëria po zbaton një marrëveshje të tregëtisë së lirë me Turqinë (që hyri në fuqi në maj të vitit 2008) si edhe me vendet e EFTA-s. Në të gjitha marrëveshjet e tregëtisë së lirë, liberalizimi i importeve dhe eksporteve përcaktohet në varësi të shkallës së sensitiviteti: (i) për një grup produktesh janë eliminuar tarifatat doganore; (ii) për një grup produktesh aplikohen kuota tarifore; (iii) produkte të tjera nuk janë objekt liberalizimi; rrjedhimisht për to vijon zbatimi i tarifave MFN. Manaxhimi i kuotave bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duke u mbështetur në parimin “kush vjen i pari, shërbehet i pari”. Duke qenë se regjimi i tregëtisë me jashtë nuk përbën pengesë për zhvillimin e eksporteve, investitorët e huaj mund të synojnë biznesin agroushqimor të vendit, me qëllim prodhimin për tregjet rajonale.

4. Politikat bujqësore të qeverisë shqiptare

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK) përgjigjet për hartimin e politikave dhe zbatimin e tyre në sektorin e bujqësisë. Kjo ministri përgjigjet gjithashtu për hartimin e projekt-ligjeve dhe rregulloreve; ofrimin e këshillimit dhe trainimeve; studimeve analitike dhe zhvillimore; si edhe ofrimin e aktiviteteve të shërbimit publik, si p.sh. ujitje dhe kullim, si edhe shërbime ekstensionit; kërkime bujqësore dhe kontroll laboratorik; shërbime ndërzimi; analizë e politikave bujqësore; dhe shërbime marketingu. Një agjenci e krijuar rishtazi e quajtur Agjencia e Pagesave (Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural), nën varësinë e Ministrisë së Bujqësisë ka për detyrë zbatimin e masave

të politikave bujqësore, duke përfshirë administrimin e fondeve nga buxheti i shtetit dhe fondet e Instrumentit të BE-së për Asistencë para-anëtarësimin në fushën e Zhvillimit Rural (IPARD), si edhe me punën analitike dhe vlerësuese. Përafrimi me ligjet e BE-së do të kërkojë gjithashtu forcimin e Drejtorisë së Zhvillimit Rural në Ministrinë e Bujqësisë, si Autoriteti Manaxhues i IPARD-it që duhet të akreditohet nga BE-ja dhe do të përgjigjet për hartimin e politikave dhe programeve në lidhje me përdorimin e fondeve të zhvillimit rural.

Qeveria shqiptare ka dy dokumente kryesore strategjike që lidhen me zhvillimin bujqësor dhe rural: “Strategjia për sektorin e bujqësisë dhe ushqimit 2007–2013 (SSBU)” dhe “Strategjia ndër-sektoriale për zhvillimin rural për periudhën 2007–2013 (SNSZHR)” të hartuara nga MBUMK dhe të miratuara nga Këshilli i Ministrave. Dy dokumente të tjera të rëndësishme për sektorin janë: “Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim, 2007–2013 (SKZHI)” ku përfshihen objektivat afatshkurtra dhe afat-mesme për të gjithë sektorët, duke përfshirë bujqësinë dhe Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA), i cili evidenton programet, objektivat dhe aktivitetet e përcaktuara brenda planit fiskal të qeverisë. Ligji kryesor për sektorin bujqësor është Ligji Nr. 9817, datë 22 tetor 2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.¹⁴

SSBU parashtron programin e qeverisë shqiptare për sektorin, në përputhje me objektivin e përgjithshëm të rrugës drejt integritimit në BE. AFSS përfaqëson komponentin bujqësor të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI). Ajo përcakton pesë prioritete strategjike: rritjen e mbështetjes fi-

14 Si ligji ashtu edhe SNSZHR bazohen në katër katër rregullore kryesore të BE-së: Rregullore e Këshillit (EC) Nr. 1698/2005, datë 20 shtator 2005 Mbi mbështetjen për zhvillimin rural nga Fondi Evropian Bujqësor për Zhvillimin Rural (EAFRD); Rregullore e Këshillit (EC) Nr. 1234/2007, datë 22 tetor 2007 “Krijimi një organizate të përbashkët të tregjeve bujqësore dhe për disa dispozita specifike për produkte të vecanta bujqësore; Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 1782/2003, datë 29 shtator 2003 (variant i konsoliduar) ku përcaktohen rregullat e përbashkëta për skemat e mbështetjes direkte, në kuadrin e politikave të përbashkëta bujqësore dhe përcaktimin e skemave për mbështetjen e fermerëve; dhe Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 1290/2005, datë 21 qershor 2005 Mbi financimin e politikave të përbashkëta bujqësore-CAP.

nanciare për fermat dhe bizneset e agropërpunimit; përmirësimin e manaxhimit të ujitjes dhe kullimit të tokës bujqësore; përmirësimin e marketingut të produkteve bujqësore dhe atyre të agropërpunimit; rritjen e nivelit dhe cilësisë të teknologjive, informacionit dhe dijve të fermerëve dhe bizneseve të agropërpunimit; dhe cilësi më të mirë dhe siguri të produkteve bujqësore dhe të agropërpunimit. Gjithashtu janë identifikuar disa nën-sektorë të caktuar strategjikë për zhvillime prioritare: zhvillimi i pemtarisë (duke përfshirë ullishtat) dhe vitikulturës; hortikulturës; blegtorisë; si edhe përpunimi industrial i perimeve, qumështit dhe mishit.

SNSZHR-ja jep udhëzime në lidhje me objektivat dhe aktivitetet për zbatimin e secilit prej katër akteve kryesore, si më poshtë vijon:

- Aksi 1: Përmirësimi i konkurrueshmërisë së bujqësisë, agrobiznesit dhe pyjeve, duke përfshirë: (i) modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë; (ii) rritjen e vlerës së shtuar dhe cilësisë të prodhimit dhe përpunimit; (iii) manaxhimin e qendrueshëm dhe efikas të pyjeve; (iv) rritjen e nivelit të kompetencave dhe punësimit.
- Aksi 2: Ruajtja e peisazhit kulturor dhe mbrojtja e mjedisit, duke përfshirë: (i) ruajtjen e peisazhit në zona më pak të favorizuara; dhe (ii) prezantimin e praktikave bujqësore miqësore me mjedisin.
- Aksi 3: Përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale dhe nixtja e diversifikimit, duke përfshirë: (i) krijimin e mundësive për vende të reja pune në zonat rurale; dhe (ii) përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat rurale.
- Aksi 4: Zhvillimi rural me pjesëmarrje, duke përfshirë mbështetjen për: (i) hartimin e strategjive lokale të zhvillimit; (ii) krijimin dhe fillimin nga puna e platformave për novatorizëm rural; (iii) krijimin dhe forcimin e grupeve lokale të veprimit; (iv) zbatimin e strategjive të zhvillimit lokal; (v) nxitjen e bashkëpunimit mes rajoneve; dhe (vi) zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Marrëveshja e Partneritetit të Shqipërisë me BE-në u miratua në nëntor të vitit 2007 dhe Shqipëria dorëzoi aplikimin e saj për statusin e vendit kandidat në prill të vitit 2009. Në këtë marrëveshje përshkruhen prioritetet krye-

sore për zhvillimin e ardhshëm të politikave bujqësore. Në periudhën afat-shkurtër, prioriteti qëndron në përmirësimin dhe zbatimin e ligjit për ushqimin, në përputhje me standardet e BE-së, në forcimin e sistemit të sigurisë ushqimore dhe sistemet e tjera përkatëse të kontrollit, si edhe në përmirësimin e legjislacionit dhe praktikave fitosanitare dhe veterinarë. Momentin që BE-ja i akordon Shqipërisë statusin e vendit kandidat, Shqipëria do të ketë akses tek fondet e IPARD-it. Për përdorimin real të fondeve të IPARD-it, Shqipërisë ende i mbetet për të realizuar disa kërkesa sipas rregulloreve të Instrumentit të Asistencës përpara anëtarësimit (IPA): (i) përfundimi dhe miratimi i Planit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal (NRDP) dhe (ii) forcimi dhe certifikimi i Autoritetit të Manaxhimit dhe Agjencisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Për këtë qëllim, BE-ja po financoon disa projekte për ngritjen e kapaciteteve të MBUMK për forcimin e kapaciteteve të saj dhe përafrimin e strukturave të saj me kërkesat e IPARD-it. Gjithashtu, në periudhën afat-mesme Shqipëria parashikohet të zhvillojë strategji për përdorimin e tokës, krijimin e tregut të tokës, zhvillimin rural dhe diversifikimin e aktiviteteve fermere me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë bujqësore. Strategjia ekonomike dhe fiskale e qeverisë për vitet 2011–2013 ka si objektiv përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit në fushën e sigurisë ushqimore me atë të BE-së, duke përfshirë monitorimin dhe kontrollin e produkteve ushqimore, në përputhje me standardet e BE-së.

Mbështetja vendase për sektorin bujqësor ka dy forma: masa për stabilizimin e tregut gjatë kushteve të paqëndrueshme të tregut dhe pagesa direkte për prodhuesit. Mbështetja vendase duhet të jetë në përputhje me kriteret e mëposhtme: (i) duhet të ketë efektin e cimeve mbështetëse në nivel prodhuesish; (ii) mbështetja për një produkt specifik nuk duhet ta kalojë 5 përqind të vlerës totale të prodhimit vjetër të një produkti të tillë; dhe (iii) mbështetja totale që nuk është specifike për produktin nuk duhet ta kalojë 5 përqind të të gjithë vlerës së prodhimit bujqësor gjatë vitit përkatës.

Subvencionet direkte për prodhimin bujqësor nisën në vitin 2007 me një total prej afërsisht \$5 milionë dhe shënuan një rritje në \$8 milionë në vitin 2008 dhe në \$10 milionë në vitin 2009 dhe 2010. Shuma u ul në afërsisht \$7 milionë në vitin 2011, por për vitin 2012 parashikohet të jetë në \$11 milionë. Mbështetja e qeverisë nisi me pagesat për kri-

jimin e pemetoreve dhe vreshtave të reja dhe më pas ka vijuar me pagesa fikse për krerë lopë dhe dele, si edhe me pagesa për kosheret e bletëve, mbarështimin intensiv të kërmijve, prodhimin e vajit të ullirit dhe mbjelljen e disa perimeve. Pagesa kombëtare u bënë për pemtore dhe vreshta të reja, si edhe për zhvillimin e mëtejshëm të sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve, aktiviteteve të pasvjeljes, manaxhimit të tokës etj. Për qëllimet e praktikave të mira të mbarështimit dhe menaxhimit të kafshëve është futur tashmë praktika e matrikullimit të tyre. Disa prej instrumenteve të politikave që përfshijnë asistencën financiare apo stimujt për fermerët janë huatë dhe skemat e granteve përmes Agjencisë së Pagesave për investime në teknologjitë e prodhimit, në marketing si edhe subvencione të përqindjeve të interesit për huatë nga bankat private. Gjithashtu, Agjencia për Zhvillimin e Zonave Malore (MADA)¹⁵ mundëson rritjen e aksesit të fermëve dhe agrobizneseve në financime përmes Instrumentit të Mbështetjes së Kreditimit (një instrument për garantimin e kredive) dhe siguron fonde grant dhe mbështetje teknike dhe investime për forcimin e zinxhirave të vlerave kryesore dhe përmirësimin e lidhjeve të tregut për fermerët e zonave malore dhe agrobizneset.

Në vitin 2011, mbështetja për sektorin e bujqësisë përfshinte 16 masa mbështetëse në nivel kombëtar (Kutia III.1) dhe pesë masa për zona më pak të favorizuara. Gjithashtu përvec mekanizmave ekzistuese u krijua dhe një fond garancie për huatë e marra për aktivitetet agroindustriale, si edhe për aktivitetet bujqësore me synim eksportin, që garanton deri në 50 përqind të principalit për huatë deri në \$250,000.

Sipas AFSS-së, zhvillimi i hortikulturës në sera konsiderohet si një ndër rrugët më efektive për rritjen e prodhimit. Viti 2012 është viti i katërt që subvencionohen serat. Kriteret janë në përputhje me teknologjitë e avancuara, d.m.th. me mbulesa plastike që përdoren në sera, të cilat duhet të kenë jetëgjatësi dhe të respektojnë parametrat modernë. Futja e sistemeve të ujtitjes me pika ka qënë pjesë e skemave

15 MADA po zbaton dy programe: (i) Zhvillimi i Qendrueshëm Rural i Zonave Malore – (SDRMA 2007-2013); (ii) Programi nga Mali në Treg – MMP 2009-2014) të financuara nga Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor i Kombeve të Bashkuara (IFAD), nga fondi i OPEC-ut për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID) dhe nga qeveria shqiptare.

të subvencioneve që nga viti 2009. Mbështetja për industrinë e vajit të ullirit u është siguruar vetëm atyre prodhuesëve që prodhojnë vaj cilësor ekstra të virgjër. Mbështetja për kthimin tek fermat organike është një tjetër politikë që lidhet me subvencionet ku tradicionalisht është paguar një prim për fermat e konvertuara në të

Kutia III. 1.

Shqipëria: 16 masat kombëtare mbështetëse për bujqësinë

1. Mbjellja e pemëve frutore (mollë, dardha, kumbull, qersh, pjeshkë, lajthi dhe luleshtrydhe), e ullinjve dhe agrumeve, jo më pak se 0.4 ha për fermerët individualë dhe jo më pak se 1 ha për grupet e fermerëve, 50 përqind e kostove legjitime të projekteve, por jo më shumë se 3,100 €/ha.
2. Për krijimin e vreshtave të reja, me një sipërfaqe jo më pak se 0.5 ha për fermerët individualë dhe jo më pak se 1 ha për grupet e fermerëve, 50 përqind e kostove totale legjitime të projekteve, por jo më shumë se 4,600 €/ha.
3. Ujitja me spërkatje për kopështet, agrumet dhe ullishtat intensive, 50 përqind e kostove totale legjitime të projekteve, por jo më shumë se 2,300 €/ha.
4. Për mbrojtjen e ullishtave nga miza e ullirit 125 €/ha.
5. Për certifikimin e produkteve bio të bujqësisë nga bimët e kultivuara: (i) për prodhimin që ka për synim tregun vendas, jo më shumë se 50 përqind të kostove të certifikimit dhe jo më shumë se 125 €/për fermë/për vit; (ii) për prodhimin për eksport, 50 përqind e kostove të certifikimit, por jo më shumë se 540 €/për fermë/në vit.
6. Për fidanët e prodhuar për varietet "autoktone" të rrushit "Kallmet", "Debinë" dhe "Vlosh", për fidanishtet me sipërfaqe jo më pak se 0.3 ha, 9300 €/ha.
7. Ndërtimi i puseve për ujitjen e kopështeve me pemë frutore, agrume dhe ullinj, 50 përqind e gjithë vlerës së projektit, por pa e kaluar shifrën 775 €/për pus.
8. Sigurimi i shtresave të reja plastike për të mbuluar serat tunel, 0.2 ha e lart, 2,300 €/ha/për serë.
9. Për serat me ngrohje teknike për prodhimin e perimeve – për të ndryshuar llojin e ngrohjes nga ai me naftë në ngrohje solare, 11,600 €/ha.
10. Prodhimi i kërpudhave, 50 përqind e kostove të pajisjeve dhe të instalimit, por jo për më shumë se 3,900 €/ha.
11. Pagesat për 77 €/krerë të fermave blegtorale me më shumë se 10 lopë qumështi, por jo më shumë se 30 krerë; gjithashtu do të përfitojnë vetëm ata fermerë që u lëshojnë fatura blerësve kur shesin qumështin.
12. Pagesa prej €3.8 për kokë dele, për fermerët që kanë më shumë 50 kokë të deleve të cilave u janë vënë etiketat; do të përfitojnë vetëm ata fermerë që u lëshojnë fatura blerësve kur shesin qumështin.
13. Pagesa prej €3.8 për koshere bletësh për ata fermerë që kanë mbi 50 koshere.
14. Mbarështim intensiv i kërmijve, 50 përqind e vlerës së parcelës për një ha, por pa kaluar 3,880 €/ha.
15. Për prodhimin e vajit ekstra të virgjër: 0.8 €/litër;
16. Mbështetje përmes subvencionimit të përqindjeve të interesit për huatë për agropëpunim dhe për huatë e marrë gjatë vitit 2008 nga kompanitë që mbledhin, magazinonjë dhe përpunojnë produkte bujqësore dhe blegtorale, shoqatat për prodhimin dhe tregëtimin bujqësor të regjistruara në bazë të Ligjit Nr. 8088, datë 21 mars 1996 "Për kompanitë me bashkëpunim reciprok" deri në 15,500 €, por pa kaluar 50 përqind të përqindjes së interesit dhe për jo më shumë se tre vjet.

Burimi: Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Shqipëri.

tilla. Në vitin 2012, primi do të paguhet mbi bazën e numrit të prodhimeve organike dhe sipërfaqes së mbjellë.

Taksa e tokës bujqësore është përkufizuar si taksë pronësie që arkëtohet dhe administrohet nga pushteti vendor. Me qëllim nxitjen e investimeve në pemëtari dhe pemetore frutore, toka e mbjellë me pemë frutore përjashtohet nga taksa për tokën për një periudhë pesë vjeçare, nga data e mbjelljes. Pagesa e taksës së tokës bujqësore është kusht për përfitim edhe nga subvencionet publike. Për përfitimin e granteve duhet të paraqiten fatura të regullta të qumështit të shitur.

Forma më e rëndësishme e mbështetjes financiare është subvencionimi i përqindjes së interesit, që mbulon 70 përqind të tarifës së interesit për investitorët që marrin kredi pesë vjeçare për magazinim dhe përpunim, për makineri bujqësore, tankera ftohës për qumështin, për peshkimin dhe përpunimin e frutave të detit. Një instrument tjetër që do të përdoret gjatë vitit 2012 është sigurimi i kredive pa interes (duke përdorur një fond kontraparti të disponueshëm nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural) për aktivitete si: blerja dhe instalimi i linjave të përpunimit dhe seleksionimit të arrave, lajthive dhe shegëve; ndërtimi i serave për fidanishtet dhe aroret; ndërtimi ose modernizimi i stallave dhe objekteve mbështetese për blegtorinë; blerja dhe instalimi i dhomave frigoriferike; blerja e makinerive bujqësore.

Një pjesë tjetër e rëndësishme e politikave bujqësore ka të bëjë me inkurajimin e legalizimit dhe formalizimit të aktiviteteve bujqësore. Qeveria e ka ulur takën e TVSH-së nga 20 përqind në 14 përqind për ata fermerë që përdorin sistemin formal të tregëtisë. Gjithashtu, qeveria ka inkurajuar bashkëpunimin mes fermerëve përmes lancimit të një ligji të ri Mbi bashkëpunimin, të miratuar në muajin prill të vitit 2012.

Për disa vite, Shqipëria ka aplikuar zbritjen e shumës së detyruar për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore për të gjithë personat e vetë-punësuar në bujqësi. Në Shqipëri pagesa e kontributit të sigurimeve shoqërore është e detyrueshme për të gjithë personat mbi 16 vjeç, por për individët e vetëpunësuar në bujqësi kjo është një shumë fikse, shumë më e ulët sesa për sektorët e tjerë, por që garanton të njëjtat përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore për të

gjithë personat e tjerë të siguruar. Kontributi i shtetit për sistemin e sigurimeve shoqërore vjen si kompensim për kontributin individual të reduktuar të fermerëve.

Me qëllim mbështetjen e aksesit të prodhuesëve ndaj tregjeve, qeveria shqiptare gjatë viteve 2004-2009 ka mbështetur krijimin e tregjeve rajonale të shumicës në zonat kryesore të prodhimit bujqësor (në Vlorë, Lushnjë, Korcë, Gjirokastrë, Shkodër, Kukës dhe Berat). Gjithashtu, Ministria e Bujqësisë ka mbështetur ndërtimin e thertoreve të reja komunale, me qëllim përmirësimin dhe rritjen e sigurisë ushqimore dhe garantimin e mbrojtjes së konsumatorit.

Aktivitete të tjera që inkurajohen plotësisht nga qeveria janë ato të konsolidimit dhe zhvillimit të tregut të tokës. Në vitin 2010 u miratua ligji "Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokës së pakultivuar". Pronarët mbajnë të drejtat e tyre të pronësisë, ndërsa toka e tyre u jepet me qera të tretëve nga pushteti vendor. Gjithashtu është miratuar edhe ligji "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës". Në vitin 2011 u miratuan disa ligje të rëndësishme në lidhje me materialin mbjellës, plehërat kimike dhe shërbimet veterinarë.

Bujqësia nuk perceptohet si pengesë kryesore për Shqipërinë në rrugën e saj drejt statusit kandidat për në BE, por njëkohësisht është e qartë që sektori ka mangësi të mëdha përsa i përket zhvillimit të tij. Raporti i Komisionit Evropian i vitit 2011 thekson ndër të tjera se: "Ka patur një farë progresi në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Po kështu progres është shënuar edhe në zbatimin e zhvillimit rural. Megjithatë, kapacitetet analitike, si edhe ato për përpilimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit rural mbeten të dobëta. Ka patur një farë progresi, ndonëse të pabarabartë, në fushën e politikave të sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare. Kapacitetet operative të Autoritetit Kombehtar të Ushqimit janë përmirësuar ndjeshëm, bashkë me disa ndryshime në kuadrin ligjor për çështjet e sigurisë ushqimore dhe veterinarë. Kapacitetet e përgjithshme dhe bashkëpunimi brenda për brenda shërbimit, si edhe përkufizimi i kompetencave mbeten të dobëta" (Komisioni Evropian, 2011). Gjithashtu, raporti bën një përmbledhje të disa prej pengesave rregullatore që duhet të trajtohen jo vetëm për hir të statusit "Kandidat", por edhe për ta bërë bujqësinë shqiptare më konkurruese.

Ndërkohë, Shqipëria duhet të bëjë përmirësime të ndjeshme për të përmbushur standardet e BE-së dhe për të adaptuar dhe zbatuar *acquis communautaire*. Në fushën e politikave të përbashkëta bujqësore (CAP), kjo ndër të tjera përfshin: harmonizimin e legjisllacionit në fushën e sigurisë ushqimore, veterinarë, fitosanitare, lëvizjen e lirë të kafshëve dhe produkteve bujqësore, administrimin dhe kontrollin e pagesave, etj. Përvoja e vendeve të reja anëtare ka treguar se ka nevojë për përpjekje të vecanta dhe investime për të përmbushur *acquis* në aspektin e bujqësisë. Disa projekte të financuara nga BE-ja (kryesisht në kontekstin e fondeve IPA) po ndihmojnë në përgatitjen e vendit për anëtarësim, duke familjarizuar autoritetet dhe organizatat e tjera përkatëse me metodat që përdoren për zbatimin e masave të mbështetura nga BE-ja.

Legjisllacioni shqiptar në fushën e bujqësisë është vetëm pjesërisht i harmonizuar me *acquis*-të. Ndonëse ka patur progres relativisht të mirë në lidhje me legjisllacionin për sigurinë ushqimore dhe veterinarinë, harmonizimi i legjisllacionit përsa i përket Organizatave të Përbashkëta të Tregut ende është prapa. Megjithatë, Shqipëria nuk parashikon probleme në vitet në vijim përsa i takon miratimit të *acquis communautaire* që kanë mbetur dhe ajo do të jetë në gjendje t'i zbatojë ato plotësisht, me anëtarësimin e saj në BE.

Ministria e Bujqësisë parashikohet të rishikojë strategjitë e zhvillimit bujqësor dhe rural, si edhe të përfundojë planin për zhvillimin rural që do të jetë baza për miratimin e masave të politikave për zhvillimin bujqësor dhe atë rural. Legjisllacioni në fushën e sigurisë ushqimore është vetëm pjesërisht i harmonizuar me *acquis*-të, ndërsa është krijuar Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, si një institucion kryesor përgjegjës për kontrollin e situatës së sigurisë ushqimore në vend. Legjisllacioni në këtë fushë bazohet kryesisht tek “Ligji për ushqimin”, “Ligji për veterinarinë”, “Ligji për mbrojtjen e bimëve” dhe ligje të tjera përkatëse.

Si një masë e mëtejshme drejt përafrimit me strukturat dhe zhvillimin institucional të BE-së, në Shqipëri janë krijuar shërbimet publike këshillimore të cilat funksionojnë në të gjitha qarqet dhe nivelet administrative të vendit. Në nivel qendror, shërbimi këshillimor është nën varësinë e Drejtorisë së Shërbimeve Këshillimore, Shkencës dhe Informacionit Bujqësor (DESSI) në Ministrinë e Bujqësisë. Kjo

drejtori përgjigjet për hartimin e strategjive dhe manaxhimin dhe organizimin e këtij shërbimi në rang kombëtar¹⁶. Të pesë Qendrat për Tranferimin e Teknologjisë Bujqësore (QTTB) janë pjesë e strukturës qendrore. Detyrat e tyre kryesore përfshijnë: futjen e metodave të reja, inputeve dhe paketave teknologjike; zhvillimin e kërkimeve në ferma dhe testimet mbi bazën e problemeve të ngritura nga fermerët në qarqet përkatëse; kualifikimi dhe ekspertiza teknike për shërbimin këshillimor dhe fermerët; demonstrimi i teknologjive të reja për mbarëshkrimin e kafshëve; dhe përgatitja dhe botimi i materialeve këshillimore për specialistët dhe fermerët. Niveli aktual i efikasitetit të organizatave të shërbimit mbetet i ulët dhe kapacitetet e tyre kanë nevojë për shumë përmirësim. Vetëm një numër i vogël fermerësh u referohen shërbimeve këshillimore për informacione dhe këshilla në lidhje me farërat, drithërat, dizinfektimin, mbarëshkrimin blegtoral dhe problemet me aksesin e fondeve, që pengojnë modernizimin dhe rritjen e fermave.

B. Tendencat dhe problemet kryesore në lidhje me Investimet e Huaja Direkte në bujqësi në ekonominë e tjera në tranzicion dhe në Shqipëri

Bujqësia është një fushë specifike për IHD-të, vecantitë e së cilës kanë nevojë për vëmendje gjatë hartimit të politikave përkatëse në Shqipëri. Ndërsa pronësia e huaj e tokës është e kufizuar në disa vende, në disa të tjera roli i IHD-ve në bujqësi është kontrovers. Shkalla e IHD-ve në bujqësi zakonisht është e vogël, por me impakt të rëndësishëm, në vecanti në vendet në zhvillim (UNCTAD, *WIR09*).

IHD-të në bujqësi në nivel global po shtohen, ku prurjet vjetore të IHD-ve në bujqësi në rang global janë trefishuar në një mesatare prej 3 miliardë dollarë nga vitet 1989–1991 dhe 2005–2007. Megjithatë, raporti i IHD-ve në bujqësi si total i IHD-ve mbetet i ulët, ku totali i IHD-ve hyrëse në bujqësi është vetëm 32 miliardë dollarë. Për më tepër, TNC-të në përpunimin ushqimor dhe tregëtinë e pakicës

16 Ka gjithashtu edhe tri Koordinatorë Rajonalë të Shërbimeve Këshillimore, si pjesë e këtij Seksioni në Ministrinë e Bujqësisë që përgjigjen për bashkërendimin dhe monitorimin e planeve këshillimore në nivel rrethi, për programet e trainimit dhe aktivitetet kërkimore në fermë brenda qarqeve të tyre.

gjithashtu investojnë në bujqësi dhe në prodhimin e bazuar në kontrata me fermerët. Kjo e fundit është një formë angazhimi e cila nuk bazohet në investime kapitale por ku një supermarkatë e huaj apo përpunues ushqimor i ble kulturat bujqësore nga fermerët që në fillim të sezonit përmes një marrëveshjeje paraprake ku përcaktohet cmimi, sasia, cilësia dhe specifikime të tjera. Duke përfshirë përpunimin dhe marketingun, Investimet e Huaja Direkte në agrobiznes janë një shumëfish i asaj cka investohet në bujqësi në një kuptim të ngushtë. Kështu, p.sh. pas një niveli të lartë rritjeje në fillim të viteve 2000, prurjet e IHD-ve në industrinë ushqimore dhe atë të pijeve i kaluan 40 miliardë dollarë gjatë viteve 2005–2007.

IHD-të në bujqësi janë shtuar gjithashtu edhe në vendet e reja anëtare të BE-së dhe ato të Evropës Juglindore, duke shënuar një maksimale prej 1.2 përqind të totalit të IHD-ve hyrëse, me 917 milionë dollarë në Serbi (tabela III.5). Në Turqi, 32 milionë dollarë ose 0.8 përqind e IHD-ve shkuan në sektorin e bujqësisë në vitin 2009, pas një shume të ngjashme në vitin 2008, pas pothuaj asnjë ngritjeje në vitet e mëparshme. Investitorët e huaj në sektorin e bujqësisë në Turqi erdhën kryesisht nga Lindja e Mesme dhe u drejtuan kryesisht rritjes

së gjedhit (Deloitte, 2010). Në vitin 2008 IHD-të në bujqësi u rritën, në vecanti në pjesën veriore të pasur të vendit që është edhe rajoni i fermave, duke arritur përqindjen më të lartë të totalit të fondeve të IHD-ve midis vendeve të rajonit. Jo vetëm investitorët bujqësorë por edhe firmat e investimeve financiare po provojnë shancet e tyre atje.¹⁷ Prurjet e IHD-ve në bujqësinë shqipëtare arritën në 15 milionë dollarë në vitin 2007, u rritën në €38 milionë në vitin 2008, por ranë në €11 milionë në vitin 2010 (të dhënat nga Banka Kombëtare e Serbisë). Kjo sugjeron që interesi për Investimet e Huaja Direkte në bujqësi pati një kulm të vetëm që përkonte me pikun e cmimeve të ushqimeve në tregjet ndërkombëtare dhe që nuk vazhdoi në vitet në vijim.

Investimet e Huaja Direkte në bujqësi u shtuan në vendet e reja anëtare të BE-së pas anëtarësimit të tyre, në shumicën e vendeve u rrit njëkohësisht edhe totali i stokut të IHD-ve. Disa nga kushtet për IHD-të në bujqësi u liberalizuan, ndonëse pronësia e tokës mbeti e kufizuar në pjesën dërmuese të këtyre vendeve. Pronësia e tokës së huaj zakonisht është shumë e rregulluar, si pjesë e politikave bujqësore për shumicën e vendeve, me qëllim që toka të mbetet në pronësi të fshatarëve dhe familjeve

TABELA III.5.

Totali i IHD-ve hyrëse në bujqësi, gjueti dhe pyje në disa vende të përzgjedhura anëtare të BE-së dhe në vendet e Evropës Juglindore, 2009

Host country	€ million	per cent of total
Bullgaria	182	0.5
Republika Çeke	156	0.2
Hungaria	385	0.6
Polonia	587	0.5
Rumania	467 a/	1.0 a/
Slovakia	71 b/	0.2 b/
Shqipëria	7	0.3
Bosnje Hercegovina	11	0.2
Kroacia	90	0.4
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	31 c/	1.0
Serbia	917	1.2

Burimi: Baza e të dhënave wiiw sipas statistikave kombëtare, www.wiiw.ac.at

a/ të dhënat për vitin 2008, bashkë me peshkimin

b/ të dhënat për vitin 2008.

c/ të dhënat për vitin 2008.

17 "Investors eyeing Balkan farms as long-term play", Reuters, 1 nëntor 2010.

TABELA III.6.

Stoku i IHD-ve hyrëse në industrinë ushqimore, pije dhe duhan," në vendet e reja anëtare të BE-së dhe në vendet e Evropës Juglindore, 2009

Vendi pritës	€ milionë	Përqindje e totalit
Republika Çeke	2,607	3.0
Hungaria	1,757	2.6
Polonia	7,656	5.9
Rumania	2,060	4.1
Slovakia	725	2.0
Shqipëria	51	2.3
Bosnje Hercegovina	31	5.8
Kroacia	602	2.3
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (2007)	174	6.8
Serbia	54	5.4

Burimi: baza e të dhënave wiiw, sipas statistikave kombëtare, www.wiiw.ac.at.

rurale. Në vendet e BE-së nuk mund të bëhet diskriminim midis të drejtave të personave të huaj apo vendas, qofshin ata persona natyrorë apo juridikë. Vendet anëtare e kufizojnë aksesin e shtetasve të huaj në lidhje me tokën bujqësore duke e kushtëzuar pronësinë e tokës me rezidencën, arsimim në fushën fermere dhe sigurimin e të ardhurave nga ferma. Në vendet anëtare dhe në disa vende të reja anëtare mund të zbatohen kufizime të ndryshme të përkohëshme (Bojnec, 2011).

Pronësia e tokës bujqësore nga persona të huaj natyrorë është e kufizuar në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, me përjashtim të rasteve të trashëgimisë, por shtetasit e huaj janë të lirë ta marrin tokën me qera. Personat juridikë janë të lirë të kenë tokë në pronësi apo me qera, pa kufizime. Në Kroaci, si personat e huaj natyrorë, ashtu edhe ata juridikë përbalen me kufizime që parashikohet të qëndrojnë për shtatë vjet pas anëtarësimit në BE. Në Turqi, personavë juridikë vendas dhe personave të huaj natyrorë dhe juridikë nuk u lejohej të kenë në pronësi tokë bujqësore. Kjo është praktika më kufizuese që favorizon familjet fermere vendase. Midis vendeve të reja anëtare të BE-së, Hungaria është vendi që aplikon kufizime të ngjashme me ato të Turqisë që do të zëvendësohen nga kufizime që janë në përputhje me ato të BE-së, nëse ky përjashtim i traktatit të antarësimit nuk do të mbahet në fuqi pas vitit 2012. Rumania nuk e kufizon pronësinë e tokës të personave juridikë dhe rrjedhimisht të huajt i regjistrojnë kompanitë sipas ligjit rumun në fuqi që u bën atyre të mundur të kenë tokë në pronësi. Kjo rregullorë është e ngjashme me atë të Shqipërisë.

Përqindja e IHD-ve në bujqësi e paraqitur

në tabelën III.5 lidhet me hapjen ndaj tregut të tokës dhe me disponueshmërinë e tokës bujqësore. Sipas regjimeve më liberale, përqindja maksimale në IHD është vetëm afërsisht 1 përqind dhe që arrihet në vende me tokë të mirë fermere dhe politika të hapura kundrejt pronarëve të huaj të tokës, si në Rumani, Serbi dhe në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Sipas kësaj përvoje nuk mund të pritet një rritje më shumë se trefishi i IHD-ve në sektorin bujqësor në Shqipëri, edhe sikur kushtet të përmirësohen më tej.

Ndonëse IHD-të në sektorin e bujqësisë zakonisht janë të kufizuara, ato mbeten më të përhapura në sektorin ushqimor, të pijeve dhe duhanit (tabela III.6). Përqindja e këtyre të fundit në rezervën e IHD-ve është midis 2 përqind dhe 6 përqind në vendet e reja anëtare të BE-së dhe rajonin e Evropës Juglindore. Në Shqipëri ajo mbërrin në 2.3 përqind të IHD-ve, duke qënë një ndër shifrat më të ulëta të rajonit.

Ka argumente sipas të cilave në ekonomitë në tranzicion, Investimet e Huaja Direkte luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e një rritjeje të fortë dhe të qëndrueshme (Konig, 2009). Investimet e mëdha të huaja në industrinë ushqimore dhe në industrinë që furnizon me lëndë të parë mund të nxisin prodhimtarinë dhe novatorizimin institucional përmes zinxhirit ushqimor, me efekte të rëndësishme pasuese për kompanitë dhe fermat vendase, dhe rrjedhimisht për familjet rurale. Ka të tjerë që e kundërshtojnë këtë konkluzion (Swinnen dhe Van Herck, 2010), sipas të cilëve zinxhiri i shitjes me pakicë përgjithësisht është pa dëshirë për të përdorur furnitorët lokalë ose ka raste

kur ata i ulin disa cmime në nivelin e duhur për të mbuluar kostot. Qeverisja e hallkave të ofertës moderne karakterizohet nga përdorimi i standardeve të larta, për të siguruar cilësinë e sigurisë ushqimore përgjatë të gjithë zinxhirit dhe rrjedhimisht duke cuar në nivele të larta të koordinimit vertikal. Ka patur shqetësime në potencë në lidhje me “shpërndarjen e qerave dhe përjashtimin e fermerëve nga hallkat moderne të politikave dhe ofertës”, duke cuar në rekomandimin që “qeveritë mund t’u vijnë në ndihmë fermerëve për tu integruar në hallkat e ofertave bashkëkohore dhe të përfitojnë nga mundësitë ekonomike që ofron zhvillimi” (Konig, 2009). Në vendet në tranzicion më të avancuara ekonomike, si p.sh. vendet e reja anëtare të BE-së, investimet e huaja në industrinë agroushqimore kanë qënë motori kryesor i rritjes së produktivitetit, përmirësimeve cilësore dhe rritjes së konkurrencës në sektorin bujqësor. Fermerët kanë përfituar ndjeshëm nga efektet vertikale si edhe nga prurjet e IHD-ve në përgjithësi në industrinë ushqimore dhe nga trysia mbi firmat vendase për tu ristrukturuar gjë që ka sjellë ndryshime të rëndësishme në zinxhirin e furnizimit bujqësor” (Swinnen dhe Van Herck, 2010).

Edhe në Shqipëri, filialet e huaja në industrinë ushqimore, atë të pijeve dhe duhanit janë shumë më sinjifikative se në prodhimin bujqësor (tabela III.7), ndonëse kanë qënë objekt i luhatjeve të mëdha, në varësi të madhësisë së kampionit. Sipas të dhënave më të fundit për vitin 2010, 3.3 përqind e ndërmarrjeve aktive në industrinë ushqimore kishin investitorë të huaj (73 firma). Ato prodhojnë 22 përqind të gjithë xhiros, me 16 përqind të punëmarrësve për të gjithë industrinë. Kjo tregon se filialet e huaja janë më të mëdha sesa kompanitë vendase të kësaj industrie dhe se ato kanë produktivitet më të lartë të krahut të punës sesa firmat me pronësi vendase.

Kjo është një përpjekje e parë e Ministrisë së Bujqësisë për të mbledhur informacion për TNC-të e huaja që janë aktive në fushën e agrobiznesit në Shqipëri. Ndonëse një informacion i tillë është ende i paplotë, parashikohet që ai të plotësohet dhe përmirësohet më tej në vitet në vijim. Një vrojtje e kohëve të fundit nga Ministria e Bujqësisë ka identifikuar 16 kompani me investime të huaja (tabela III.8)¹⁸. Kapitali

18 Asnjë nga këto kompani nuk morri pjesë në sondazhin mbi kënaqësinë e investitorëve, rezultatet e të cilit jepen në Kapitullin II. D.

i investuar është i vogël, me përjashtim të pesë rasteve ku ai është i barabartë apo i kalon një milionë euro. (Nuk disponohen të dhëna për kapitalin e investuar për pesë kompani të tjera). Projekti më i madh është fabrika e miellit Atlas Sh. a. në Tiranë, në pronësi të Loulis Group (një kompani greke) dhe dy biznesmenëve shqiptarë. Kompanitë që kanë investime të huaja direkte janë të përhapura në shumë nën-sektore të bujqësisë, pa asnjë përçindim në lidhje me fushën e aktivitetit. Ato mbulojnë ato fusha ku kushtet lokale janë të favorshme për prodhim dhe eksporte, si p.sh. në fruta, perime dhe duhan. Pjesa dërmuese e investitorëve janë me origjinë italiane ose greke, tendencë kjo që nuk devijon nga investimet e huaja direkte në sektorë të tjerë.

Nëntë nga 16 kompanitë e listuara në tabelën III.8 kanë plotësuar pyetësorin në lidhje me aktivitetet e tyre, në muajin shkurt të këtij viti. Ato janë ndër projektet më të mëdha të investimeve në bujqësi dhe në agrobiznes përse i takon investimeve kapitale. Por gjithësesi ato janë SME, të cilat kanë të punësuar 10-85 persona. Tre prej tyre janë 100 përqind me pronësi të huaj dhe tre të tjera janë kryesisht me pronësi të huaj; katër janë kompani të krijuara nga investitorë grekë dhe tre nga investitorë italianë. Aktivitetet e tyre përqëndrohen në përpunimin e produkteve bujqësore kryesisht me origjinë shqiptare. Vetëm një prej tyre e eksporton shumicën e prodhimit të vet, ndërsa tre të tjera kanë aktivitete eksporti kryesisht në vendet e rajonit.

Përse i përket arsyeve për të investuar në Shqipëri, pjesa më e madhe e kompanive përmendën mundësitë që ofron tregu lokal. Njëkohësisht, ata shprehën pakënaqësi në lidhje me cilësinë, sasinë dhe cmimin e lëndës së parë vendase, si edhe me kushtet e pabarabarta të konkurrencës së tregut. Këto komente theksojnë nevojën për zhvillim institucional dhe një organizim më të mirë të tregut. Përse u takon elementëve specifikë të politikave bujqësore, disa investitorë përmendën subvencionet për mbjelljen e pemëve frutore, që kanë një ndikim pozitiv në furnizimin e lëndës së parë; burimi kryesor i pakënaqësive kishte të bënte me problemet e rimbursimit të TVSH-së. Në të ardhmen, kompanitë nuk parashikojnë përmirësime të biznesit gjatë vitit 2012 dhe në afatshkurtër, por vetëm në një perspektivë më afatgjatë. Kjo tregon se ata parashikojnë rënie të ritmeve të rritjes ekonomike dhe konsumit familjar në Shqipëri dhe në disa vende të rajonit në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

TABELA III.7.

Shqipëria: përqindja e filialeve të huaja në industrinë ushqimore, të pijeve dhe duhanit (në përqindje)

	Ndërmarrjet	Punësimi	Xhiroja	Investimet
2007	1.1	12.7	22.0	11.4
2008	0.6	16.3	30.8	27.6
2009	0.7	13.9	23.3	13.8
2010	3.3	15.8	22.0	15.4

Burimi: INSTAT.

TABELA III.8.

Kompanitë me kapital të huaj në bujqësinë dhe agrobiznesin shqiptar

Nr	Emri i kompanisë	Vendi i origjinës	Qyteti ku bëhet biznesi	Fusha e aktivitetit	Viti themelimit	Shuma e investimit (në euro)
1	MIKA Sh. a. Korca	Greqia	Korce	Mbledhja dhe përpunimi i duhanit	1996	Afërsisht 650,000
2	Nikolaos & Thimi Sh. p. k.	Greqia	Korce	Mbledhja dhe përpunimi i lëkurëve të kafshëve	2011	Mbi 50,000
3	Solisima Sh.a	Greqia	Korce	Përpunimi i frutave	1996	Afërsisht 4,500,000
4	Kristo&Zguri Sh. p. k.	Greqia	Korce	Mbledhja dhe përpunimi i kërmillit	2000	Mbi 20,000
5	Ledmarke Sh. p. k.	Italia	Fier	Prodhim dhe përpunim perimesh	2011	Afërsisht 70,000
6	Green-farm Sh. p. k.	Italia	Lushnje	Prodhimi i luleve dhe pemëve dekoratike	2007	Afërsisht 1,000,000
7	Korporate	Italia	Kavaje	Prodhimi, vjelja dhe eksportimi i perimeve	2011	n.a.
8	Toni SH.PK.	Gjermani	Rrogozhin, Kavaje	Bulmet	2001	n.a.
9	Atlas Sh. a.	Greqia	Tirana	Prodhim mielli	1995	Afersisht 11,500,000
10	ALB-MINES Sh. p. k.	Turqia	Vore, Tirane	Prodhim mielli	2004	n.a.
11	Mozzarella Sh. p. k.	Italia	Tirane	Prodhim dhe përpunim qumështi	2000	n.a.
12	Agrotal Sh. a.	BERZH 30 përqind (partner shqiptar 70 përqind)	Kavaje	Prodhim ullinjsh	2009	n.a.
13	GALE Sh.p.k	Italia	Vlore	Përpunim kafeje	2010	Afërsisht 200,000
14	Agrofruit Sh.p.k	Greqia	Korce	Përpunim frutash	2009	Afërsisht 800,000
15	Vessa Sh.p.k	Italia	Kavaje	Përpunim lëkure	1995	Afërsisht 4,500,000
16	Meggle Albania Sh.p.k	Gjermani	Rrogozhine	Bulmet	2010	Afërsisht 2,050,000

Burimi: Ministria e Bujqësisë, Shqipëri.

C. Konkluzione dhe rekomandime për politikat: Thithja e IHD-ve dhe rritja e përfitimeve prej tyre në bujqësinë shqiptare

Konsiderata të përgjithshme

Shqipëria ka një qasje liberale ndaj tregëtisë dhe investimeve në bujqësi. Por liberalizimi i plotë i tregjeve të brendshme dhe tregtisë ndërkombëtare mund të mos i zgjidhë të gjitha problemet (FAO, 2003). Reforma të tilla nuk garantojnë përdorimin më efikas të burimeve natyrore dhe genetike për bujqësinë. Deformimet e tregut do të vijojnë ta pengojnë bujqësinë dhe të kufizojnë përfitimet potenciale të mirëqënies. Kjo për shkak të kushteve specifike të bujqësisë: rezervat e produkteve kryesore janë të nevojshme për tu mbrojtur nga problemet që mund të shkaktojnë moti në lidhje me prodhimin dhe nga luhatjet ekstreme të cmimeve. Ulja e riskut për bizneset shpesh shkon paralelisht me uljen e konkurrencës. TNC-të kanë akses të privilegjuar ndaj informacioneve, kapitalit dhe pushtetit politik, të gjitha prej të cilave kufizojnë konkurrencën duke krijuar barrierë për futjen në treg. Politikat publike duhet të ndërmarrin hapa për rritjen e pushtetit të prodhuesëve vendas për të mbyllur marrëveshje apo ujdj, duke u siguruar atyre subvencione dhe duke ushtruar kontroll në treg.

Për të lehtësuar dhe nxitur investimet në industrinë agroushqimore, qeveria duhet të investojë në infrastrukturën rurale, në arësim dhe R&D në sektorin bujqësor. Përveç këtyre, qeveria duhet të zbatojë politika që nxisin integrimin e fermerëve në zinxhirët modernë të furnizimit. Ndër rekomandimet praktike¹⁹ në lidhje me këto politika përfshihen sa më poshtë vijon:

- Qeveritë mund të ndihmojnë në uljen e kostove të transaksioneve me të cilat përballen kompanitë e përpunimit dhe ato të shitjes me pakicë, gjatë kontraktimeve me fermerë të vegjël përmes investimeve në infrastrukturën rurale dhe në institucionet ndërmjetëse (krijimi i shoqatave fermere dhe pikat e mbledhjes).
- Qeveritë mund të nxisin konkurrencën në sektorin e përpunimit ushqimor.

¹⁹ Sipas Swinnen dhe Van Herck (2010).

- Qeveritë duhet tu vijnë në ndihmë fermerëve (të vegjël) për të rritur aftësitë për të mbyllur marrëveshje apo për të rënë në ujdj me përpunuesit, aktorët e pakicës dhe furnitorët e lëndës së parë, duke marrë masa për të rritur transparencën e kontratave, për të siguruar asistencë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke ofruar standard tregu gjatë negociatave të cmimeve, trainime për fermerët në lidhje me të drejtat/detyrimet e tyre si kontraktorë dhe të investojnë në qendrat e kontrollit të cilësisë për të siguruar pagesa korrekte për të siguruar cilësi në zinxhir.
- Gjithashtu, qeveritë duhet të ndihmojnë fermerët në aksesin e tyre ndaj kredive rurale, që i aftëson për të bërë investimet e nevojshme për të prodhuar produkte me cilësi të lartë, sic kërkohet nga zinxhirët modernë të furnizimit.
- Në rast krize dhe rritjeje të cmimeve të ushqimeve, qeveritë duhet të sigurojnë mbështetje në të ardhura për grupet më vulnerabël të popullatës (duke përfshirë transfertat në para cash, programet e ushqimit dhe programet për të sëmurët dhe të moshuarit), në vend të subvencioneve për fermerët apo vendosjes së kontrolleve të cmimit dhe masave tarifore. Në ato raste kur subvencionet ushqimore janë të pashmangëshme, ato duhet të jenë të përkohëshme dhe të kenë si objektiv të varfërit (p.sh. përmes kuponave ushqimore).

Probleme të zhvillimit

Zhvillimi ekonomik me bazë të gjerë i vendit kërkon mobilizimin e burimeve të investimeve në bujqësi që është edhe punëdhënësi kryesor në vend. Zhvillimi bujqësor ka në përbërjen e tij një aspekt ekonomik, një aspekt social, si edhe një aspekt të qendrueshmërisë mjedisore. Sektori agroushqimor është përgjegjës për një pjesë të madhe të deficitit të tregëtisë së jashtme të vendit që është një ndër problemet për bilancin e pagesave. Studimi aktual del në konkluzionin se është e mundur të ngushtohet hendeku i produktivitetit të bujqësisë shqiptare përkundrejt vendeve më të përparuara dhe të përmirësohet bilanci i tregëtisë me jashtë të vendit përmes investimeve të brendshme dhe të jashtme dhe përmes zhvillimit institucional të sektorit.

Gjatë 20 viteve të fundit, burimi kryesor i rritjes në bujqësinë shqiptare ka qënë rritja e e bazuar në faktorët total të produktivitetit (toka, krahu i punës dhe kapitali). Stabiliteti makroekonomik dhe liberalizimi ekonomik cuan në rialokim të burimeve nga aktivitetet më pak fitimprurëse (drithërat) tek ato më fitimprurëse (hortikulturë, pemëtari dhe blegtori) gjë që lejoi bujqësinë të gjeneronte një rritje ekonomike me një përqindje të ulëta investimesh. Megjithatë, me qëllim ruajtjen e rritjes në sektorin bujqësor, Shqipëria duhet që gradualisht të kalojë nga modeli “i rritjes së produktivitetit bazuar në faktorët total” e shkaktuar nga rialokimet e burimeve gjate periudhës së post-tranzicionit, drejt modeleve të bazuara në shtimin e investimeve në kapitalin fizik dhe njerëzor, në dije dhe në teknologji.

Zona gjeografike për prodhimin bujqësor është e kufizuar dhe rrjedhimisht specializimi merr rëndësi të dorës së parë. Bujqësia shqiptare ka disa avantazhe konkurruese në lidhje me prodhimin e frutave dhe perimeve të ndryshme, kryesisht në lidhje me prodhimin e mollëve, shagëve, arrave, lajthive, ullinjve, rrushit, fiqve, qershive, si edhe të lulëlakrës, brokollit dhe fasuleve. Vënia në përdorim e këtyre avantazheve kërkon më shumë investime dhe një mjedis më të favorshëm ekonomik. Në këtë aspekt, Ministria e Bujqësisë, ka realizuar dy studime të detajuara që kanë si qëllim identifikimin dhe përkufizimin e masave efektive mbështetëse për zhvillimin e ullinjve, arrorëve dhe shagëve në Shqipëri.

Shqipëria ka burime investimi për zhvillimin e bujqësisë dhe agrobiznesit, duke qënë se ka patur një akumulim të shpejtë të kapitalit në ekonomi gjatë viteve të fundit, bazuar në burime të brendshme dhe në të ardhura nga emigracioni. Kapitali është përqëndruar kryesisht në pasuri të paluajtshme, në hotele dhe restorante, si edhe në aktivitetet financiare dhe jo në bujqësi dhe agrobiznes ku fitimet mund të jenë më të pakta dhe risqet më të larta. Në këtë kuadër nevojiten politika për reduktimin e riskut dhe ruajtjen e konkurrencës për ta bërë bujqësinë dhe aktivitetet përkatëse më tërheqëse për investitorët.

Niveli aktual i investimeve në nivel fermash është modest dhe një nga arësyet kryesore për këtë është akses i dobët ndaj kreditimit. Sektori bankar në Shqipëri është zhvilluar në mënyrë të stabilizuar gjatë 15 viteve të fundit. Megjithatë, shumica e kre-

dive bankare u janë dhënë bizneseve në zonat urbane, ndërsa akses i fermerëve ndaj kredive mbetet i kufizuar. Gjatë dy viteve të fundit, vetëm afërsisht 1 përqind e totalit të kredive shkoi në sektorin e bujqësisë; rrjedhimisht shumica e investimeve nga prodhuesit bujqësorë të vegjël dhe të mesëm u bë duke përdorur burimet e veta. Dy pengesat kryesore mbeten munesa e kolateralit nga fermerët dhe risku i lartë i perceptuar nga bankat që lidhet me aktivitetet bujqësore. Me qëllim rritjen e investimeve, qeveria duhet të gjejë mënyra dhe instrumente për të lehtësuar aksesin ndaj kredive për prodhuesit bujqësor. Pavarësisht nga likuiditeti dhe një treg urban i kredive tashmë i saturuar, shumica e bankave ende hezitojnë të japin hua në sektorin e bujqësisë dhe bizneset që lidhen me të, për shkak të riskut të lartë të perceptuar. Gjithashtu, shumica e bizneseve bujqësore kanë vështirësi për të gjetur kolateralin e nevojshëm (afërsisht 120–140 përqind e shumës së huasë). Mbi bazën e përvojave të suksesshme është e nevojshme të krijohet dhe të zgjerohet një fond për garantimin e kredive, si edhe të futen instrumente sigurimi për bujqësinë.

Donatorët ndërkombëtarë të mbështetur nga ekspertë lokalë kanë siguruar informacione të rëndësishme të segmenteve të ndryshme të prodhimit bujqësor dhe të zinxhirëve të vlerave të agrobiznesit në Shqipëri. Ata kanë evidencuar problemet kryesore që lidhen me zinxhirin e furnizimit dhe pikat e pamjaftueshme/të papërshtatëshme të shërbimeve publike, por informacioni i mbledhur është përdorur vetëm pjesërisht, ndaj nevojitet një zbatim më i koordinuar i këshillave të politikave. Një studim i kohëve të fundit i përgatitur nga Agjencia për Zhvillimin e Zonave Malore (2011) siguron një analizë më të thellë të zhvillimeve për zonat malore. Një ndër konkluzionet e këtij studimi është se “Shqipëria ka një avantazh krahasimor në prodhimin e gështenjave, arrave, lajthive dhe shagëve. Të gjitha këto janë prodhime me vlera të larta që mund të sigurojnë të ardhura të qenësishme për fermerët ruralë, edhe nga parcelat relativisht të vogla të tokës. Në rast se fermerët organizohen në shoqata prodhuesish, prodhimi mund të grumbullohet brenda vendndodhjeve specifike dhe kështu do të mund të kapërcehen disa nga problemet që lidhen me fragmentimin e tokës që lidhen me: mekanizimin; ofrimin e shërbimeve këshillimore; GLOBAL G.A.P (Praktikat e Mira Bujqësore), certifikimin dhe mbledhjen e prodhimit të vjelë”.

Përmirësimi i kushteve kuadër

Për përmirësimin e avantazheve krahasimore të Shqipërisë në lidhje me prodhimin bujqësor duhet të kapërcehen disa pengesa ndaj konkureshmërisë, në kontekstin e rritjes së konkurrencës në rajon dhe të nevojës për harmonizimin me legjislacionin dhe standardet e BE-së. Konsolidimi i tokës dhe rritja e fermave janë parakushte të rëndësishme për zgjerimin e prodhimit të orientuar nga tregut dhe për pjesëmarrjen e investitorëve të huaj në sektor. Aspekte të rëndësishme të përmirësimit të kuadrit të politikave përfshijnë: (i) rritjen e stabilitetit të masave mbështetëse në bujqësi (duke qënë se sektori bujqësor iu përgjigjet me ritme të ngadalta ndryshimeve të shpeshta të politikave dhe miratimit të prioriteteve të reja të politikave puna bëhet më e vështirë se në sektorët e tjerë); (ii) forcimin e kapaciteteve dhe transparencës së institucioneve të kontrollit, në vecanti për sa i përket sigurisë ushqimore, veterinare dhe kontrollit fitosanitar; (iii) forcimin e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për manaxhimin e masave mbështetëse për financimin e bujqësisë; (iv) përmirësimin e ngritjes së kapaciteteve dhe mekanizmave mbështetës.

Problemet kryesore të bujqësisë shqiptare përfshijnë: produktivitetin e ulët, fragmentimin e tokës; zinxhirë të paorganizuar vlerash, shërbime fitosanitare jo efikase. Një pjesë e madhe e këtyre mangësive janë të lidhura me efikasitetin e ulët të shërbimeve publike. Sigurisht që çështjet që kanë të bëjnë me pronësinë e tokës dhe fakti që fermat janë shumë të vogla mbeten faktorë të rëndësishëm që cojnë në mungesë të efikasitetit në ferma, në nivele të ulëta prodhimtarie dhe të ardhurash. Fragmentimi i tokës ka krijuar pengesa të mëdha për sa i takon përmirësimin të efikasitetit, si p.sh. kosto të mëdha transaksionesh, problem me akordimin e fondeve dhe vështirësi në adoptimin e teknologjive të ekonomisë së shkallës, sic janë traktorët apo autokombajnata.

Të gjitha investimet në bujqësi, në vecanti ato ku përfshihen bizneset e huaja, janë më të sigurt nëse janë të mbështetura nga pronësia dhe një treg funksional i tokës. Ndër faktorët që pengojnë zhvillimin e një tregu formal të tokës në zonat rurale përfshihen: funksionimi i tokës si rrjet i sigurisë shoqërore; probleme të pazgjdhura dhe konflikte në lidhje me pronësi mbi tokën; perceptimi se regjistrimi i tokës është dicka që ha kohë dhe ka kosto; si edhe tregjet e dobëta të kredive. Formalizimi dhe vënia

në funksionim e tregut të tokës janë elemente shumë të nevojshme për rritjen e efikasitetit dhe të ardhurave nga bujqësia. Kjo do të ishte një mbështetje e madhe për konsolidimin e tokës në sektorin bujqësor ku niveli i fragmentarizimit mbetet i lartë. Inkurajimi i tregut të dhënies së tokës me qera ka gjasa të jetë mënyra më e lehtë për ta nxitur një gjë të tillë. Shqipëria është një ndër vendet me politika të favorshme për investitorët dhe nuk e kufizon pronësinë e tokës për kompanitë e regjistruara sipas ligjit shqiptar, pavarësisht nga pronësia e tyre.

Duhet të zhvillohen politika dhe instrumente më aktive për rritjen e sigurisë së titujve të tokës, uljen e kostove të transaksioneve të tokës, përmirësimin e efikasitetit të sistemit të regjistrimit të tokës, dhe aplikimin e takës së tokës bujqësore, sidomos mbi token e lënë djerrë. Cmimet e tokës janë të ulëta dhe rrjedhimisht nëse toka bëhet gjerësisht e disponueshme, kjo mund të shërbejë si stimul për thithjen e investitorëve. Kjo do të cojë në rritjen e kërkesës për tokë dhe mund të rrisë cmimin e saj. Duhet të merren masa që investitorët të mos jenë të interesuar për të blerë tokë të lirë, pa përmirësuar prodhimin në të.

Siguria ushqimore dhe kontrolli i cilësisë

Në Shqipëri ka vend për përmirësim të faktorëve që influencojnë rritjen në bujqësi, në vecanti për sa i përket cilësisë. Ecuria në këtë aspekt lidhet me informacionin dhe dijet e fermerëve, si edhe me metodat dhe teknologjitë që ata përdorin. Aftësitë për të punuar në ferma mund të përmirësohen përmes shkollimit më të mirë (në vecanti të përmirësimit të arsimit profesional) si edhe përmes zbatimit të rezultateve të punës kërkimore.

Përmirësimi i cilësisë së produkteve është një burim i rëndësishëm potencial i rritjes. Niveli i lartë i importeve bujqësore dhe niveli i ulët i eksporteve tregon faktin se fermerët shqiptarë ende përballen me vështirësi në lidhje me plotësimin e standardeve cilësore të konkuresëve të tyre dhe me kufizimet në zhvillimin e zinxhirëve të furnizimit. Në vecanti, seleksionimi, paketimi dhe siguria ushqimore janë një burim i rëndësishëm për rritjen e sektorit. Ato mund të bëjnë të mundur fermerëve të bëhen pjesë e zinxhirëve modernë të furnizimit (kësh-tu p.sh. përpunuesit ushqimorë, supermarkatat dhe tregjet e eksportit) që cojnë në standard-

izim të vlerave, përputhshmëri me standardet e sigurisë dhe cilësisë ushqimore dhe normalitetit të furnizimit.

Përfitimi nga avantazhet e rritjes së mundësive tregëtare do të kërkojë nga prodhuesit agro-ushqimorë në Shqipëri të përmirësojnë cilësinë dhe sigurinë e produkteve të tyre, për të qënë në përputhje me kërkesat strikte të BE-së. Teksa tregjet rajonale dhe ato të BE-së bëhen gjithmonë e më shumë të ekspozuara ndaj produkteve më cilësore, më të sigurta, me cmime më të mira bujqësore dhe ushqimore, prodhuesit dhe eksportuesit shqiptarë do të përballen me vështirësi në rritje në hedhjen e produkteve të tyre në këto tregje. Sektori do të përballen me trysni të ngjashme konkurruese në tregun vendas si: importe më të sigurta dhe me cilësi më të lartë, me cmime më të ulëta, reduktimi i kostove të shportës së ushqimeve dhe mundësisht bërja e industrisë lokale më konkurruese. Për përmirësimin e sigurisë dhe cilësisë ushqimore nevojiten investime të mëdha publike dhe private, në vecanti në pajisje dhe infrastrukturë, si edhe në sisteme moderne të kontrollit të cilësisë.

Një zbatim më strikt i standardeve të sigurisë ushqimore do të kryhet sipas fazave, duke kombinuar asistencën financiare dhe stimujt për përputhshmëri, në një mënyrë që i vjen në ndihmë sektorit dhe që hedh bazat për miratimin e standardeve që kërkojnë nga BE-ja. Këtu do të përfshihen hartimi i planeve për koordinimin e aktiviteteve të agjencive të ekzekutimit, me qëllim shmangien e dublimit të inspektimeve dhe sigurimin e integritetit të planeve të kontrollit dhe aktiviteteve laboratorike.

Përpjekje më të mëdha kërkojnë për fuqizimin e strukturave të kontrollit ushqimor, në përputhje me kërkesat e BE-së. Ekzistojnë elementët bazë të sistemit të kontrollit zyrtar në tregun vendas, por ato kanë nevojë për tu forcuar. Mospërputhjet në zbatimin e legjislacionit ekzistues përsa i përket sigurisë ushqimore kanë lejuar vijimin e praktikave të paligjshme dhe kanë shkurajuar investimet private për zhvillimin e një rrjeti të qendrueshme të faciliteteve moderne. Përparësi kryesore duhet t'i jepet zbatimit të Ligjit për Shërbimet Veterinare dhe Fitosanitare, si edhe fuqizimit të inspektorateve.

Gjatë periudhës së tranzicionit, mungesa e nivelit të duhur të bashkëpunimit dhe koordinimit midis organeve të kontrollit ka shtuar kompleksitetin dhe ka krijuar mbivendosje dhe

mangësi në procedurat e inspektimit dhe ato të zbatimit të ligjit. Krijimi i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit parashikohet të sjellë përmirësime të rëndësishme në këtë fushë. Megjithatë, ekziston nevoja për një përmirësim të mëtejshëm të bashkëpunimit midis personelit të këtij Autoriteti, shërbimeve kombëtare veterinarë, shërbimeve veterinarë bashkiake, shërbimeve të shëndetit publik, policisë rrugore dhe asaj kufitare.

Ka nevojë për përmirësim të standardeve të cilësisë dhe certifikimit, në vecanti për mishin, bulmetin, frutat dhe perimet. Inspektorët duhet të zbatojnë detyrën e tyre për tu siguruar që cdo operator në industrinë ushqimore të veprojë në përputhje me standardet e sigurisë dhe cilësisë ushqimore. Aktualisht ende mungojnë Kërkesat Minimale Teknike (MTR) për cilësinë dhe nuk ka standarde të detyrueshme për shumicën e produkteve bujqësore. Standardet për produktet individuale të vendosura nga Departamenti i Standardeve janë vullnetare dhe certifikimi sipas standardeve nuk është falas. Së paku, me qëllim shtimin e numrit të prodhuesëve për eksport, fermerët duhet të inkurajohen të zbatojnë standardet.

Rëndësia e certifikimit nga standarde ndërkombëtare nuk është e nevojshme vetëm për prodhuesit e eksportit. Vetëm afërsisht 50 fermerë që prodhojnë fruta dhe perime janë të certifikuar sipas EurepGAP (standardi i përbashkët për praktikën e manaxhimit të fermave) dhe nuk ka informacion në lidhje me numrin e fermave që janë të certifikuar sipas GLOBAL.G.A.P. Industria përpunuese ka djeni, por jo të mjaftueshme në lidhje me standardet e BE-së. Në shumicën e rasteve, kompanitë që duhet të zbatojnë apo prezantojnë një standard të ri e bëjnë këtë përmes konsulentëve privatë, por ka edhe nevojë për certifikim. Forcat spontane të tregut nuk do të nxisin aplikimin e MTR-së për cilësinë e frutave dhe perimeve të prodhuara për tregun vendas pa iniciatën e shtetit. Në perspektivë, zinxhirët e supermarkatave mund të shndërrohen në një faktor të rëndësishëm për përhapjen e standardeve dhe MTR cilësore.

Shqipëria duhet të bëjë përmirësime të ndjeshme të cilësisë së farëve dhe materialit të mbjelljes, në vecanti për frutat dhe perimet. Skemat e certifikimit janë krijuar, por kanë nevojë për kontroll dhe monitorim më efikas. Sipas legjislacionit aktual, fermerët mund të blejnë nga furnitorët e autorizuar ose të prodhojnë vetë materialin mbjellës. Në rastin e parë

ka së paku kontroll të dokumentuar të farërave të importuara dhe kontrole periodike nga Instituti i Bimëve dhe Farërave (në lidhje me cilësinë e farërave) si edhe nga Ministria e Bujqësisë. Inspektimi fitosanitar duhet të mundësojë kontrollin e sigurisë së farërave dhe materialeve të tjera që prodhohen nga vetë fermerët. Dokumentet që paraqiten nga serat e regjistruara shqiptare në përgjithësi janë të plota, por kjo nuk garanton gjithësesi gjurmshmëri të plotë të materialit mbjellës as në rastet e importimit të tyre. Gjithashtu blloqet ekzistuese të pemtoreve mëmë duhet të kontrollohen vazhdimisht për sëmundje karantine, në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria e materialit mbjellës të prodhuar në Shqipëria me rregullat e certifikimit.

Ngritja e kapaciteteve

Ekziston nevoja për ndërtimin e institucioneve të forta për rritjen bujqësore, të cilat të mund tu përgjigjen nevojave të fermerëve të përfshirë në aktivitete të reja si: prodhimi frutor dhe blegtoral, zbatimi i teknikave dhe teknologjive të reja dhe rritja e aksesit ndaj fondëve. Përmirësimi i kapaciteteve dhe efikasitetit të institucioneve publike mbetet një sfidë, në vecanti përsa i takon shërbimeve këshillimore, arsimit profesional, sigurisë ushqimore dhe kontrollit të higjienës, si edhe institucioneve që merren me manaxhimin e investimeve publike dhe skemave mbështetëse në sektorin bujqësor. Ndërsa ka patur përmirësim të kapaciteteve të dy kategorive të fundit, shërbimet këshillimore dhe arsimit profesional janë ende mbrapa përsa i përket efikasitetit.

Shërbimet këshillimore luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e aksesit të fermerëve në lidhje me mundësitë financiare, duke përfshirë edhe financimet e ardhshme nga programi i BE-së për bujqësinë (IPARD). Gjithashtu, me qëllim garantimin e një mbështetjeje më të mirë për fermerët në lidhje me aksesin në tregje nevojitet rritja e kapaciteteve të stafit që ofron shërbime këshillimore.

Përvec përmirësimit të kapaciteteve të stafit këshillimor publik ka vend edhe për përmirësim të performancës dhe efikasitetit të Qendrave të Transferimit të Teknologjisë Bujqësore (QTTB). Pjesa më e madhe e punës së tyre kërkimore nuk u shkon prodhuesëve për shkak të hallkave që mungojnë midis zinxhirit të shërbimit. Ato duhet të jenë të lidhura më mirë me

shërbimet këshillimore rajonale dhe me qendrat lokale të informacionit, duke u siguruar atyre informacion më cilësor dhe trainime mbi teknologjitë e reja. Gjithashtu, qendrat e informacionit bujqësor në nivel lokal duhet të jenë të pajisura më mirë (duke përfshirë edhe pajisjet e IT) dhe të kenë informacionin përkatës në lidhje me përmirësimet e përdorimit të lëndës së parë dhe teknologjive.

Rritja e konkurrueshmërisë

Perspektiva e rritjes së bujqësisë shqiptare do të vijë me shumë gjasë nga intensifikimi i prodhimit përmes komercializimit të fermave dhe përqëndrimit tek produktet me vlera të larta. Është e vështirë të thuhet nëse rritja e rendimentit është si rezultat i përmirësimeve të lëndës së parë dhe teknologjisë apo një kombinim i faktorëve, por rritjet e prodhimitarisë tregojnë se sektori po modernizohet dhe se ka vend për përmirësim të mëtejshme.

Studime të ndryshme sektoriale sugjerojnë se Shqipëria duhet të përqëndrohet më shumë në avantazhet e dukshme konkurruese në nënsektorët e fruta-perimeve, ku vendi ka një performancë më të mirë në krahasim me vendet fqinje (në dallim nga drithërat ku ka një performancë të ulët). Në sektorin e bujqësisë ka hapësira të mëdha për rritje dhe zhvillim tek kulturat bujqësore me vlerë të lartë, sic janë frutat dhe perimet; prodhimet blegtorale (në vecanti qumështi dhe mishi i deles); agropërpunimi; dhe disa produkte të tjera që shfrytëzojnë relativisht ndjeshëm krahun e punës në sektorin bujqësor shqiptar (bimët mjekësore, vaji i ullirit, mjalti, prodhimi i ushqimeve organike). Të gjitha këto janë fusha që mund të promovohen midis investitorëve të huaj potencialë.

Modernizimi i sektorit rural dhe bujqësor shqiptar do të kërkojë që shumë prej fermave të vogla familjare të largohen nga sektori bujqësor drejt mundësive më fitimprurëse në sektorin jo fermer. Kjo do të çlironte sipërfaqe toke për veprimtari të vlefshme fermere, për të vijuar me përmirësimin dhe komercializimin, si edhe me rritjen e produktivitetit të aseteve të sektorit. Një sektor bujqësor me orientim biznesi është gjithmonë më i aftë për të integruar investimet e huaja.

Ndonëse ka disa ferma të suksesshme që do të mund të absorbojnë krahun ekstra të punës, pjesa më e madhe e krahut të punës në

zonat rurale do të duhet të kërkojë profesione të tjera. Ekzistojnë lidhje potenciale që duhet të shfrytëzohen midis bujqësisë, agropërpunimit, turizmit dhe mjedisit. Turizmi është një sektor që po zhvillohet relativisht me shpejtësi në Shqipëri, gjë që tregon se agro-turizmi dhe sektorët që lidhen me të si: produktet tradicionale ushqimore janë një fushë potenciale për zhvillimin ekonomik, me lidhje të fuqishme me cilësinë e mjedisit.

Integrimi perspektiv në BE është forca kryesore shtytëse për zhvillimin institucional dhe ligjor në vend. Ndonëse ky mbetet një objektivi vlefshëm afatgjatë, devijimi nga kërkesat e BE-së mund të justifikohet për qëllime zhvillimi. Paralelisht me procesin e integritimit të saj në BE, Shqipëria duhet të sigurohet që politikatat dhe reformat e saj bujqësore të mbeten në përputhje me sfidat e saj dhe situatën aktuale të vendit. Shqipëria përballet me sfida shumë të ndryshme në sektorin bujqësor nga ato me të cilat përballet vendet anëtare të BE-së, si p.sh. me nevojën për rritjen e produktivitetit, përmirësimin të cilësisë dhe forcimit të marketingut. Rrjedhimisht, politikatat bujqësore duhet tu përgjigjen sfidave aktuale të sektorit, në vend të kalohet tek një miratim i nxituar i parimeve të Praktikave të Përbashkëta Bujqësore (CAP) të BE-së, që kanë për qëllim trajtimin e problemeve të ndryshme të fermerëve të vendeve të BE-së.

Programet për mbështetjen e sektorit bujqësor në vend aktualisht janë relativisht jodeformuese, duke garantuar kështu një fillim të mbarë drejt perspektivës për të qënë në përputhje me CAP-in. Por gjithësesi, do të duhet të kalojnë shumë vite përpara se Shqipëria t'i harmonizojë plotësisht politikatat dhe instrumentet e saj me CAP-in. Qeveria shqiptare duhet të veprojë me kujdes për përafrimin e politikave të saj me CAP-in, për tu siguruar që ato i përshtaten kontestit të vendit.

Zhvillimi i zinxhirit të vlerave

Shqipëria po e zhvillon zinxhirin e saj agroushqimor, ndonëse integrimi dhe konsolidimi vertikal mbeten ende tejte të kufizuara; vetëm prodhuesit e perimeve, frutave dhe qumështit janë disi më mirë të organizuar. Ka nevojë për politika më të forta dhe mbështetje teknike me qëllim kalimin në një nivel më të lartë të organizimit të të gjithë zinxhirëve të vlerave. Një pjesë e madhe e zbatimit të infor-

macionit teknologjik varet nga organizimi dhe ndërveprimi i fermerëve. Kjo mund të përmirësohet përmes vetë-organizimit, përmes politikave publike dhe nga pjesë të tjera të zinxhirit të vlerave agroushqimore (ofruesit e lëndës së pare, kompanitë ushqimore, shitësit e pakicës).

Gjithashtu, politikatat dhe masat mbështetëse duhet tu përgjigjen më mirë sfidave specifike të zinxhirëve të ndryshëm të vlerave dhe rajoneve të ndryshme. Ndërsa zonat më të begata mund të përfitojnë nga përmirësimet në politikatat dhe infrastrukturën bujqësore, zinxhirë më pak të organizuar dhe më të varfër vlerash në zona më të thella do të kërkojnë një fokus më të madh tek politikatat jo-bujqësore si: shërbimet publike, asistencë sociale dhe infrastruktura e përshtatshme.

Në të ardhmen, problemi më i madh për fermerët do të vijë nga përqëndrimi i lartë i pakicës përkundrejt përqëndrimit të ulët të fermerëve, gjë që con në konkluzionin e nxitjes së përqëndrimit dhe bashkëpunimit të fermave, si edhe të aplikimit të rregulloreve në përfitim të tyre dhe monitorimit për garantimin e konkurimit të barabartë mes shitësve të pakicës (Konig, 2009). Integrimi i prodhuesëve bujqësorë në zinxhirët e biznesit të TNC-ve që vijnë në vend është një burim i rëndësishëm potencial i teknologjisë dhe know-how. Njeko-hësisht, duhet të ketë edhe një farë mbrojtjeje të zinxhirëve të vlerave dhe prodhuesëve lokalë.

Politikat në lidhje me Investimet e Huaja Direkte

Krahasimet me vendet e tjera kanë treguar se shumica e IHD-ve në agrobiznesin shqiptar është e kufizuar. Në bujqësi mund të arrihet në afërsisht 1 përqind të rezervave të IHD-ve ndërsa në industrinë ushqimore, të pijeve dhe cigareve në 5 përqind. Këto nuk janë shifra të larta nga këndvështrimi i bilancit të pagesave. Rrjedhimisht, nuk është shumica e investimeve të huaja direkte që lidhen me bujqësinë që duhet të drejtojnë politikatat e shtetit, por aspektet e zhvillimeve të pritshme.

Në sektorin e përpunimit ushqimor, roli i FIE-ve është me rëndësi përse i takon rendimentit dhe punësimit. TNC-të kanë segmentet më produktive të firmave të tyre në këtë industri, kjo sipas të dhënave të INSTAT-it dhe rezultatit të vrojtimit me investitorët. Për të përfituar më shumë nga produktiviteti dhe efektet

e tij, politikat shqiptare në lidhje me IHD-të duhet të synojnë investitorë potencialë të interesuar për përpunimin e prodhimeve lokale bujqësore.

Investitorët e huaj kanë një numër të kufizuar të aspekteve specifike që e bëjnë detyrën e thithjes së investimeve të tyre të ndryshme nga ajo për thithjen e investitorëve në përgjithësi. TNC-të me një bazë më të madhe kapitali mund të jenë më pak të ekspozuara ndaj riskut sesa investitorët e vegjël, por ato kanë kërkesa më të mëdha për transparencën dhe stabilitetin e legjislacionit. Rrjedhimisht, përmirësimet e politikave të hartuara si kushte kuadër për sektorin bujqësor në tërësi janë edhe më të nevojshme për thithjen e investitorëve të huaj.

Impakti pozitiv i zhvillimit të IHD-ve në sektorin agrorshqimor mbetet një çështje komplekse që kërkon veprim simultan si në sferën publike, ashtu edhe në atë private. Nga ana tjetër, iniciativat qeveritare janë të nevojshme për përmirësimin e kushteve institucionale për iniciativën private, krijimin e një mjedisi në ndihmë të biznesit qoftë për investitorët e huaj, qoftë për ata vendas. Nga ana tjetër, kapitali i huaj dhe ai vendas mund të bëjë disa nga investimet e nevojshme dhe të përmiësojë nivelin e efikasitetit të fermave. Mekanizmat e mbështetjes dhe kontrollit duhet të sigurohen nga agjenci të pavarura, zakonisht publike, por disa shërbime mund të ofrohen nga sektori privat. Aktorët kryesorë të zinxhirit të vlerave gjithashtu mund ndihmojnë në organizimin e disa prej institucioneve.

Ndikimet e drejtpërdrejta pozitive të TNC-ve mund të jenë: krijimi i fermave tepër produktive dhe konkurruese, si edhe rrjeteve të biznesit. Ndikimet e tërthorta ekonomike të TNC-ve në lidhje me prodhimin bujqësor në nivel mikro mund të cojnë në një përfshirje më intensive të fermerëve (gjysëm) komercialë në rrjete biznesi të TNC-ve, që nga ana e tyre kontribuojnë në mundësi punësimi dhe në

përmirësimin e aksesit në financa dhe tregje për fermerët e vegjël. Përfshirja e TNC-ve mund të kontribuojë në transferimin e teknologjive dhe ndarjen e përvojave, bashkë me zbatimin e standardeve të prodhimit.

Por mund të ketë edhe efekte negative, nëse TNC të fuqishme marrin tokën e fermerëve të vegjël dhe ndonëse përmirësojnë produktivitetin, ata nxjerrin jashtë loje prodhuesit e vegjël nga tregjet lokale dhe rrisin papunësinë. Në këtë aspekt, hapja graduale e tregut dhe mbrojtja provizore e prodhuesëve lokale mund të jetë një avantazh. Njëkohësisht, politikat qeveritare duhet të mbështesin zhvillimin e fermave me qëllim tregu, rrjetet e prodhimit dhe zinxhirët e vlerave, bazuar në shoqatat e prodhuesëve lokale.

Kur shitësit e pakicës dhe prodhuesit ushqimorë hyjnë në një vend të ri ata krijojnë sistemet e tyre të prokurimeve dhe shpërndarjes. Zakonisht ata marrin modelet e tyre të biznesit dhe mundohen t'i bëjnë furnitorët lokalë të veprojnë në përputhje me to. Ata zbatojnë standard të larta për furnitorët dhe janë të përpunueshëm kur vjen fjala për cmimin dhe cilësinë. Prodhuesit bujqësorë lokalë duhet të plotësojnë këto standard, në rast se duan të përfshihen në zinxhirin e furnizimit. Në rast se atyre u mungojnë kapacitetet, sic është rëndom rasti, investitorët e importojnë pjesën më të madhe të lënës së tyre të parë. Importet nuk mund të përjashtohen, por duhet të zbatohen masa për të mbështetur furnitorët lokalë. Politikat shtetërore dhe shoqata e fermerëve mund të zbusin kontaktin midis prodhuesëve bujqësor dhe kompanive të shitjes me pakicë dhe atyre të industrisë ushqimore. Futja në treg e zinxhirëve të mëdhenj ndërkombëtarë të pakicës në Shqipëri është ende në hapat e para dhe ato organizata ende nuk kanë predominancë. Qeveria duhet të nxisë politikat e saj drejt rritjes së konkurrueshmërisë së produkteve lokale, forcimit të zinxhirëve të vlerave lokale dhe përmirësimit të burimeve lokale në këtë sektor.

REFERENCAT

- Bojnec, Stefan (2011). "Land markets in the EU candidate countries of Croatia, Former Yugoslav Republic of Macedonia and Turkey," Centre for European Policy Studies (CEPS) Factor Markets Working Paper, No. 1, September.
- Cela, R., Marku, S. dhe Imami, D. (2010). "Rishikim i sektorit bujqësor dhe politikave bujqësore në Shqipëri" (Kapitulli 2) në vendet e Ballkanit Perendimor, Insitituti Leibniz për Zhvillimin Bujqësor në Evropën Qendrore dhe Lindore (IAMO), vëllimi 57, pp. 37-62.
- Deloitte dhe Republika e Turqisë, Kryeministria, Agjencia e Nxitjes së Investimeve (2010). *Turkish Agriculture Industry Report*. <http://www.invest.gov.tr/en-US/infocenter/publications/Documents/AGRICULTURE.INDUSTRY.PDF>.
- Komisioni Evropian (2011). *Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2011-2012, Konkluzionet për Shqipërinë*, Com (2011) 666 final (Bruksel:Komisioni Evropian).
- Komisioni Evropian (2010). *Strategjia e Zgjerimit dhe Raportet e Progresit 2010*. (Bruksel: Komisioni Evropian), nëntor.
- FAO (2003). *Trade Reforms and Food Security: Conceptualizing the Linkages*. Romë: FAO.
- Görg, H. and Greenaway, D. (2001). "Foreign direct investment and intra-industry spillover: A review of the literature," Research Paper No. 37, University of Nottingham.
- Holzner, Mario (2010). "Albania: Part of a Greke tragedy?" in Vladimir Gligorov, Peter Havlik, Michael Landesmann, Josef Pöschl and Sándor Richter (eds.), *Crisis Is Over, but Problems Loom Ahead*, wiiw Current Analyses and Forecasts: Economic Prospects for Central, East and Southeast Europe, No. 5, February 2010. Vienna: Vienna Institute for International Economic Studies.
- Hunya, Gábor (2010). "IHD in the CEECs hit hard by the global crisis," wiiw *Database on Foreign Direct Investment in Central, East and Southeast Europe, 2010*. Vienna: Vienna Institute for International Economic Studies.
- FMN (2010). "Shqipëria—2010 neni IV konsultimet, konkluzione paraprake të misionit" 10 mars, Uashington, D.C. <http://www.imf.org/external/np/ms/2010/031010.htm>.
- FMN (2010a). *World Economic Outlook: Recovery, Risk and Rebalancing*. Uashington, D.C.: FMN.
- Konig, G. (2009) "The impact of investment and concentration among food suppliers and retailers in various OECD countries", paper presented at the VIIth global forum on international investment, OECD, 7-8 dhjetor.
- Marku, S. dhe Treska, T. (2008), "Cështje të politikave në lidhje me zhvillimin e zonave rurale dhe më pak të favorizuara—nevoja për koncepte dhe qasje të rinovuara" botim në *Review Economicus*, Nr. 3, Universiteti European i Tiranës, fq. 75-89.
- Marku, S. (2008). "Zhvillimi rural në Shqipëri – nevoja për qasje të reja", botuar në *Revieë Economy and Transition*, Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike, Tiranë, fq. 71-84.
- Marku, S. (2008) "Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat rurale malore në Shqipëri" në Konferenca Ndërkombëtare mbi Sfidat dhe Problemet Ekonomiko-Shoqërore, 2008, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, fq 261-271.
- Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK) (2007). *Strategjia për sektorin e bujqësisë dhe ushqimit 2007-2013*. Tiranë
- MIGA (2006). *Investment Horizons: Western Balkans*. Uashington, D.C: Grupi i Bankës Botërore /MIGA.
- Agjencia për Zhvillimin e Zonave Malore (MADA) (2011). *Fizibiliteti i mbështetjes së qeverisë shqiptare për përmirësimin dhe zinxhirët e vlerave për arrat, gështenjat, bajamet dhe shegat*. Tiranë
- OECD (2010). *South East Europe - Investment Reform Index 2010: Monitoring Policies and Institutions for Direct Investment*. Paris: OECD.
- Republika e Shqipërisë (2011). Programi Ekonomik dhe Fiskal 2011-2013. [Please provide information on the ministry or department that produced the document, and the place of publication and/or website details].
- Swinnen, J. and K. Van Herck (2010). *Policy Response to Challenges in agriculture and Rural Development in the Europe and Central Asia Region: Sharing Experience and Enhancing Cooperation in the Region*, LICOS Qendra për Institucionet dhe Performancën Ekonomike, Universiteti Katolik i Lëvenit.
- UNCTAD (WIR02). *World Investment Report 2002: Transnational Corporations and Export Competitiveness*. Nju Jork dhe Gjenevë: Kombet e Bashkuara
- UNCTAD (WIR06). *World Investment Report 2006: IHD from Developing Countries and Transition Economies –Implications for Development*. Nju Jork dhe Gjenevë: Kombet e Bashkuara
- UNCTAD (WIR09). *World Investment Report 2009: Transnational Corporations, Agricultural Production and Development*. Nju Jork dhe Gjenevë: Kombet e Bashkuara
- UNCTAD (WIR10). *World Investment Report 2010: Investing in a Low-Carbon Economy*. Nju Jork dhe Gjenevë: Kombet e Bashkuara).
- UNCTAD (WIR11). *World Investment Report 2011: Non-equity Modes of International Production and Development*. Nju Jork dhe Gjenevë: Kombet e Bashkuara
- PNUD (2005). *ANE Strategic Plan for 2005: Support for Trade Regulation and Trade Promotion*. <http://www.trade.undp.org>
- PNUD (2005a). "Marketing and distribution chain study," EU Cards Project No 2004 / 084-899, <http://www.trade.undp.org>
- Banka Botërore (2007). "Shqipëria: Politika strategjike për një sektor bujqësor më konkurrues" Raporti Nr. AAA 18-AL, Uashington, D.C.
- Banka Botërore, (2007a). "Shqipëria: Rritja urbane, migrimi dhe ulja e varfërisë:- Vlerësimi i varfërisë" Raport Nr. 40071-AL, Uashington D.C.
- Banka Botërore (2010). *Investing across borders 2010, Indicators of foreign direct investment regulations in 87 countries*. Uashington, D.C., Banka Botërore
- Banka Botërore (2010a). *Shqipëria: Programi i Ri për Rritjen- Memorandumi Ekonomik*. Uashington D.C., Banka Botërore.
- OBT (2010), *Shqipëria –Rishikim i Politikave Tregëtare 2010: Vjelja e përfitimeve nga reforma dhe liberalizimi*. Gjenevë, OBT

